DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 412 • MARS 2025

LEHTËSIMET ISLAME PËRGJATË AGJËRIMIT TË RAMAZANIT

RAMAZANI NJË OFERTË HYJNORE PËR FEMRËN MUSLIMANE

ZEKATI - SHTYLLA E DREJTËSISË SOCIALE NË ISLAM

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnava, me rastin e fillimit të muajit të bekuar Ramazan

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Të dashur qytetarë!

Sonte, me faljen e namazit të teravive, e me ngrënien e syfyrit në agimin e nesërm, besimtarët myslimanë nisin ibadetin e agjërimit të muajit të bekuar Ramazan. Andaj sonte, kemi natën e madhe të Ramazani, ku me këtë rast, kam kënaqësinë e veçantë që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal t'ju drejtohem me përgëzimet dhe urimet më të mira, me bindjen dhe shpresën që ta presim dhe ta përjetojmë agjërimin e muajit të bekuar me përkushtim në lutje, ibadete, bamirësi dhe solidaritet.

Është e natyrshme që njeriu t'i përjetoj dhe t'i shijoj mirësitë dhe begatitë e shumta të dhuruara prej Zotit xh.sh., e një ndër to është edhe agjërimi i muajit Ramazan. E si të mos e mirëpret besimtari ardhjen e muajit të bekuar, që është një nga pesë shtyllat e Islamit, dhe që konsiderohet një mundësi e madhe për t'iu afruar edhe më shumë begative të Zotit. Në këtë mënyrë, zemra e myslimanit është e përgatitur për të hyrë në atmosferën e adhurimit, për ta pastruar shpirtin përmes agjërimit, namazit, sakrificës dhe dhembshurisë për të varfrit dhe nevojtarët, për ta arritur kështu devotshmërinë dhe për të reflektuar mbi mësimet e fesë.

Besimtarët myslimanë, me të drejtë e përjetojnë me përkushtim ardhjen e muajit të mirësisë, devotshmërisë, sakrificës dhe faljes së mëkateve, muaj i cili na sjellë mirësi, gëzim, bereqet, begati, mëshirë, lumturi, shëndet dhe paqe, si te fëmijët, te të rinjtë, te nipi e mbesa, te gjyshi e gjyshja, te babai dhe te nëna, muaj i cili përshkon dhe ndriçon fytyrat dhe shpirtrat e të gjithë besimtarëve, andaj porositemi që ta shtojmë adhurimin dhe veprat e mira.

Kanë mbetur edhe pak orë e të shfaqet në mbarë botën gjysmëhëna e muajit të bekuar Ramazan, muaj të cilin e dëshirojnë zemrat dhe shpirtrat e besimtarëve, muaj që me mall e presim ardhjen e tij për t'iu bashkuar në mëshirë dhe falje, muaj që i begaton edhe më shumë sofrat tona, andaj për besimtarët është një dëshirë e madhe dhe një bekim madhështor që t'i shfrytëzojmë të mirat e veçanta që sjellë ky muaj.

Të respektuar vëllezër dhe motra,

Besimtarët e mirëpresin muajin Ramazan për ta rikthyer pastërtinë e zemrave, shkëlqimin e shpirtrave dhe kthjelltësinë e ndërgjegjes. Zoti i Plotfuqishëm na ka bekuar me një muaj kaq të madh, pra ka ardhur koha e agjërimit të këtij muaji, i cili sjellë vetëm ndërgjegjësim, devotshmëri, dhe sakrificë, e këto burojnë nga thellësia dhe pastërtia e besimit në Zotin Një dhe të Vetëm.

Zoti i Madhëruar thotë: *"Muaji Ramazan, është ai (muaj) në të cilin u zbrit Kurani..."*

Muaj që Zoti e ka veçuar me shumë virtyte dhe mirësi të mëdha, me cilësi të larta morale, e të cilat e shtyjnë besimtarin të bëjë vepra të mira dhe të largohet nga veprat e liga. Është muaj në të cilin zbret mëshira e pafund e Zotit të Madhërishëm, falen mëkatet dhe veprat e këqija, hapen dyert e Xhenetit dhe mbyllen dyer e Xhehenemit. Si mund të mos i gëzohemi këtij muaji, kur brenda tij e kemi Natën e Kadrit, në të cilën natë Zoti zbriti Kuranin.

Zoti xh.sh. thotë: *"Ne e zbritëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit."*

Me rastin e fillimit të këtij muaji të bekuar, këshilloj vëllezërit dhe motrat e mi kudo që janë që të kenë frikë nga Zoti i Madhëruar, të garojnë në vepra të mira, të urdhërojnë njëri-tjetrin për të bërë mirë, të jenë të durueshëm ta ruajnë unitetin e të mos përçahen, të bashkëpunojnë në mirësi, urtësi dhe devotshmëri, si dhe të ruhen nga të gjitha ato mëkate që Zoti i ka ndaluar. Kjo ngase Ramazani është një muaj madhështor, muaj në të cilin shumëfishohen veprat e mira dhe falen mëkatet për ata që agjërojnë dhe falin namazin me besim dhe devotshmëri, duke kërkuar kështu shpërblimin për punët e tyre.

Vëllezër dhe motra!

Agjërimi ka shumë dobi dhe urtësi. Duke e bërë agjërimin në formën më të mirë, besimtari e fisnikëron moralin, durimin, bujarinë dhe përpjekjet në atë që e kënaq Zotin.

Muaji Ramazan është një mundësi që vjen vetëm një herë në vit, andaj ta shfrytëzojmë këtë mundësi dhe të përfitojmë prej tij, sikur të jetë Ramazani i fundit që do ta përjetojmë.

Urime, shëndet dhe mbarësi për të gjithë besimtarët kudo që janë!

Agjërim të lehtë dhe të pranuar te Zoti!

Me fat muaji i bekuar Ramazan!

Myftiu Naim ef. Tërnava

Prishtinë, më 28 shkurt 2025

2 Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnava me rastin e fillimit të muajit të bekuar Ramazan

EDITORIAL

4 Solidariteti i institucionalizuar në muajin e mëshirës

FETARE

5 Ramazani na bashkon
Nurudin bin Kalale

8 Veçoritë e Ramazanit
Mr. Artan Musliu

12 Ah, sikur i tërë viti të jetë Ramazan!
Mumin Shehu

15 Mukabeleja në Ramazan
Dr. Azmir Jusufi

18 Kur malli për Ramazanin bëhet lutje
Bajram Zeqiri

20 Agjërimi dhe dispozitat bazë të tij
Dr. Zenel Hajdini

24 Lehtësime fetare përgjatë agjërimit të Ramazanit
Dr. Muhamed Stublla

28 Ramazani, një ofertë hyjnore për femrën myslimane
Adlie Morina-Krasniqi

31 Aspektet psiko-sociale dhe shëndetësore të agjërimit të Ramazanit
Hfz. dr. Almir Pramenkoviq

34 Dispozitat e namazit të teravive
Mr. Ekrem Maqedonci

37 Namazi i vitrit dhe falja e tij gjatë Ramazanit
Dr. Ejup Haziri

41 Dhjetë netët e fundit të Ramazanit dhe Nata e Kadrit
Isa Tërshani

45 Zekati - shtylla e drejtësisë sociale në Islam
Dr. Ilmije Kuqi

FAMILJE & EDUKIM

48 Familja myslimane dhe industria e Inteligjencës Artificiale

AKTIVITETE

50 Myftiu Tërnava priti në takim shefin e Misionit të EULEX-it në Kosovë, z. Giovanni Pietro Barbano



Xhamia e "Martirëve" në Vushtrri

DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore

Nr. 412 • viti 38 • Mars 2025
• Ramazan 1446
• Çmimi 1 €

Boton
Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi

Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci, Mr. Muharrem Tërnava, Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik: Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.

Solidariteti i institucionalizuar në muajin e mëshirës

"Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë-sadaka që t'i pastrosh me të dhe t'ua shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta..."

(Et Tevbe, 103)

Portat e mirësisë dhe mundësitë e përfitimit madhështor të shpërblimeve në muajin e bekuar Ramazan janë magjepsëse. Besimtarët gjatë gjithë këtij muaji çelikosin besatimin e tyre dhënë Zotit, për të qenë të përkushtuar në adhurime dhe që ndaj urdhrave të Tij të jenë tejmase konsekuentë. Vigjilenca e tyre arrin kulmin, saqë nuk lejojnë që t'iu ikë asnjë çast e asnjë mundësi në këtë muaj pa e marrë hisen e tyre të shpërblimit në të. Ata, në njërën anë agjërojnë, falin namaz, e shtojnë masën e mirësjelljes dhe bujarisë së tyre, ndërsa në anën tjetër braktisin veset e liga dhe i kthehen karakterit të tyre për ta gdhendur nga të gjithë ato veti të liga që e ndiejnë vetën të rënduar prej tyre për muaj e vite me radhë. Nisen nga thirrja fisnike që bëhet në fillim të muajit Ramazan, siç na e kumtoi i Dërguari ynë, Muhamedi a.s.: "...o ti që aspiron të mirën, mësyja (tanimë pa hezitim) asaj, dhe o ti që synon ndonjë vepër të ligë, ndaloje veten (nga ajo)...". (Ibën Maxheh, 1642 dhe Hakemi, 1532).

Ashtu siç myslimanët me pietet bëjnë përpjekje në këtë muaj që ta pastrojnë shpirtin e tyre nga mëkatet, po ashtu janë të kujdesshëm që t'i pastrojnë edhe pasuritë e tyre duke dhuruar zekatin, sadekatul fitrin, por jo vetëm, për të dëshmuar kështu fisnikërinë e tyre në këtë muaj të Fisnikërisë Hyjnore të Zotit Fuqiplotë.

Në vorbullën e paqartësive që ngritën kohë pas kohe, rreth formës së organizimit të aparatit inkasues dhe distribuues të zekatit, duhet vënë pikat mbi shkronja e të themi qartazi se zekati, si çështje e ndjeshme, meqë ka të bëjë me pasuritë, kurrë nuk është llogaritur thjesht një lloj bamirësie individuale e lënë kuturu. Ai është një organizim dhe mekanizëm i kulluar shoqëror, për të cilin në rrethana të mirëqena duhet kujdesur shteti. Pra, shteti islam ishte ai që në epokat e të kaluarës islame merrte përsipër edhe inkasimin, por edhe distribuimin – shpërndarjen e pasurive zekatore.

Ajeti kuranor lidhur me këtë dilemë ishte i prerë, duke ngarkuar me këtë mision të Dërguarin e Allahut a.s. në cilësinë e tij prej një udhëheqësi shtetëror, kur Zoti i tha: "Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë-sadaka që t'i pastrosh me të dhe t'ua shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta..." (Et Tevbe, 103). Mirëpo në mungesë të ekzistencës së konceptit të organizimit të tillë shtetëror, mbesin ministritë e çështjeve fetare në sistemet bashkëkohore në botën islame, e te komunitetet fetare islame në Evropë, janë bashkësitë fetare islame, organizmat që llogariten më të denjat për ta kryer këtë detyrë.

Të rikthejmë në vëmendje faktin se i Dërguari i Allahut, në cilësinë e tij prej një udhëheqësi të shtetit, nuk lejonte boshllëk institucional në këtë fushë, por autorizonte dhe mandatonte zyrtarisht njerëz të besueshëm për ta mbledhur zekatin. Kështu bëri me Ebi Mesudin-Ukbetu bin Amërin r.a., pastaj Muadh bin Xhebelin r.a., kur këtë të fundit e dërgoi në Jemen, e shumë të tjerë. Kësisoj vazhdoi tradita më pas edhe nga kalifët e drejtë.

Kjo e shtyri Imam Maverdiun, shkollarin klasik, i cili i detajoi qysh herët normat e një qeverisjeje të mirëfilltë islame, e i cili kur foli për këtë çështje tha: "Nuk ka dyshim se kur pagesa e zekatit bëhet tek udhëheqësi islam, ose personi i autorizuar prej tij, kjo e shkarkon pronarin e pasurisë në mënyrë të drejtpërdrejtë (nga obligimi i zekatit)." (El Havij el Kebir, 3/184). Ndërsa Ibën Hazmi ishte ende më konciz kur theksoi se: "I gjithë ymeti islam janë pajtuar që nuk pranohet si inkasant-mbledhës i zekatit secili që për vete thotë unë jam mbledhës i zekatit. Pra cilido që del për të mbledhur zekatin pa e ngarkuar atë prijësi legjitim, i tilli nuk llogaritet prej inkasantëve-mbledhësve të ligjshëm të zekatit." (El Muhala, Ibën Hazëm (6/149).

Koncepti racional i instucionalizimit të zekatit dhe sadekatul fitrit nuk ngufatë prirjen bujare të njerëzve solidarë që pos këtyre fondeve, të cilat i orientojnë në Bashkësinë Islame, institucion tradicional e legjitim që drejton jetën fetare në vend, që ata pastaj bamirësitë e tjera të zgjedhin vet se si t'i shpërndajnë dhe kujt dëshirojnë t'ua dhurojnë. Nëpërmes një ekuivalence të tillë të urtë, ne arrijmë që edhe institucionin e zekatit dhe sadekatul fitrit ta ruajmë si mekanizëm dhe institucion të mëkëmbjes së Islamit dhe mbarëvajtjes së institucioneve fetare, dhe në anën tjetër me ndihmesat e tjera solidare të bashkëndjejmë e t'iu dalim në ndihmë nevojave të atyre njerëzve që gjatë jetës janë përballur me skamje e varfëri.

Mr. Driton Arifi

Ramazani na bashkon

Nurudin bin Kalale

Muaji i bekuar Ramazan do të na kthehet pas disa javësh (ditësh), për t'i ndriçuar hëna e re e tij zemrat tona para se të shfaqet në qiell. Aromat e tij të besimit i mbushin shpirtrat me qetësi dhe shpresë. Ramazani është margaritar i vitit dhe lidhës i muajve, që kthehet te ne përsëri pas disa muajsh mungesë, duke shkruar në portat e shtëpive tona: **"***Ramazani na bashkon.***"** Ai vjen duke sjellë me vete mirësi, harmoni, gëzim, mëshirë dhe vëllazëri, dhe duke na dhënë lajmin e mirë të unitetit, bashkimit dhe lidhjes mes myslimanëve. Por, a është e vërtetë që *Ramazani na bashkon* dhe si?

Së pari, si të mos na bashkojë Ramazani, kur është muaji kur hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit, dhe lidhen shejtanët dhe xhinët e rebeluar. I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: "Kur hyn nata e parë e Ramazanit, lidhen shejtanët dhe xhindet e rebeluar, mbyllen portat e Xhehenemit dhe nuk hapet asnjëra prej tyre, hapen portat e Xhenetit dhe nuk mbyllet asnjëra prej tyre. Një thirrës thërret çdo natë: "O ti që e do të mirën, afrohu! O ti që e do të keqen, frenohu!" Allahu liron njerëz nga zjarri për çdo natë të Ramazanit."[1]

A NA BASHKON RAMAZANI ME TË VËRTETË?

Muaji Ramazan nuk është një muaj i zakonshëm si të tjerët gjatë vitit. Ai është muaj me një veçanti dhe shenjtëri të dallueshme, që reflektohet në respektin që i japin myslimanët këtij muaji të bekuar, i cili ka vend të veçantë në zemrat e tyre. Madje, ai lidhet me tituj dhe cilësime të ndryshme, të cilat agjëruesit besojnë se nuk mund ta përshkruajnë asnjë muaj tjetër. Ai është muaji i dashurisë, bereqetit, devotshmërisë, mirësisë dhe besimit; muaji i solidaritetit, mëshirës, dhe lidhjeve shoqërore. Prandaj, është thënë "*Ramazani është bujar*" dhe "*Ramazani na bashkon*", sepse myslimanët besojnë fuqishëm se ai është një muaj që bashkon dhe nuk ndan. Këta tituj dhe këto cilësime nuk janë thjesht vetëm etiketa, por më tepër janë pasqyra të sjelljeve sociale, të traditave dhe zakoneve, që janë bërë pjesë e pandashme e ritualeve të këtij muaji të bekuar.

Por, mbi çfarë na bashkon Ramazani në këtë kohë? A na bashkon vërtet në vëllazërim dhe lidhje familjare? Apo na bashkon thjesht vetëm rreth një sofre të përbashkët? Apo na i bashkon zemrat tona rreth mirësisë dhe mëshirës? Apo "*bashkimi*" në Ramazan kufizohet vetëm në ushqime dhe pije të ndryshme, apo ai është mundësi e jashtëzakonshme për t'i afruar shpirtrat dhe për t'i bashkuar zemrat?

RAMAZANI NA BASHKON SI NJË ZAKON VJETOR

Nuk ka dyshim që Ramazani na bashkon si një zakon vjetor, duke sjellë me vete mirësi dhe bereqet. Gjatë këtij muaji, vëmendja ndaj kulturës islame, ndjenjës fetare dhe praktikave fetare rritet ndjeshëm. Megjithatë, fatkeqësisht, për shumë njerëz, Ramazani është kthyer thjesht vetëm në një zakon vjetor ose një traditë, ku njerëzit e presin që t'i ndryshojnë zakonet e tyre sociale, si në ushqim, pije, punë, gjumë, etj.. Kjo ndodh sepse veprimet e papërgjegjshme sulmuan muajin e bekuar dhe e shpërfillën atë, duke e zbrazë agjërimin nga kuptimi dhe thelbi i tij. Kështu ai pothuajse u shndërrua thjesht në ndërprerje të ngrënies dhe pirjes, ose në grevë të përkohshme nga ushqimi dhe pijet. Në këtë rrëmujë të ideve që u sulmuan mbi muajin e bekuar, ndjenjat e larta islame dhe moralet e mira u harruan dhe, njerëzit e neglizhuan mbrojtjen e të drejtave të Ramazanit dhe humbën respektin për të dhe për shenjtërinë e tij.

Me shtimin e këtyre natyrave të huaja në shoqërinë tonë islame, fjala "Ramazani na bashkon" mori kuptim, qëllim dhe rezultat tjetër. Veprimi i bashkimit u kthye nga bashkimi i zemrave dhe moralit të mirë në bashkimin rreth radiove, programeve televizive, serialeve, konkurseve dhe veprave të tjera dramatike dhe mediatike që prodhohen posaçërisht gjatë muajit Ramazan, ku shumica e të cilave - nëse jo të gjitha - nuk janë të përshtatshme, as të balancuara, dhe as nuk janë në përputhje me muajin e bekuar dhe nuk përkojnë me vlerën dhe shenjtërinë e tij.

Ramazani bëhet një mundësi e artë një herë në vit për shoqërinë, pavarësisht shtresave apo dallimeve, për të kapërcyer problemet dhe konfliktet. Nuk ka vend për urrejtje, përçarje apo grindje. Zemrat pastrohen, duart shtrihen për paqe dhe pajtim, fytyrat ndriçohen nga buzëqeshja dhe shtëpitë mbushen me dashuri, dhembshuri dhe harmoni.

Nuk është çudi që shumë nga këto vepra nuk kanë asnjë lidhje me identitetin arab dhe islam, sepse ato nuk arrijnë asnjë nivel kulturor dhe etik që i përshtatet madhështisë së muajit të bekuar. Përkundrazi, në vend që të jenë faktorë bashkimi, pavarësisht nga papërshtatshmëria e tyre, ato janë bërë faktorë përçarjeje dhe largimi. Arsyeja për këtë është se ato përmbajnë mashtrime për mendjet, lëndim të ndjenjave të turpit, dhe janë aq të devijuara, plot degjenerim, fjalë të papërshtatshme dhe skena të pahijshme, saqë nuk janë të denja për t'u shfaqur madje as jashtë muajit Ramazan.

PAVARËSISHT GJITHÇKAJE, RAMAZANI ENDE NA BASHKON

Pavarësisht nga të gjitha shkeljet dhe tejkalimet që ndodhin ndaj shenjtërisë së këtij muaji të bekuar, Ramazani ende na bashkon përmes respektit të tij, të cilin e forcojnë mësimet e pastra të fesë islame. Ai vazhdon ta ruajë statusin e tij të lartë midis muajve të vitit. Myslimanët e presin këtë muaj me shpresë për mirësi, duke kërkuar shpërblim, falje dhe mëshirë nga Allahu në çdo aspekt të virtyteve. Gjatë Ramazanit, shumë ndodhi pozitive ndodhin midis njerëzve: ata që janë në konflikt pajtohen, ata që janë të larguar afrohen, dhe ata që janë të zemëruar me njëri-tjetrin gjejnë paqe. Shpesh ndodh që ata që kanë të drejtë të heqin dorë vullnetarisht nga pretendimet e tyre, ndërsa të tjerët që kanë gabuar kërkojnë falje dhe pajtim. Ramazani bëhet një mundësi e artë një herë në vit për shoqërinë, pavarësisht shtresave apo

dallimeve, për të kapërcyer problemet dhe konfliktet. Nuk ka vend për urrejtje, përçarje apo grindje. Zemrat pastrohen, duart shtrihen për paqe dhe pajtim, fytyrat ndriçohen nga buzëqeshja dhe shtëpitë mbushen me dashuri, dhembshuri dhe harmoni.

Ramazani, pavarësisht gjithçkaje, mbetet muaji i adhurimit, agjërimit dhe lutjes. Ai duhet të na bashkojë në dashuri dhe përkushtim shpirtëror, ashtu siç na bashkon rreth sofrës së iftarit dhe syfyrit, si dhe në mbledhjet familjare. Ramazani gjithashtu na bashkon në faljen e namazit me xhemat, në teravitë në xhami dhe në leximin, meditimin dhe studimin e Kuranit.

KTHIMI I SHPIRTIT TË RAMAZANIT

Ndoshta gjëja më e dukshme kur afrohet muaji Ramazan është ndjenja e shpirtit të tij që përshkon të gjitha shtëpitë. Njerëzit fillojnë të përgatiten për të garuar në bërjen e veprave të mira dhe në ofrimin e iftareve për agjëruesit. Ata mblidhen për dashurinë ndaj Allahut, të Dërguarit të Tij a.s. dhe shokëve të tij, si dhe për të studiuar Kuranin dhe jetën e Pejgamberit a.s.. Por, nuk (duhet të) mblidhen për t'i kaluar netët para asaj që transmetojnë kanalet televizive, ose nëpër mjediset e kafeneve, gjë që shpesh çon në humbjen e detyrimeve fetare.

Ramazani na bashkon me aromën e imanit, përulësisë dhe lutjes drejtuar Allahut, me thënien "*Amin*" në lutje, me frikën dhe lotët. Ky është muaji që na bën të ndiejmë urtësinë e agjërimit dhe frytet e tij fetare, shpirtërore dhe shëndetësore. Kur ndiejmë etje, kujtojmë atë që është i etur, dhe kur ndiejmë uri, kujtojmë të varfrin e mjerë që vuan nga uria gjatë gjithë vitit.

"Agjërimi dhe Kurani ndërmjetësojnë për robin tek Allahu në Ditën e Gjykimit. Agjërimi thotë: "O Zot, unë ia ndalova ushqimin dhe epshet gjatë gjithë ditës, prandaj më prano mua për të!" Ndërsa Kurani thotë: "O Zot unë ia ndalova gjumin gjatë natës, prandaj më prano mua për të!" Dhe u jepet leja për ndërmjetësim."

(Muhamedi, a.s.)

Ramazani na bashkon gjithmonë në devotshmëri, në braktisje të mëkateve dhe grindjeve, në përputhje me këshillën pejgamberike: "Nëse dikush të fyen, thuaj: Unë jam agjërueshëm."

Ramazani na bashkon me Kuranin, përmes Kuranit dhe rreth Kuranit, sepse është muaji i shpalljes së Kuranit, në një natë të bekuar – Natën e Kadrit.

Ky është muaji që ndërmjetëson për besimtarin. *"Agjërimi dhe Kurani ndërmjetësojnë për robin tek Allahu në Ditën e Gjykimit. Agjërimi thotë: "O Zot, unë ia ndalova ushqimin dhe epshet gjatë gjithë ditës, prandaj më prano mua për të!" Ndërsa Kurani thotë: "O Zot unë ia ndalova gjumin gjatë natës, prandaj më prano mua për të!" Dhe u jepet leja për ndërmjetësim."*

Ky është muaji i faljes, kush e agjëron me besim dhe duke shpresuar shpërblim, do t'i falen mëkatet e kaluara.

Ramazani është muaji i agjërimit, adhurimit, sinqeritetit, besimit dhe afrimit tek Allahu i Plotfuqishëm.

Përktheu nga gjuha arabe: Miftar Ajdini

Burimi:
https://islamonline.net

1 Hadithin e transmeton Ibën Hibbani, ndërsa Albani e ka vlerësuar si hasen (i mirë).

Veçoritë e Ramazanit

Mr. Artan Musliu

Për ta filluar shpalljen e Tij të fundit, Allahu xh.sh. ka bërë përzgjedhjen më të mirë të kohës, vendit dhe bartësit të kësaj shpallje. Kjo shpallje universale filloi pikërisht në muajin Ramazan, në Qabenë e bekuar dhe te Muhamedi a.s..

Allahu xh.sh. është Ai që ka krijuar çdo gjë. Si Krijues Suprem ka bërë edhe veçimin, përzgjedhjen e disa prej krijesave të Tij nga disa të tjera, siç dalloi profetë dhe të dërguar. Ka dalluar vende prej vendeve të tjera, siç dalloi Qabenë nga çdo vend tjetër në tokë, ka dalluar njerëz nga njerëz të tjerë, siç dalloi Muhamedin a.s. nga çdo njeri tjetër. Ky dallim, specifikim ka përfshirë edhe vetë kohën, si një prej shumë krijesave të Allahut xh.sh.. Allahu xh.sh. dalloi orë prej orëve të ditës, si atë të ditës së xhuma. Dalloi ditë prej ditëve, si ditën e Arafatit. Dalloi net prej netëve, si nata e Kadrit. Padyshim se, dalloi muaj prej muajve, siç është muaji Ramazan.

Muaji Ramazan është një muaj i shenjtë, i dalluar prej të gjithë muajve të tjerë, gjithnjë sipas kalendarit lunarë. Kalendar ky, sipas të cilit bëhet edhe përllogaritja kohore në islam. Specifikat, veçoritë e Ramazanit janë në tri aspekte: zbritja e Kuranit, agjërimi, Nata e Kadrit.

Tani do të mundohemi që shkurtimisht të flasim për këto tri specifika të këtij muaji të madhërishëm, dhe rreth asaj se si duhet të përgatitet besimtari për pritjen e këtij muaji.

ZBRITJA E KURANIT

Për ta filluar shpalljen e Tij të fundit, Allahu xh.sh. ka bërë përzgjedhjen më të mirë të kohës, vendit dhe bartësit të kësaj shpallje. Kjo shpallje universale filloi pikërisht në muajin Ramazan, në Qabenë e bekuar dhe te Muhamedi a.s.. Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. thotë: *"Muaji Ramadan, që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga gënjeshtra). E kush e përjeton*

prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni." (El Bekare, 185). Pra, pikërisht në këtë muaj ka filluar shpallja e Kuranit si libër përmbyllës nga ana e Allahut xh.sh. për fenë islame. Padyshim se vetëm ky fakt do të ishte i mjaftuar për t'ia shtuar nderin dhe madhërinë këtij muaji të begatshëm.

AGJËRIMI

Prej veçorive, specifikave të tjera që e bëjnë të dallohet muaji Ramazan nga çdo muaj tjetër është edhe agjërimi. Agjërimi është një prej pesë shtyllave thelbësore të Islamit. Ai është prej adhurimeve individuale, të obligueshme për çdo person të moshës madhore që i përket besimit islam dhe që gëzon shëndet të mirë sa të mund të përballojë agjërimin.

Të agjërosh do të thotë të abstenosh veten tënde, qoftë në aspektin fizik apo mental, nga sistemi i rregullt jetësor dhe, t'i përkushtohesh me tërë qenien tënde shpirtërore Allahut xh.sh., duke synuar kënaqësinë e Allahut dhe arritjen e devotshmërisë. Me anë të abstenimit fizik e kemi për qëllim mospërdorimin e çdo gjëje ushqyese prej mëngjesit e deri në mbrëmje, pavarësisht formës së konsumit të saj, si dhe abstenimin nga çdo marrëdhënie intime apo formë tjetër e vetëkënaqësisë. Ndërsa, me abstenim mental e kemi për qëllim të ndaluarit e vetes nga çdo mendim negativ, paragjykim apo keqkuptim ndaj të tjerëve. Të ndaluarit e vetes nga përdorimi i çfarëdo shprehjeje që nuk përkon me karakterin e myslimanit si dhe përpjekjes maksimale që t'i shmangemi çfarëdo konfrontimi, qoftë verbal apo fizik. E tërë kjo duhet që të bëhet me të vetmin qëllim, për të arritur kënaqësinë e Allahut xh.sh. dhe devotshmërinë ndaj Tij. Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. thotë: *"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."* (El Bekare, 183). Po ashtu, kemi edhe thënien e Profetit a.s., i cili ka thënë: "Agjërimi është mburojë nga epshet, prandaj, asnjëri prej jush mos të ofendoj dhe mos të kacafytet. E nëse dikush e ngacmon apo e ofendon, le të thotë: "Unë jam agjërues."[1] Në lidhje me këtë, kemi edhe transmetimin tjetër që na vije nga Profeti a.s., në të cilin thuhet: "Kush nuk heq dorë nga mashtrimet, dëshmia e rrejshme dhe të vepruarit me të, atëherë, Allahu xh.sh. nuk ka nevojë prej heqjes dorë të tij nga ushqimi dhe pija."[2] Në një transmetim tjetër, Profeti a.s., ka thënë: "Agjërimi nuk është vetëm në heqjen dorë nga ngrënia dhe pirja, por agjërimi është edhe në të hequrit dorë nga fyerja dhe ofendimet. E nëse dikush të ngacmon atëherë thuaj: Unë jam agjërues, unë jam agjërues."[3]

"Nata e Kadrit është më e rëndësishme se njëmijë muaj. Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje. Ajo është paqe deri në agim të mëngjesit."

(Kadër, 3-5)

Siç shihet, edhe nga vetë porositë e Profetit a.s. synimi kryesor i agjërimit nuk është assesi vetëm në të abstenuarit nga ngrënia dhe pirja, por edhe nga sjellja dhe fjalori që përdorim gjatë agjërimit. Ai duhet të jetë i përshtatshëm me vetë natyrën dhe karakterin e besimtarit, e në veçanti gjatë këtij muaji të shenjtë. Këtë më së miri e kuptojmë kur e kemi parasysh thënien e Profeti a.s., që na tregon se prej një shumice të agjëruesve nuk mbetët asgjë prej agjërimit të tyre, përveçse urisë dhe etjes. Kjo pasi që, shpërblimin e kanë humbur duke fyer, sharë dhe duke ofenduar të tjerët.[4]

NATA E KADRIT

Prej specifikave tjera që e dallojnë këtë muaj është edhe vetë Nata e Kadrit. Rreth asaj se kur ndodhet saktësisht kjo natë ka shumë transmetime dhe shumë mendime të dijetarëve. Por, më i sakti është ai se kjo natë ndodhet në dhjetë netët e fundit teke të muajit Ramazan. Për rëndësinë e kësaj nate më së miri na tregon vetë Allahu xh.sh. kur thotë: *"Nata e Kadrit është më e rëndësishme se njëmijë muaj. Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje. Ajo është paqe deri në agim të mëngjesit."* (El Kadër, 3-5). Po ashtu, kemi edhe transmetime të shumta nga Profeti a.s., që na dëshmojnë rëndësinë e kësaj nate. Prej tyre do të përzgjedhim thënien e Profetit a.s. ku thotë: "Me të vërtetë ju ka arritur ky muaj, muaji Ramazan, e në të është një natë më e vlefshme se njëmijë muaj. Kush privohet prej

saj është privuar prej një mirësie shumë të madhe. Nuk do të privohet prej mirësie të saj veçse i privuari."[5]

Këto janë specifikat-veçoritë kryesore që e bëjnë këtë muaj të dallohet prej të gjithë muajve të tjerë. Besimtarit të sinqertë, që është vënë në kërkim të kënaqësisë së Allahut xh.sh. dhe arritjes së devotshmërisë së tij, i takon të jetë i përkushtuar për këtë muaj. Të parapërgatitet fizikisht dhe psiqikish, duke u fokusuar në këto tri specifika kryesore. Të mundohet maksimalisht t'i shfrytëzojë këto tri gjëra gjatë këtij muaji.

Si ta shfrytëzojmë këtë muaj?

Besimtari duhet të jetë i përkushtuar në leximin e Kuranit, me qëllim adhurimi dhe studimi, në të njëjtën kohë. Duke mos e harruar faktin se ky Kuran nuk ka zbritur vetëm për ata që kanë qenë para nesh, por ky Kuran ka zbritur për mbarë njerëzinë. Si i tillë, ai të drejtohet edhe ty. Besimtari duhet të llogaris vetën e tij si pjesë të asaj që përmban Kurani. Andaj, duhet lexuar me një kujdes, përkushtim dhe vëmendje shumë të lartë, duke u munduar që çdoherë të dalë me mësime të reja, të cilat do të duhej të reflektonin në jetën tonë të përditshme. E mbi të gjitha duhet pasur parasysh se kjo është fjalë e Allahut xh.sh., andaj, sa herë që të mallëngjehesh për të të folur Allahu xh.sh. kthehu te Kurani. E sa herë të kesh nevojë t'i flasësh Allahut xh.sh., atëherë drejtohu te namazi dhe lutjet.

Po ashtu, duhet të mundohemi të agjërojmë dhe të mos përdorim justifikime të ndryshme për t'iu shmangur agjërimit. Kjo ngase, edhe sikur të agjëronim tërë jetën tonë, jashtë Ramazanit, nuk do të mund ta kompensonim një ditë të humbur nga agjërimi gjatë Ramazanit. Përveç kësaj, duhet të mundohemi ta ruajmë agjërimin, të mos lejojmë të biem pre e provokimeve të ndryshme që na vijnë nga jashtë, e si shkak i këtyre të humbasim, të zbehim, apo dobësojmë agjërimin. Çdoherë duhet të kemi parasysh faktin se, për këjemi duke agjëruar?

Përderisa nuk ka asgjë më madhështore sesa vetë Krijuesi, për të Cilin edhe agjërojmë, atëherë nuk ia vlen të humbasim këtë agjërim.

Besimtari duhet të angazhohet maksimalisht në kërkim të Natës së Kadrit. Pra, të mundohet të përcjellë shenjat e saj dhe të shtojë maksimalisht adhurimin e tij gjatë këtyre netëve në përpjekje për të gjetur këtë natë. Një gjë të tillë duhet ta bëjë në veçanti në dhjetë netët e fundit teke të Ramazanit. Por, edhe sikur ta kërkonte përgjatë gjithë këtyre dhjetë netëve, apo përgjatë gjithë Ramazanit, nuk do të humbas asgjë. Përkundrazi, do jetë prej fitimtarëve. E në anën tjetër, humbja e saj me të vërtetë është humbje e madhe.

Ashtu, siç e kemi cekur në fillim, Allahu xh.sh. ka bërë përzgjedhjen e çasteve dhe orëve nga koha e kësaj bote. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe brendapërbrenda Ramazanit. Andaj, ka disa kohë që janë më specifike, më të duhura për adhurime, në veçanti për lutje. Kështu, do mundohemi t'i cekim këto kohë të arta dhe shumë të çmuara të Ramazanit.

Prej kohëve më të mira apo prej orëve më të mira të Ramazanit janë tri: koha pas namazit të sabahut, koha para iftarit dhe koha e syfyrit.

- ***Koha pas namazit të sabahut***, kjo është për të cilën ka bërë lutje vetë Profeti a.s. që të jetë prej kohëve të begatshme.[6] Andaj duhet ta shfrytëzojmë maksimalisht këtë kohë. Shfrytëzimi bëhet me përmendjen dhe rikujtimin e Allahut xh.sh., dhe vazhdon ashtu deri në lindjen e diellit. Pas lindjes së diellit përmbyllet me faljen e namazit të duhasë. Një gjë të tillë, na e mëson vetë Profeti a.s., kur thotë: "Kush e fal

namazin e sabahut në grup, pastaj ulet dhe e përmend Allahun xh.sh., derisa të lind dielli dhe fal dy rekate namaz, do të ketë shpërblimin e një haxhi dhe umreje."[7]

- ***Koha para iftarit***, kjo kohë është shumë e vlefshme për besimtarët, pasi në këtë kohë lutja e agjëruesit nuk refuzohet. Pra, ajo është prej kohëve në të cilat pranohen lutjet. Këtë na e dëshmon edhe vetë Profeti a.s., kur thotë: "Tre personave nuk iu refuzohet lutja: agjëruesit deri në iftar, imamit të drejtë dhe atij ndaj të cilit është bërë padrejtësi."[8] Në një transmetim tjetër, Profeti a.s., ka thënë: "Agjëruesit nuk i refuzohet lutja në iftarin e tij."[9] Po ashtu, kemi edhe transmetimin tjetër që dëshmon rëndësinë e kësaj kohe, ku Profeti a.s. thotë se është prej kohëve kur Allahu xh.sh. liron besimtarët prej zjarrit të Xhehenemit. Në lidhje me këtë Profeti a.s. ka thënë: "Allahu liron (robër) nga zjarri dhe atë për çdo iftar."[10]

- ***Koha para syfyrit dhe vetë koha e syfyrit***, janë kohë shumë e begatshme. E një gjë të tillë e dëshmon vetë Profeti a.s., kur thotë: "*Syfyri është begati që është dhuruar nga Allahu xh.sh., andaj mos e humbisni.*"[11] Në një transmetim tjetër thuhet se begatia është në tri gjëra dhe njërën prej tyre e ka përmendur syfyrin.[12] Prandaj, mos ta nënvlerësojmë këtë kohë, le të mundohemi ta shfrytëzojmë sa më shumë që të kemi mundësi.

Ramazani është duke u afruar, ashtu siç e pamë nga ajo që u cek më lartë dhe nga ajo që na ka mësuar Profeti a.s., agjërimi është i pakrahasueshëm dhe i pabarabartë me adhurimet e tjera për shkak të vlerës, të shpërblimit dhe të ndikimit të madh që ka. Në lidhje me këtë, Profeti a.s., në një transmetim thotë: "*Agjërimi është i pakrahasueshëm.*"[13] Në një transmetim tjetër, ai a.s. thotë: "*Agjërimi nuk baraspeshohet me* asgjë."[14] Agjërimi po ashtu është mbrojtje prej cytjeve të djallit, zjarrit të Xhehenemit, po ashtu edhe prej vetë cytjeve dhe veseve të liga të njeriut. Këtë më së miri na e dëshmon thënia e Profetit a.s., ku thotë: "*Me të vërtetë, agjërimi është një perde mbrojtëse.*"[15]

E deri në arritjen e tij, ne nuk na mbetët gjë tjetër vetëm se të lutemi që Allahu xh.sh. të na mundësojë arritjen e tij, të na mundësojë agjërimin e tij dhe të na mundësojë shfrytëzimin maksimal të veçorive të tij!

---

1 Transmetimin e shënon Abdurrezaku, trans. nr. 7893, Nesaiu, trans. nr. 2538, e ndërsa ky është prej transmetimeve të vërteta.

2 Transmetimin e shënon Imam Buhariu, trans. nr. 1804.

3 Transmetimin e shënon Imam Ibën Hibani dhe Ibën Huzjeme në Sahihun e tyre, e ndërsa ky është sipas kushteve të Imam Buhariut dhe Muslimit.

4 Transmetimin e shënon Ibën Maxheh, trans. nr. 1690, Nesaiu, trans. nr. 3250, e po ashtu edhe Imam Ahmedi 2/441, si dhe të tjerë.

5 Transmetimin e shënon Ibën Maxheh, trans. nr. 1690, Nesaiu, trans. nr. 3250, e po ashtu edhe Imam Ahmedi 2/441, si dhe të tjerë.

6 Hadithin e transmeton Imam Ebu Davudi, trans. nr. 2606, e po ashtu e transmeton edhe Imam Tirmidhiu, trans. nr. 1212, si dhe të tjerë.

7 Hadithin e shënon Imam Tirmidhiu, trans. nr. 586, po ashtu edhe Imam Bejhakiu, trans. nr. 9762.

8 Transmetimin e shënon Imam Tirmidhiu, trans. nr. 3522 e ndërsa në lidhje me të thotë se është i mirë dhe i vërtetë, po ashtu këtë transmetim e shënon edhe Imam Ahmedi, trans. nr. 9366, si dhe të tjerë.

9 Transmetimin e shënon Imam Ahmedi, trans. nr. 9793, e ndërsa Zejni në Musned, 9/411, thotë se është prej transmetimeve të vërteta, pasi që ngjashëm me të e kanë shënuar edhe Ibën Ebu Shejbeh dhe Ibën Hibani.

10 Transmetimin e shënon Ibën Maxheh, trans. nr. 1633, e ndërsa Imam Albani në librin Sahih Ibën Maxheh, 1/275, thotë se ky transmetim është i mirë dhe i vërtetë.

11 Transmetimin e shënon Imam Nesaiu, trans. nr. 2133, e ndërsa Imam Albani në Sahih et Tergib e shënon si të vërtetë, trans. nr. 1069.

12 Këtë transmetim e shënon Taberaniu në *El Kebir*, trans. nr. 6127.

13 Hadithin e transmeton Imam Nesaiu në Librin mbi Agjërimin, trans. nr. 2190, e po ashtu edhe Imam Ahmedi në Musnedin e tij, trans. nr. 21636. E ndërsa Imam Albani e shënon si transmetim Sahih në editimin mbi librin e Imam Nesaiut.

14 Hadithin e transmeton Imam Nesaiu në Librin e tij mbi Agjërimin, trans. nr. 2193, e po ashtu e shënon edhe Imam Ibën Hibani ndërsa Shuajb el Arnauti thotë se zinxhiri transmetues i tij është i vërtetë. Këtë hadith si të vërtetë e shënon edhe Imam Albani në editimin e tij mbi librin e Imam Nesaiut.

15 Transmetimin e shënon Imam Muslimi, trans. nr. 1151, e po ashtu edhe Imam Ahmedi, trans. nr. 9633, si dhe të tjerë.



Ah, sikur i tërë viti të jetë Ramazan!

Mumin Shehu

Transmetohet nga Abdullah ibën Mesud el Gafari r.a., të ketë thënë: " E kam dëgjuar Pejgamberin a.s., duke thënë: "Sikur ta dinin besimtarët e ymetit tim se çfarë (dobi-mirësi) ka në Ramazan, do të dëshironin që tërë viti të jetë Ramazan."[1]

Nisur nga ky hadith fisnik i Pejgamberit a.s., shohim se ai po ia bën të qartë ymetit të tij vlerën e madhe, begatitë dhe mirësitë që posedon muaji i bekuar Ramazan. Në këtë hadith, shprehja e Pejgamberit a.s., "Sikur ta dinin...", duhet që të na nxisë që të mësojmë se çfarë e bën këtë muaj kaq madhështor dhe të begatë. Nuk ka dyshim se udhëzimi më i mirë në rruzullin tokësor është udhëzimi i Muhamedit a.s., vulës së gjithë pejgamberëve. Ja disa prej margaritarëve të këtij muaji të bekuar.

VLERA E RAMAZANIT PËR SHKAK TË IBADETIT TË VEÇANTË QË KRYHET NË TË

Agjërimi është ibadet, i cili nuk mund të barazohet me asgjë. Ebu Umame el Bahili r.a., tregon: "I thashë të Dërguarit të Allahut, më urdhëro për një vepër që më shpie në Xhenet.

Ai më tha: "Agjëro, sepse nuk ka asgjë tjetër të barabartë me agjërimin."[2]

Nga Ebu Hurejra r.a., transmetohet se Pejgamberi a.s., ka thënë: "Kush prish agjërimin e një dite të Ramazanit pa ndonjë arsye dhe pa qenë sëmurë, nuk do të mund ta plotësojë (zëvendësojë) atë edhe sikur të agjërojë tërë jetën."[3]

Nëse kështu është vlera e një dite të Ramazanit, atëherë si do të jetë shpërblimi për tërë muajin që përbëhet nga 29 apo 30 ditë! Ebu Hurejre r.a., transmeton se Pejgamberi a.s., ka thënë: "Çdo vepër të mirë që kryen i biri i Ademit shpërblimi i saj shumëfishohet nga dhjetë deri në shtatëqind fish. Allahu i Lartësuar thotë: Përveç agjërimit, ai është për Mua dhe vetëm Unë e jap shpërblimin për të, sepse ai që agjëron lë dëshirat e tij dhe ushqimin vetëm për Mua (për hirin Tim)..."[4]

VLERA E RAMAZANIT PËR SHKAK TË KURANIT

Nuk ka dyshim se mirësia kryesore që bën që ky muaj të jetë me vlerë shumë të madhe është se ky është muaji në të cilin Allahu i Gjithëmëshirshëm nga lart zbriti fjalët e Tij, Kuranin. Pra, zbriti udhëzimin, dritën, mëshirën e Tij. Zoti i Madhëruar thotë: *"Muaji Ramazan që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra)..."* (El Bekare, 185). Kurani fisnik është një fjalë e lartë hyjnore dhe dhurata më e madhe e dërguar nga Allahu i Madhëruar për njerëzimin. Lidhur me këtë, Pejgamberi ynë a.s., ka thënë: "Epërsia e Fjalës së Allahut ndaj fjalëve të krijesave, është si epërsia e Allahut ndaj robërve të Tij." (Darimi, Fedailul Kuran, 6).

Poeti Xhelaleddin Rumiu ka thënë: "Fjalët e Kuranit mund të shkruhen me një sasi boje, ndërsa për të fshehtat e tij nuk mjaftojnë as detet dhe as oqeanet pa anë e pa fund."

Pra, muaji Ramazan është muaji i Kuranit. Transmeton se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Agjërimi dhe Kurani do të ndërmjetësojnë për robin në Ditën e Kiametit. Agjërimi do të thotë: "O Zot, gjatë ditës e privova (e ndalova) nga ushqimi dhe epshet, më jep leje të ndërmjetësojë për të." Kurani do të thotë: "O Zot, gjatë natës e privova nga gjumi, më jep leje të ndërmjetësojë për të." Tha: Kështu do t'u jepet leje të ndërmjetësojnë." (Transmeton Imam Ahmedi 6589).

> *"Një umre e kryer në Ramazan ka vlerën e një haxhi."*
> (Muhamedi, a.s.)

Që të dy këta ndërmjetësues, Kuranin dhe agjërimin, i posedon Ramazani. Që Nata e madhe e Kadrit të ketë vlerë aq të madhe, pikërisht mirësia kryesore është për shkak të zbritjes së fjalëve të Allahut të Lartmadhëruar në të. Allahu i Madhëruar thotë: "*Ne e zbritëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit. E ç'të bëri ty të dish se ç'është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj! ...*" (El Kadër, 1-3).

Lum ymeti i Muhamedit a.s. për këtë begati dhe dhuratë të madhe nga Allahu i Gjithëmëshirshëm! Kjo është nata, në të cilën ibadeti *është më i mirë* se ibadeti në periudhë prej një mijë muajsh – që është 83 vjet dhe katër muaj. Kjo natë madhështore është Nata e Kadrit, madhështia dhe vlera shpirtërore e së cilës i tejkalon të kuptuarit njerëzor. Se kjo natë është në muajin Ramazanit na dëshmon hadithi vijues. Ebu Hurejre r.a., ka thënë: "Kur hyri muaji Ramazan, Pejgamberi i Allahut ka thënë: "Ju erdhi muaji Ramazan, muaji i bekuar. Allahu ju ka urdhëruar të agjëroni në të. Në këtë muaj hapen dyert e Xhenetit, kurse mbyllen dyert e Xhehenemit. Në këtë muaj shejtanët mbyllen. Në këtë muaj është nata e cila është më e mirë se një mijë muaj. Kush privohet nga kjo e mirë, ai është vërtet i privuar." (Nesaiu, nr. 2105).

Nga këto argumente pamë se ajo që i jep vlerë të madhe muajit të bekuar Ramazan është zbritja e Kuranit, fjalës së Allahut të Madhëruar.

VLERA E RAMAZANIT PËR SHKAK TË PËRFITIMEVE TË MËDHA TË BESIMTARËVE NË TË

Muaj në të cilin shumëfishohen shpërblimet – Allahu Mëshirëplotë i ka bërë një nder të madh këtij ymeti me muajin e bekuar Ramazan. Veprat e mira, si: agjërimi, namazi, dhikri, sadakaja, leximi i Kuranit etj., në këtë muaj shpërblehen shumë më shumë sesa në muajt e tjerë.

Transmetohet se Pejgamberit a.s., ka thënë: "*Kushdo që i afrohet Allahut me një vepër të mirë në këtë muaj është sikur ta ketë kryer një farz në muajt e tjerë, ndërsa kush e kryen një farz në ketë muaj është sikur t'i ketë kryer shtatëdhjetë farze në muajt e tjerë.*"[5]

Sa u përket adhurimeve të tjera, shpërblimet e tyre mund të jenë të njohura, ato shumëfishohen nga dhjetë deri në shtatëqind herë ose më shumë, sipas dëshirës së Allahut. Por, Allahu i Madhëruar ka veçuar agjërimin. "*Përveç agjërimit, ai është për Mua dhe vetëm Unë e jap shpërblimin për të...*", përderisa shpërblimi i agjërimit nuk mund të llogaritet nga askush përveç Allahut të Lartësuar. Ai nuk ia ka lënë (përcaktimin e shpërblimit) as melaqeve të Tij, por shpërblimin e tij e ka marrë përsipër Vetë. E s'ka dyshim se robi kurrë nuk do të dëshpërohet për ndonjë mangësi apo padrejtësi, kur Allahu Bujar përmbush atë që ka marrë për sipër.

Transmetohet se Pejgamberit a.s. ka thënë: "Një umre e kryer në Ramazan ka vlerën e një haxhi." Në një transmetim tjetër: "Sa një haxh i kryer me mua." (Buhariu nr. 1863 Muslimi nr. 1256).

Muaj në të cilin pranohen lutjet – Ajo që besimtarët duhet ditur se çka përmban Ramazani, është edhe pranimi i lutjeve në këtë muaj. Allahu i Madhëruar thotë: *"E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua."* (El Bekare,186). Ky ajet kuranor vjen pas ajetit mbi agjërimin dhe muajin Ramazan. Me këtë aludohet në faktin se muaji Ramazan është ndër kohët e bekuara për t'iu lutur Allahut xh.sh.. Ebu Hurejra r.a. transmeton se Pejgamberi i Allahut a.s., ka thënë: "Agjëruesit nuk i refuzohet duaja." (Musnedi, 9793).

Gjithashtu transmetohet nga Ebu Hurejra r.a., se Muhamedi a.s., ka thënë: "Tre njerëzve nuk u refuzohet lutja: udhëheqësit të drejtë, agjëruesit në momentin e iftarit, lutja e të dëmtuarit (të keqtrajtuarit), e cila ngrihet mbi re, i hapen dyert e qiellit, dhe Zoti i Madhëruar thotë: "Pasha madhështinë Time, patjetër do të të ndihmoj, qoftë edhe pas një kohe!" (Tirmidhiu, nr.2525).

Muaji në të cilën besimtari mund të shpëtojë nga zjarri i Xhehenemit – Synimi i besimtarit me largimin dhe distancimin e tij nga haramet është shpëtimi i tij nga Zjarri. Rastin më të volitshëm për këtë e kemi në Ramazan. Pejgamberi a.s., ka thënë: "Natën e parë të muajit Ramazan prangosen djajtë dhe prijësit e tyre prej xhinëve, ndërsa mbyllen dyert e Zjarrit dhe nuk hapet derë prej tij; hapen dyert e Xhenetit e nuk mbyllet derë prej tij, dhe thërret një thirrës: "O ti që dëshiron mirësinë, përkushtoju Allahut duke iu bindur Atij, e, o ti që dëshiron të keqen, ndalo nga veprimi i saj, dhe Allahu liron robër nga zjarri edhe atë çdo natë."[6]

Gjithashtu Bejhekiu, në fund të hadithit, që transmeton nga Ibën Mesudi r.a. shënon: "Allahu për çdo natë të Ramazanit gjatë iftarit liron gjashtëdhjetë mijë njerëz nga zjarri. E kur vjen Bajrami i Ramazanit (Fitër Bajrami), liron tridhjetë herë më shumë seç ka liruar gjatë gjithë Ramazanit."[7]

Një hadith që e transmeton Ebu Seid el Huduri r.a., thotë se Pejgamberi a.s,. ka thënë: "Ai që agjëron një ditë në rrugën e Allahut, Allahu do t'ia largojë fytyrën nga Zjarri për shtatëdhjetë vjet." (Muslimi, 1153).

Kjo është për agjërimin nafile jashtë muajit Ramazan, e si qëndron puna me shpërblimin madhështor për atë që agjëron vetëm një ditë farz të muajit të madh Ramazan?! Po agjërimi i tridhjetë ditëve të Ramazanit?!

Fitimi i Xhenetit – Besimtari me veprat e tij të mira shpreson premtimin e Allahut, Xhenetin e Tij të përhershëm. Kur Pejgamberi a.s. e këshilloi një njeri për agjërim, u shpreh: "Agjëroje muajin e sabrit (durimit)." (Transmeton Ebu Davudi, 1256), duke aluduar në muajin e madh Ramazan. Ndërsa Allahu i Madhëruar për durimtarët thotë: "*… durimtarëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë (pa llogari)!*" (Zumer, 10). Ndërsa, në një ajet tjetër, për frytin e durimit, Allahu i Madhëruar thotë: *"(Përfundimi i mirë i tyre është) Xhenete të Adnit (vende të përjetshme) ku do të hyjnë ata, edhe prindërit, gratë dhe fëmijët e tyre të cilët kanë qenë vepërmirë, ata do t'i vizitojnë engjëjt duke hyrë në secilën derë. (U thonë): Selamun alejkum, me durimin tuaj gjetët shpëtimin; sa përfundim i lavdishëm është ky vend.*" (Err Rrad, 24-25).

Muaji i pastrimit nga të gjitha mëkatet – Tjetra që duhet të dimë se çfarë përmban prej mirësive ky muaj i bekuar është falja e mëkateve tona. Transmetohet se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: "*...Ramazani deri në Ramazanin tjetër, janë falje e asaj që ka ndodhur mes tyre (falje mëkatesh), nëse eliminohen (qëndrohet larg) mëkatet e mëdha.*" (Transmeton Muslimi, nr.233).

Ebu Hurejra r.a., transmeton se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: "Kush e agjëron Ramazanin me bindje të plotë, duke llogaritur shpërblimin nga Allahu, atij i falen të gjitha mëkatet e bëra më parë." (Transmeton Buhariu, 4/99 dhe Muslimi, nr.759).

Përpos agjërimit, edhe *falja e nafileve* në këtë muaj i fshinë të gjitha mëkatet. Transmetohet prej Abdurrahmanit r.a., se Pejgamberi i Allahut a.s., njëherë, duke folur për muajin Ramazan, ka thënë: "Ky është muaji në të cilin Allahu ua ka përcaktuar agjërimin, kurse unë ua kam bërë traditë që natën të falni nafile gjatë këtij muaji. Kush agjëron dhe natën fal (namaz) gjatë këtij muaji, duke besuar dhe shpresuar se për këtë do të shpërblehet, do të pastrohet nga mëkatet sikur tash është lindur nga nëna." (Ibën Maxheh, 1328).

Gjithashtu edhe Nata e Kadrit, në këtë muaj të madh, i fshinë të gjitha mëkatet. Personi që e humb këtë natë, vërtet ka humbur një të mirë të madhe, e nuk ka mundësi me e humb atë, veçse i ndaluari prej saj. I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: "Kush falet gjatë Natës së Kadrit me besim (me iman) dhe duke shpresuar shpërblimin, atij do t'i falen mëkatet e mëparshme." (Transmeton Buhariu, 4/217 dhe Muslimi, 759).

Sipas këtyre argumenteve, agjërimi i Ramazanit, falja nafile gjatë netëve të tij, e sidomos gjatë Natës së Kadrit i fshijnë të gjitha mëkatet, kështu që ne, me mëshirën e Allahut të Madhëruar, në Fitër Bajram fillojmë një jetë të re pa mëkate. Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a., se i Dërguari a.s., u ngjit në minber dhe tha: "Amin! Amin! Amin!" Dikush tha: "O i Dërguari i Allahut! Ti u ngjite në minber dhe the: "Amin! Amin! Amin!" (përse e the këtë)?" Ai a.s. tha: "Erdhi Xhibrili a.s. e më tha: "Kush e arrin muajin Ramazan, e nuk i falen mëkatet, duke meritуar kështu Zjarrin, atë e largoftë Allahu (nga Mëshira e Tij)! Thuaj: Amin! Atëherë thashë: Amin!…"[8]

Nga hadithi kuptohet se besimtarit i është ofruar një lehtësi dhe shanse e madhe, që përmes agjërimit, namazit, veprave të mira në këtë muaj të madh, ta arrijë me lehtësi mëshirën e Allahut dhe faljen e Tij. Dijetarët thonë se fjala *"fursah – shans"* është diçka që vjen një mundësi apo rast i volitshëm, që po ikën, nuk kthehet më kurrë. Siç janë ditët, rinia, Ramazani, jeta etj., të cilat ikën dhe nuk kthehen më. Andaj, nëse besimtari në këtë muaj nuk e arrin faljen e Allahut të Gjithëmëshirshëm, atëherë vallë në cilin muaj mund ta arrijë atë!

Pra, ndër çështjet që posedon muaji Ramazan, e që ia ngritin shumë vlerën e tij, është fitimi me lehtësi i faljes së Allahut Mëshirëplotë. E nëse të falë Allahu, atëherë ke shpëtuar nga Zjarri dhe je futur në Xhenetin e Tij të përhershëm.

Nga këto transmetime, perla të të Dashurit tonë, të Muhamedit a.s., mësojmë diç nga ajo, përse ai tha: "Sikur ta dinin besimtarët e ymetit tim se çfarë (dobi-mirësi) ka në Ramazan, do të dëshironin që tërë viti të jetë Ramazan." (Sahih Ibën Huzejme, v. 2 f. 190, nr. 1886.)

1 Sahih Ibën Huzejme, v. 2 f. 190, nr. 1886.
2 Transmeton Nesaiu (4/165), Ibën Hibani (faqe 232) dhe Hakimi (1/321). Senedi i këtij hadithi është i saktë.
3 El Hafidh el Mundhiri, *Et Tergib ve et Terhib*, f.205, nr.295. Hadithi daif.
4 Buhariu, nr.7492 dhe Muslimi, nr.1151.
5 Ibën Huzejme në Sahih nr. 1887. Albani e ka vlerësuar të dobët në librin e tij "*Eddaifeh uel Meudua*" 2-263.
6 Tirmidhiu (682); Ibën Maxheh (1642) dhe Hakimi (1532). Hadith i mirë, sipas Imam Albanit, në "Sahihul-Xhami" (759).
7 El Hafidh el Mundhiri, *Et Tergib ve et Terhib*, f.204, nr.292. Hadithi daif.
8 Transmeton Ibën Huzejme (3/192), Ahmedi (2/246, 254) dhe Bejhakiu, 4/204); nga Ebu Hurejra. Ky hadith është i saktë dhe esenca e tij gjendet në Sahihun e Muslimit, 4/1978.

Mukabeleja në Ramazan

Dr. Azmir Jusufi

ÇKA ËSHTË MUKABELEJA?

Mukabeleja është leximi apo këndimi me zë i Kuranit në xhami, duke u lexuar (kënduar) nga një apo disa hafëzë të Kuranit, zakonisht gjatë Ramazanit. Është një lexim i përbashkët me zë i Kuranit gjatë Ramazanit,, para ose pas namazit, e që në përkthim nga arabishtja do të thotë "mbledhje, tubimi". Lexohet një xhuz ose 20 faqe çdo ditë, ashtu që të lexohet i tërë Kurani deri në Bajram.

Tevfik Muftiqi, përmend disa kuptime të fjalës "mukabele", ndër të cilat veçojmë: *pritje, mirëseardhje, takim, mbledhje, intervistë, audiencë, bisedë, krahasim, rreshtim* etj..[1]

Në "*Enciklopedinë turke të Islamit*", përmendet se fjala "mukabele" në terminologjinë fetare ka një kuptim të dyfishtë: e para i referohet traditës së leximit të Kuranit, ndërsa e dyta i referohet metodës së verifikimit të hadithit të përdorur në shkrimin e hadithe. Kur bëhet fjalë për hadithin, termi *mukabele* i referohet metodës me të cilën nxënësit verifikuan hadithet e shkruara që dëgjuan nga mësuesit e tyre duke i krahasuar hadithet që ata shkruanin me hadithet origjinale të regjistruara nga mësuesi i tyre. Kjo metodë më vonë u pranua nga studiuesit e hadithit si kusht për pranimin e hadithe të shkruara, por jo të memorizuara.[2]

Mukabeleja zakonshëm lexohet në tri periudha kohore: pas sabahut, pas drekës ose pas namazit të ikindisë. Praktika më e përhapur është leximi i mukabeles pas namazit të ikindisë. Mukabeleja lexohet nga imamët, hafëzët dhe ata që dinë dhe janë në gjendje të lexojnë dhe shqiptojnë siç duhet dhe saktë Librin e Allahut.

Mukabeleja është leximi apo këndimi me zë i Kuranit në xhami, duke u lexuar (kënduar) nga një apo disa hafëzë të Kuranit, zakonisht gjatë Ramazanit.

Është nder i madh të dish leximin e drejtë të Kuranit. Po ashtu, ata që vijnë për të dëgjuar dhe ndjekur leximin e mukabeles nëpër xhami i pret një shpërblim i madh, edhe pse janë të paktë ata që duan të vijnë për ta dëgjuar këndimin e Kuranit në xhami.[3]

VLERA E LEXIMIT TË KURANIT DHE E MËSIMIT TË TË TJERËVE

Në *Sahihun* e Buhariut është shënuar nga Othman b. Afani r.a., se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: "Më i miri prej jush është ai që e mëson leximin e Kuranin – e studion Kuranin – dhe pastaj ua mëson atë të tjerëve."

Në dy *Sahihet* – nga Buhariu dhe Muslimi – është shënuar nga Aisheja r.a., se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: "Ai që e lexon Kuranin me përpikëri do të jetë në shoqërinë e shkruesve fisnikë dhe të virtytshëm, ndërsa ai që lexon Kuranin dhe pastaj ndalet dhe ndjen vështirësi gjatë leximit, do të ketë dy shpërblime: njëri shpërblim për leximin e Kuranit dhe tjetri për vështirësinë që ndien gjatë leximit të tij."

Muslimi transmeton nga Ebu Umame r.a., se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: "Lexojeni Kuranin, sepse ai (Kurani) do të vijë në Ditën e Gjykimit si ndërmjetës për ata që e lexojnë atë."

LEXIMI I KURANIT – MUKABELEJA NË RAMAZAN

Kurani është shpallur në muajin Ramazan, prandaj muaji Ramazan quhet edhe muaji i Kuranit. Të gjithë myslimanët i përkushtohen më intensivisht leximit të Kuranit. Gjatë atij muaji, i Dërguari i Allahut a.s., e lexoi Kuranin para melaqes Xhibril a.s., i cili e dëgjoi në këtë mënyrë. Kjo është arsyeja pse tradita jonë e leximit të mukabeles bazohet në faktin se herë pas here është e nevojshme të lexohet Kurani para dikujt që është më i ditur dhe që mund të na dëgjojë dhe të na korrigjojë gabimin tonë eventual.

Leximi në grup i Kuranit është një praktikë e rrënjosur thellë në traditën e myslimanëve në mbarë botën, duke përfshirë traditën e myslimanëve shqiptarë dhe boshnjakë, veçanërisht gjatë muajit Ramazan. Traditat autentike përmendin vlera dhe përparësi të shumta të leximit (mësimit) në grup, gjë që stimulon afirmimin e mëtejshëm të kësaj praktike të bukur. Ata që marrin pjesë janë të zhytur në një atmosferë dhe ambient të veçantë, që u lejon atyre të përjetojnë relaksim shpirtëror, të mendojnë mbi mesazhet e fjalës së Allahut xh.sh., dhe të zbulojnë e të thellohen në njohuri të reja shkencore.[4]

Përfitimet e leximit në grup reflektohen edhe në faktin se të pranishmit, përveç leximit të Kuranit me radhë, dëgjojnë njëri-tjetrin. Dëgjimi është gjithashtu një lloj ibadeti për të cilin Pejgamberi, a.s., ka thënë: "Kushdo që dëgjon vetëm një ajet nga libri i Allahut, ai do të jetë dritë për të."[5]

Allahu xh.sh., në ajetet 29 dhe 30 të sures Fatir thotë: *"Ata që lexojnë librin e Allahut, e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e haptazi, ata e shpresojnë në një fitim që kurrë nuk humbet. Që Ai (Allahu) do t'ju plotësojë shpërblimin e tyre, e edhe do t'ju shtojë nga mirësia e Tij, vërtet Ai është mëkatfalës dhe shumë mirënjohës."* (Fatir, 29-30). Ibën Kethiri, duke i komentuar këto ajete, thotë se kjo u referohet recituesve të Kuranit dhe se ata do të kenë një shpërblim më të madh se sa e meritojnë dhe se do të marrin një shpërblim që as nuk e prisnin.[6]

Për rëndësinë e recitimit të Kuranit gjatë Ramazanit flet edhe veprimi i Malik ibën Enesit r.a., i cili ishte një nga dijetarët më të famshëm të hadithit të kohës së tij. Kur vinte Ramazani, ai braktiste studimin e hadithit dhe shoqërimin me dijetarët, edhe pse edhe këto ishin vepra të mira të zgjedhura, dhe fokusohej vetëm në leximin dhe studimin e Kuranit.

MUKABELEJA - NGA MUHAMEDI A.S. DERI TE NE

Në një hadith të transmetuar nga Abdullah ibën Mesudi r.a., Muhamedi a.s., ka thënë: "Kush lexon një shkronjë nga Libri i Allahut (Kurani), do të ketë një të mirë për të, e që një vepër e mirë shpërblehet dhjetëfish. Nuk po them që 'elif lam mim' është një shkronjë, por "elifi" është shkronjë, "lami" është shkronjë dhe "mimi" është shkronjë."[7]

Ebu Hurejra r.a., transmeton se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: "Askush nuk mblidhet në një nga shtëpitë e Allahut për të lexuar Librin e Allahut dhe për ta mësuar mes tyre, e që mos të zbret mbi ta qetësia, t'i mbërthejë mëshira dhe t'i

mbulojnë melaqet dhe Allahu xh.sh., i përmend tek ata që janë tek Ai (melaqet)."[8]

Duke e dëgjuar mukabelen, ne në fakt krahasojmë njohuritë tona, mësimet tona me leximin e imamit, e kalojmë ditën e Ramazanit në ibadet dhe kujtojmë takimin – "makabelen" e Pejgamberit a.s., me melaqen Xhibril në Ramazan, kur Xhibrili e dëgjoi atë duke lexuar Kuran. Ramazani është pasuruar në mbarë botën me shumë ngjarje që e gjallërojnë shpirtin e besimtarit. As xhematet tona nuk bëjnë përjashtim. Edhe në Kosovë, Ramazani pasurohet me përmbajtje të rregullta, disa prej të cilave, si mukabeleja, janë specifike për rajonet tona. Secila prej këtyre përmbajtjeve është jashtëzakonisht domethënëse në vetvete dhe i merr rrënjët thellë nga burimet e mësimeve islame.

Në kohën kur librat kopjoheshin me dorë dhe kështu shumëzoheshin, mukabeleja ishte akti i krahasimit të veprës origjinale me kopjen dhe korrigjimit të ndonjë gabimi. Gjatë kopjimit, një dorëshkrim vendosej pranë një tjetri dhe kur krahasohej, një person lexonte nga kopja dhe ulej përballë tjetrit që do të ndiqte nga origjinali. Në këtë mënyrë, çdo përshkrim do të krahasohej me origjinalin.

Por lind pyetja, çfarë po krahasojmë ne në të vërtetë me mukabelen? I krahasojmë njohuritë tona, leximin tonë me leximin e imamit, texhvidin e vetë me texhvidin e lexuesit të Kuranit. Kush di të lexojë vetë, le të lexojë vetë, por le ta shqyrtojë veten edhe përmes mukabeles. Përveç kësaj, ne e kalojmë ditën e Ramazanit në ibadet dhe kemi një shpërblim të jashtëzakonshëm për qëndrimin në xhami, mësimin dhe dëgjimin e tekstit kuranor.

Tradita e leximit të mukabeles u themelua duke u bazuar në leximin e Kuranit të Pejgamberit a.s., para Xhibrilit a.s., gjatë muajit Ramazan, kurse leximi i Kuranit është një ibadet me vlerë të veçantë. Fjala *kiraèt*, e cila në gjuhën origjinale shënon këtë akt, ka dy kuptime themelore: kuptimi i pari është ideja e mbledhjes ose bashkimit, ndërsa kuptimi i dytë është nxjerrja e diçkaje në mënyrë kohore-hapësinore, në mënyrë të kufizuar.

Në praktikë, kjo sigurisht konfirmon fenomenin e tekstin kuranor që të bashkojë njerëzit, por, gjithashtu, konfirmon dinjitetin njerëzor, përkatësisht e nderon besimtarin për futjen e të folurit të përhershëm të Zotit në një dimension të kufizuar kohor-hapësinor përmes bukurisë së zërit dhe intelektit të tij.

Natyrisht, leximi i Kuranit nuk është një akt ibadeti që lidhet vetëm me kolektivin dhe vetëm me hapësirën e xhamisë. Muhamedi a.s., ka thënë se shtëpia në të cilën lexohet Kurani, shkëlqen për banorët e qiellit ashtu siç shkëlqejnë yjet për banorët e tokës. Dhe është shumë bukur të kesh momentin tënd, të fshehur, mukabelen tënde, edhe nëse nuk i referohet e gjithë xhuzit të Kuranit në ditë. Muhamed Ikbali shkroi se babai i tij e rriti atë sipas një parimi: "Lexoje Kuranin sikur të shpallet ty!" Dhe pikërisht ky është mësimi i kësaj këshille të thjeshtë: përpiqu të përjetosh çdo fjalë dhe çdo mesazh si fjalim dhe dhuratë të Zotit që ju drejtohet drejtpërdrejt juve.[9]

Prandaj, mukabeleja është e bazuar dhe aludon në ato "mukabele" të para - takimet e të Dërguarit të Allahut a.s., me Xhibrilin a.s., me qëllim të përsëritjes së Shpalljes. Prandaj, le t'i kujtojmë këto takime të Pejgamberit a.s., me Xhibrilin a.s., "mukabeleve" të para sa herë që jemi prezentë në mukabelet tona.

Mirëpo, mukabeleja ka edhe një simbolikë tjetër më të lartë. Me të aludohet për dëgjimin e Pejgamberit a.s., nga melaqja Xhibril a.s., në Ramazan. Ibën Abasi r.a., ka thënë: "I Dërguari i Allahut a.s., ishte më fisniku i njerëzve dhe ishte më fisniku në muajin Ramazan, sepse Xhibrili vinte tek ai çdo natë dhe e dëgjonte duke lexuar Kuran derisa të kalonte Ramazani. Dhe kur Xhibrili vinte tek ai, ai do të ishte më fisnik dhe më i shpejtë në të mirë se era që lëshohet."[10]

Prandaj, mukabeleja është e bazuar dhe aludon në ato "mukabele" të para - takimet e të Dërguarit të Allahut a.s., me Xhibrilin a.s., me qëllim të përsëritjes së Shpalljes. Prandaj, le t'i kujtojmë këto takime të Pejgamberit a.s., me Xhibrilin a.s., "mukabeleve" të para sa herë që jemi prezentë në mukabelet tona.[11]

1 Tevfik Muftiq, *Arapsko-bosanski rječnik*, (Sarajevë, El Kalem, 2004), 1164.

2 https://www.islam.ba/pojmovnik/m/mukabela.

3 https://mojdzemat.com/sta-je-to-mukabela/.

4 Halil Mehtiq, „Grupno učenje Kur'ana", *Glasnik* nr. 5-6, (Sarajevë, 2015), 465.

5 Hadithin e shënojnë Ahmedi në *Musnedin* e tij, hadithi nr. 8. /138 dhe Ed Darimiu në *Sunenin* e tij, Kapitulli mbi vlerat e Kuranit, hadithi nr. 3./233. Ibid, f. 468.

6 Ibn Kesir, *Tefsir – Skraćeno izdanje*, përzgjodhi versionet më të sakta: Muhammed Nasib Er Rifai', (Sarajevë, 2002), 1146.

7 Hadithin e shënon Tirmidhiu, 8/226, hadithi është *sahih* - autentik.

8 Hadithin e shënon Muslimi në *Sahihun* e tij, hadithi është *sahih* - autentik.

9 https://www.islamska-zajednica.si/2024/03/ucenje-mukabele/.

10 Hadithin e shënojnë Buhariu, Muslimi, Ahmedi dhe En Nesaiu. Hadithi është *sahih* - autentik.

11 https://www.islam.ba/teme/duhovnost/mukabela-od-vjerovjesnika-do-nas.

Kur malli për Ramazanin bëhet lutje

Bajram Zeqiri

Në çdo cep të natës, një hënë e re po mbush qiejt me dritën e saj të argjendtë. Ajo po lind si një yll vezullues, plot shkëlqim, duke shpërndarë dritën e saj magjike në zemrat e çdo besimtari. Gjithçka mbushet me një qetësi dhe me një ngrohtësi të pashpjegueshme. Një valë e re drite shpërthen për të sjellë një kthesë të madhe në jetën e besimtarit, si një mundësi për t'u rifreskuar dhe për t'u ndriçuar shpirtërisht.

Malli për zbardhimin e territ të natës me dritën e hënës së qetë tashmë i ka mbërthyer zemrat tona të njoma e shpirtrat tanë fisnikë. Ramazani, ky muaj i bekuar, si një fllad i lehtë pranvere, me gjithë shenjtërinë, dashamirësinë, bujarinë dhe mirësinë, po troket në portën e zemrave tona. Një paqe e thellë, një qëllim i ri, një mision fisnik po fillon të rilind përsëri. Çdo besimtar në këtë fillim nate, ndien një thirrje të brendshme zgjimi, për të bërë më shumë për veten dhe për të tjerët.

E akshami i ditës së fundit të muajit Shaban, na i sjellë të gjitha këto mrekulli pranë vetes. Na e sjellë margaritarin më të çmuar të vitit. "*Allahu ekber, Allahu ekber...*" – myezinët jehojnë ezanin nga minaret e xhamive, e ne, që nga aty e fillojmë garën më të mirë të jetës sonë, atë të hyrjes në Xhenet nga dera Rejjan: "*Në Xhenet, gjendet një derë, e cila quhet Rejjan. Nga kjo derë mund të futen në Xhenet vetëm agjëruesit dhe askush tjetër bashkë me ta.*" (Buhariu dhe Muslimi).

Kjo thirrje, ndonëse buçet anembanë botës, për besimtarin është edhe një thirrje e heshtur, një ftesë ngazëlluese për t'ia hapur derën një dhurate të paçmuar, një muaji të përkryer, një udhëtimi shpirtëror, i cili ndryshon çdo gjë, madje edhe çdo frymëmarrje. Përtej kësaj, është një përtëritje e lidhjes sonë me Zotin, me vlerat e mirësisë, durimit dhe faljes.

Në çdo javë të këtij muaji, në çdo ditë, në çdo orë, madje edhe në çdo minutë dhe sekondë të këtij muaji ka një mundësi për të reflektuar, një mundësi për ta pastruar shpirtin, zemrën dhe mendjen tonë. Ramazani është një mundësi për ta zgjeruar ematinë dhe mirësinë, një shans për t'i kuptuar vuajtjet e të tjerëve, një mundësi për ta shtrirë dorën e ndihmës, një qetësi për shijim të fryteve të dhëna nga Zoti, e mbi të gjitha një mendim mbi atë se si mund ta bëjmë botën edhe më të mirë se që është.

Ramazani, ky udhëtim shpirtëror, është një ftesë që të bëhemi më të mirë, më të duruar, më të sinqertë e më të pasur në shpirt. Një thirrje për ta çmuar atë që është e shenjtë, e për t'i hapur zemrat me ndjenjat e solidaritetit, ngase duke ndarë

me të tjerët, ne fitojmë më shumë, gjithçka bëhet më e bukur dhe më e shenjtë.

Një adhurim që është më i thellë sesa vetë jeta, gjithnjë me shpresën se në fund të këtij muaji të dalim më të fortë, me një shpirt më të ndriçuar, e të mbushur me dashuri, paqe dhe falje.

Një mall që na është bërë lutje, e lutja në këtë periudhë bëhet një melodi e ëmbël që ngjitet në qiell, që nuk mbetet vetëm fjalë, por shpërndahet gjithandej, duke mbushur zemrat e besimtarëve me shpresë dhe ngushëllim.

Ah, sa mall që kemi pasur për këtë muaj! Sa shumë gjatë e kemi pritur, aq shumë saqë malli na është bërë lutje. Na është bërë mungesa më e bukur e zemrës.

E kemi pritur aq me mallëngjim të madh për një vit të tërë, saqë mund të themi se malli për të është shumë më i madh sesa edhe i drurit gjetherënës për pranverën plot gjelbërim.

E kemi pritur me gëzimin e fëmijës që pret nënën e tij, që t'ia fillojmë lutjet, pendimin e përgjërimin.

Sa e bukur është një ditë e tillë Ramazani, që nis me vullnetin për të agjëruar, me zgjimin që në orët e para të agimit për t'u përgatitur për syfyrin plot bereqet, në një kohë lutjesh e rikujtimesh për të mirat dhe begatitë e Krijuesit Fuqiplotë.

Sa e begatë është një ditë Ramazani, duke qenë agjërueshm e të dorëzuar para vullnetit të Zotit tonë, e sa i bukur është ai moment kur ulemi në sofrën e iftarit, duke pritur çastin e këndimit të ezanit, për të bërë një dua, për të dhuruar një buzëqeshje, për të marrë një lutje nga prindërit tanë të dashur, e për të dhuruar një bekim për fëmijët tanë, e për të dëshmuar bashkërisht për mirësinë e muajit të bekuar Ramazan.

Ky muaj bart me vete thesare të shumta, është muaj i dhuratave, i dashamirësisë, solidaritetit dhe bujarisë. Na vjen i tillë si një pranverë e shpirtit tonë, si një fllad Xheneti, që aq shumë na ka munguar.

Për madhështinë dhe mrekullitë e këtij muaji, i dashuri ynë, Muhamed Mustafaja a.s., i përgëzonte shokët e tij, duke ju thënë: "*O ju njerëz! Ju erdhi muaji i bekuar Ramazan. Në këtë muaj hapen dyert e Xhenet, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe prangosen shejtanët.*" (Imam Ahmedi dhe Nesaiu).

Sa i bukur është ai moment kur ulemi në sofrën e iftarit, duke pritur çastin e këndimit të ezanit, për të bërë një dua, për të dhuruar një buzëqeshje, për të marrë një lutje nga prindërit tanë të dashur, e për të dhuruar një bekim për fëmijët tanë...

Ashtu duhet të jenë edhe shpirtrat tanë, të hapur për punë të mira, për bamirësi dhe solidaritet, për lexim Kurani dhe për ibadet, e të mbyllur për punë të liga, inate, hasmëri dhe urrejtje. Çdo barrierë që kemi vënë mes nesh dhe atyre që i duam, na fton ky muaj që ta largojmë. Na kujton se paqja e vërtetë vjen nga brenda, dhe se çdo fjalë e thënë me dashuri dhe dhembshuri mbetet një pikë uji në oqeanin e oazës shpirtërore.

Xheneti i mbushur me të mira, që mbetet synimi ynë i botës tjetër, gjatë këtij muaji të begatë, zbukurohet me bukuritë e tij, vetëm e vetëm për agjëruesit e devotshëm.

Ramazani është muaj i Kuranit, e pa të, ai do të mbetej një muaj i rëndomtë si të gjithë të tjerët. Si i tillë, duhet të na drejtojë edhe në përkushtimin më të madh ndaj Librit të Zotit. *"Muaji Ramazan, që në të filloi të shpallet Kurani..."* (El Bekare, 185).

Fundi i tij plot bereqet, është edhe kurora e gjithë këtij muaji. Në të gjendet edhe një natë që ka vlerën e më shumë se njëmijë muajve të tjerë, e kjo na u dha dhuratë nga Allahu i Madhëruar, e lënia mënjanë e saj, bëhet shkak i privimit të të mirave të asaj nate. *"Nata e Kadrit është më e rëndësishme se njëmijë muaj."* (El Kadër, 3).

Në atë natë, uni bën sexhde në mihrabin e tokës, e përmallimi ngrihen lart për të bërë sexhde në mihrabin e qiellit.

Ramazani duhet të jetë fitore e vërtetë e shpirtrave dhe mendjeve tona, e asnjëherë nuk mund të fitojmë mbi të tjerët, nëse veç nuk kemi arritur të fitojmë mbi vetveten, e kjo më së miri arrihet vetëm në Ramazan.

Mirë se na vjen o muaji i dritës, i shpirtit dhe i shërimit hyjnor!

Mirë se na vjen, oj pranverë e ëmbël që zgjon dashurinë brenda nesh!

Mirë se na vjen, oj hënë e bekuar që ndriçon rrugën e shpëtimit tonë!

Mirë se na vjen muaji i bekuar Ramazan!

Agjërimi dhe dispozitat bazë të tij

Dr. Zenel Hajdini

Agjërimi është një nga pesë shtyllat themelore të Islamit, dhe si i tillë ka një rëndësi të veçantë në jetën shpirtërore dhe sociale të besimtarëve. Si një akt i adhurimit dhe një mjet për pastrimin shpirtëror, agjërimi jo vetëm që forcon lidhjen e individit me Zotin, por gjithashtu promovon disiplinën, durimin dhe vetëkontrollin.

Dispozitat e agjërimit bazohen në burimet themelore të sheriatit islam: Kuranin dhe Sunetin (traditën) e Pejgamberit a.s.. Sipas këtyre burimeve, agjërimi është i detyrueshëm për ata të cilët i plotësojnë kushtet e caktuara gjatë muajit Ramazan. Allahu xh.sh. në Librin e Tij thotë: *"O besimtarë! Agjërimi ju është bërë obligim ashtu siç ishte edhe për ata që ishin para jush, që të bëheni të devotshëm."* (El Bekare, 183)

Ndërsa Pejgamberi a.s., ka thënë: "Islami ngritët mbi pesë shtylla (kondita): Dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit dhe agjërimi i ramazanit." (Buhariu 8, Muslimi 16).[1]

Në këtë shkrim do të trajtohen dispozitat themelore të agjërimit duke përfshirë kushtet e vlefshmërisë së tij, veprimet që e prishin ose e dëmtojnë atë, si dhe përjashtimet dhe lehtësimet e përcaktuara për kategori të veçanta të njerëzve, teksa në fund do të jepen edhe disa trajtime mjekësore që ndikojnë në vlefshmërinë e agjërimit.

Fëmijët të cilët ende nuk kanë hyrë në moshën e pubertetit nuk e kanë obligim agjërimin e Ramazanit. Por, nëse agjërohet ndonjë ditë nga ky muaj me qëllim të edukimit dhe përgatitjes, kjo është më mirë.

KUSHTET PËR VLEFSHMËRINË E AGJËRIMIT[2]

Në mënyrë që agjërimi të jetë i vlefshëm, agjëruesi/ja duhet t'i plotësojë këto kushte:

Të jetë mysliman – dihet se ky është kusht për çdo adhurim.

Të jetë i moshës madhore – fëmijët të cilët ende nuk kanë hyrë në moshën e pubertetit nuk e kanë obligim agjërimin e Ramazanit. Por, nëse agjërohet ndonjë ditë nga ky muaj me qëllim të edukimit dhe përgatitjes, kjo është më mirë.

Të mos jetë udhëtar – udhëtari e ka të lejuar të mos agjërojë, dhe ditën e mbetur duhet ta kompensojë pas muajit Ramazan.

Ta ketë shëndetin – sëmundja është shkak për të mos agjëruar, ndërsa ditët e mbetura duhet të kompensohen pas muajit Ramazan. Por, nëse është i shtyrë në moshë dhe nuk kanë mundësi të agjërojnë, atëherë ata ushqejnë një të varfër në ditë. Për këtë kemi ajetin kuranor: *"Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një*

të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të..." (El Bekare, 183).

Pra, i sëmuri dhe udhëtari lejohet të mos agjërojnë, por pasi të kthehen në gjendjen normale, ata i agjërojnë ditët e lëna. Allahu xh.sh. ka thënë: *"Pra, kushdo nga ju që e zë këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim (le të agjërojë më vonë), aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo që t'jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (pas agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë."* (El Bekare, 183).

Këtu mund ta përmendim edhe çështjen e gruas gjidhënëse ose shtatzënë. Nëse shtatzëna apo gjidhënësja ka mundësi të agjërojë pa vështirësi dhe mjekët janë të mendimit se ajo nuk dëmtohet në asnjë rast, atëherë ajo duhet të agjërojë. Ndërsa, nëse ajo nuk ka mundur të agjërojë, sepse mund të dëmtohet vetë ajo apo foshnja, atëherë agjërimi nuk është obligim për të, mirëpo ajo i bën kaza më vonë ato ditë që i kanë mbetur. Kështu e gjejmë te medhhebi jonë hanefi, të cilët e krahasojnë me të sëmurin i cili ka mundësi të shërohet, pra i bën kaza ditët e mbetura.

Nijeti – si çdo adhurim tjetër, edhe agjërimi, për të qenë i vlefshëm e ka kusht nijetin. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Veprat janë sipas nijeteve." (Buhariu, 1. Muslimi, 1907).[5]

Dijetarët hanefi[6] janë të mendimit se koha e nijetit është e vlefshme deri para kohës së namazit të drekës. Për këtë Aisheja, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon: "Një ditë, i Dërguari i Allahut hyri në dhomë. Ai a.s. tha: "A keni ndonjë gjë për të ngrënë?" Ne i thamë: "Jo". Ai a.s. tha: "Unë po agjëroj!" (Muslimi, 1154).[7]

ÇFARË LEJOHET GJATË AGJËRIMIT

1. Larja dhe zhytja në ujë (freskimi). Lejohet larja apo noti gjatë agjërimit me kusht që të mos kalojë uji në fyt, e nëse kjo bëhet pa dashje, atëherë nuk prishet agjërimi. Transmetohet nga Aisheja dhe Umu Selemeh, Allahu qoftë i kënaqur me to, se kanë thënë: "I Dërguari i Allahut gdhihej xhunub, pasi kishte pasur marrëdhënie intime dhe më pas agjëronte."(Buhariu, 1926. Muslimi, 1109).[8]

2. Shpëlarja e gojës dhe hundës. Lejohet shpëlarja e gojës dhe e hundës, por jo edhe gargara (futja e ujit thellë në fyt). Për këtë Pejgamberi a.s., ka thënë: "Kur të marrësh abdes, pastroje hundën thellë duke thithur ujin, por nëse je agjërueshëm, mos e bëj." (Tirmidhiu, 788).[9]

3. Përdorimi i misvakut. Për këtë, transmetohet nga Amir ibën Rabia se ka thënë: "E kam parë të Dërguarin e Allahut duke përdorur misvakun, ndërkohë që ishte agjërueshëm, aq herë sa nuk numërohen dhe nuk llogariten." (Tirmidhiu, 725).[10]

4. Gjilpërat (injeksionet). Disa nga dijetarët bëjnë dallimin ndërmjet gjilpërave ushqyese dhe atyre jo ushqyese. Por, ndoshta mendimi më i mirë është se gjilpërat në përgjithësi nuk e prishin agjërimin, përveç nëse dikush i merr ato me qëllim që të ushqehet.

5. Gjërat nga të cilat është e pamundur të mbrohemi. Këto gjëra nuk e prishin agjërimin, e disa nga këto janë: gëlltitja e pështymës, pluhurat, mizat etj..

6. Provimi i ushqimit pa e kapërdirë. U lejohet atyre që e përgatitin ushqimin që ta provojnë atë, mirëpo jo të gëlltisin diçka prej tij.

7. Ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime nga mbrëmja deri në agim. Të gjitha këto lejohen pas kohës së iftarit deri në kohën e syfyrit. Lejohet që agjëruesi të zgjohet xhunub, por më pas duhet patjetër të pastrohet. Kjo duke u argumentuar me hadithin e Aishes dhe Umu Selemes që e përmendëm më lartë.

8. Puthja e gruas. Ky veprim nuk e prish agjërimin e atij i cili e përmban veten. Aisheja, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: "I Dërguari i Allahut na puthte duke qenë agjërueshëm, prekte lëkurën (tonë) duke qenë agjërueshëm, mirëpo ai ishte më i përmbajturi." (Buhariu, 1927. Muslimi, 1106).[11] Sidoqoftë, edhe pse është e lejuar, më e mira është që agjëruesi t'u shmanget veprimeve të tilla.

DISA VEPRIME TË PAPËLQYESHME GJATË AGJËRIMIT

Është mekruh, e papëlqyeshme për agjëruesin t'i bëj disa veprime, edhe pse ato gjëra nuk e prishin agjërimin e tij.

1. Shijimi i ushqimit. E përmendëm më parë se shijimi i ushqimit nuk e prish agjërimin, por nëse kjo gjë bëhet pa pasur nevojë, atëherë është e papëlqyer dhe një veprim i tillë

Nëse dikush ha ose pi qëllimisht, ai duhet ta kompensojë atë ditë që e ka prishur, si dhe ta shlyejë shpagimin përkatës duke agjëruar 60 ditë rresht.

mund të çoj deri në prishjen e agjërimit.

2. Përtypja e ushqimit për foshnjën. Ky veprim është i papëlqyeshëm, sepse mund ta prishë agjërimin. Nëse nuk ka asnjë tjetër që mund ta bëj këtë gjë, atëherë i lejohet, por që duhet të ketë kujdes nga gëlltitja.

3. Dhurimi i gjakut dhe hixhamja. Një veprim i tillë është i lejuar, por nëse këto veprime e dobësojnë atë fizikisht, atëherë është e papëlqyeshme një veprim i tillë.

VEPRIMET QË E PRISHIN AGJËRIMIN[12]

Rregull për prishjen e agjërimit: Çfarëdo që hyn në sistemin tretës, kalon gojën dhe faringun dhe ajo që shkrin ose tret ushqimin, pra ajo që mbërrin në ezofag dhe në zorrë.

1. Ngrënia dhe pirja me qëllim. Nëse agjëruesi harron dhe ha ose pi, apo detyrohet me forcë që të prishë agjërimin, agjërimi i tij është i vlefshëm dhe nuk është obligative të kompensohet ajo ditë. Për këtë, Pejgamberi a.s., ka thënë: "Kush harron dhe ha (apo pi), duke qenë agjërueshëm, të mos e ndërpresë agjërimin e tij, pasi Allahu e ka gostitur atë me ushqim dhe pije." (Buhariu, 1933. Muslimi, 1155).[13] Ndërsa, nëse dikush ha ose pi qëllimisht, ai duhet ta kompensojë atë ditë që e ka prishur, si dhe ta shlyejë shpagimin përkatës duke agjëruar 60 ditë rresht. Gjithashtu, agjëruesi duhet të ketë kujdes gjatë marrjes së abdesit që të mos e thith ujin me hundë, sepse nëse uji kalon nga hunda në fyt, atëherë agjërimi i tij prishet dhe duhet ta kompensojë atë ditë.

2. Marrëdhëniet intime gjatë ditës së Ramazanit. Nëse bëhet ky veprim, atëherë obligohet kompensimi i asaj dite, si dhe shpagimi i saj duke agjëruar 60 ditë rresht pas muajit Ramazan. Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon se një burrë shkoi te Pejgamberi a.s., dhe i tha: "U shkatërrova!" Pejgamberi a.s., i tha: "Pse?" Ai tha: "Kreva marrëdhënie intime duke qenë agjërueshëm." Pejgamberi a.s., i tha: "Liro një rob!" Ai tha: "Nuk kam." Pejgamberi a.s., i tha: "Agjëro 60 ditë pa ndërprerje!" Ai tha: "Nuk mundem." Pejgamberi a.s., i tha: "Ushqe 60 të varfër!" Ai tha: "E ku ka më të varfër sesa unë?" Pejgamberi a.s., i tha atij disa kilogramë hurma dhe i tha: "Merri këto dhe jepua sadaka të varfërve." Ai tha: "E ku ka më të varfër sesa unë? Familjarët e mi janë më nevojtarë se çdokush tjetër." Pejgamberi a.s., i tha: "Merri dhe ushqe familjen tënde." (Buhariu, 1936. Muslimi, 1111).[14]

Pra, ai i cili kryen marrëdhënie intime, përveç kompensimit të asaj dite, duhet të bëjë edhe njërën nga këto tri gjëra: të lirojë një rob, ose të agjërojë 60 ditë pa ndërprerje, ose të ushqejë 60 të varfër. Por, përderisa nuk ka robër, tani kemi vetëm këto dy mundësitë, ose agjërim 60 ditë rresht, ose 60 të varfër të ushqehen.

Ndërsa, nëse ndodh që agjëruesi të ha ose të pi, ose të bëjë marrëdhënie intime në mëdyshje për kohën e iftarit apo syfyrit, pra duke menduar se ka perënduar dielli ose nuk ka hyrë koha e syfyrit, atëherë ai obligohet vetëm me kompensim të asaj dite, e jo edhe shpagim.

3. Pirja e duhanit dhe arritja e tymit në mushkëri. Nëse agjëruesi pi duhan, ose nëse thith tymin e duhanit me qëllim, agjërimi i tij prishet. Ndërsa, nëse thith tymin e duhanit pa qëllim (p.sh., duke ecur rrugës), agjërimi i tij nuk prishet.

4. Marrja e ilaçeve nga goja e prish agjërimin, sepse ajo depërton direkt në lukth. Përjashtim bën përdorimi i aparatit të astmës.

5. Menstruacionet dhe lehonia. Kur femra është në njërën nga këto dy gjendje, ajo nuk agjëron, por i plotëson më vonë ditët e lëna.

Trajtime mjekësore që ndikojnë në vlefshmërinë e agjërimit[15]

SË PARI: SUBSTANCAT E MËPOSHTME NUK E PRISHIN AGJËRIMIN:

1. Pikat në sy ose në vesh, larja e veshëve, pikat ose spërkatja në hundë, për sa kohë që substanca që arrin në fyt, nuk gëlltitet.

2. Tabletat që vendosen nën gjuhë për të trajtuar anginën (therjen) në gjoks ose ndonjë sëmundje tjetër, me kusht që të mos gëlltitet ajo që arrin në fyt.

3. Çdo gjë që futet në vulvë, qoftë supost, shpëlarës, ureteroskop apo mjet për ekzaminim mjekësor.

4. Futja e ureteroskopit në mitër, pajisja intrauterine (spirale) ose ndonjë pajisje tjetër të ngjashme.

5. Çdo gjë që hyn në traktin urinar të mashkullit dhe femrës: sondë, ureteroskop, substanca radiopake, ilaç ose lëng për pastrimin e zorrëve.

6. Mbushja e dhëmbëve ose heqja e dhëmballëve, pastrimi i tyre me misvakë ose furçë dhëmbësh, me kusht që të mos gëlltitet ajo që arrin në fyt.

7. Larja e gojës, gargara, spërkatës për kurimin parcial të gojës, me kusht që të mos gëlltitet ajo që arrin në fyt.

8. Injeksionet në lëkurë, injeksionet intramuskulare ose intravenoze, duke përjashtuar çdo injektim me lëngje ushqyese (serumet).

9. Gazi i oksigjenit.

10. Anestezia me avull, me kusht që pacientit të mos i injektohen lëngje ushqyese.

11. Çdo gjë që depërton në trup përmes lëkurës, si kremrat, pomadat ose manikotat e lëkurës, që përmbajnë substanca kurative ose kimike.

12. Futja e sondës për koronografi apo kurimin e venave të zemrës apo organeve të tjera.

13. Futja e laparoskopit përmes murit të barkut për ekzaminimin e zorrëve apo operacionin e tyre.

14. Biopsia e mëlçisë ose organeve të tjera, me kusht që të mos shoqërohet me marrje solucionesh.

15. Fibroskopia ose gastroskopia, me kusht që të mos shoqërohet me marrje lëngjesh ose substanca të tjera.

16. Futja e çfarëdo instrumenti ose substance kurative në tru ose në palcën kurrizore.

17. E vjella e pavullnetshme, përveç të vjellave të qëllimshme (të provokuara).

SË DYTI: ÇFARË E PRISH AGJËRIMIN:

1. Respiratori me avull i mushkërisë për trajtimin e astmës, sepse sasia që arrin në stomak prej tij është shumë më e madhe se sasia e falshme.

Transfuzioni i gjakut, sepse ai përmban një sasi të madhe uji.

Hemodializa dhe dializa peritoneale, sepse transmetojnë një sasi të madhe uji, kripërash dhe sheqeri.

Kapsulat inhalatore të astmës, që përmbajnë pluhur të thatë, sepse një pjesë e tij është substancë që arrin në stomak.

1 Muhamed Ismail el Buhari, Sahihu el Buhari, (Riad, Arabia Saudite, 2000), v1, f11. Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v1, f.54.

2 Abdullah el Musili, *El Ikhtijar litealilul Mukhtar*, (Dar er Risaleh el Ilmije, Siri, 2010), v1, f396-397. El Kasanij el Hanefij, Bedaiu es Sanaiu, (Dar el Kutub el Ilmije, 1986), v2, f.83-86.

3 Muhamed bin Xherir et Taberij, *Xhamiul Bejan fi Te'vilil Kuran*, Tefsir et Taberij, (Mueseseh er Rrisaleh, 2000), v3, f.425.

4 Muhamed Bin Isa et Tirmidhiu, Sunen et Tirmidhiu, (Darul Garb, Bejrut, Lubnan, 1998), v3, f.58.

5 Muhamed Ismail el Buhari, Sahihu el Buhari, (Riad, Arabia Saudite, 2000), v1, f12. Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v3, f.1515.

6 Burhanudin el Merginani, El Hidaje fi Sherh Bidajetil Mubtedij, (Dar Ihjau Turath el Arabij, Lubnan) v1, f.116.

7 Muslim, Sahihu Muslim, v2, f.808.

8 Buhariu, Sahihu Buhariu, v3, f.29. Muslim, Sahihu Muslim, v2, f.780.

9 Et Tirmidhiu, Sunen et Tirmidhiu, v3, f.146.

10 Et Tirmidhiu, Sunen et Tirmidhiu, v3, f.95.

11 Buhariu, Sahihu Buhariu, v3, f30. Muslim, Sahihu Muslim, v2, f.777.

12 Abdullah el Musili, El Ikhtijar litealilul Mukhtar, v1, f.407-408.

13 Buhariu, Sahihu Buhariu, v3, f.31. Muslim, Sahihu Muslim, v2, f.908.

14 Buhariu, Sahihu Buhariu, v3, f.32. Muslim, Sahihu Muslim, v2, f.781.

15 Kararat ue Teusijat Mexhma el Fikh el Islami edDeuli, botimi i katërt viti 1442h- 2020 e.s.

Lehtësime fetare përgjatë agjërimit të Ramazanit

Dr. Muhamed Stublla

HYRJE

Madhështia e bindjes, kauzës, lëvizjes apo individit, vlerësohet në bazë të përbërjes së tij apo të saj. Sa më të avancuar të jenë inspiruesit apo themeluesit e tyre, aq më të fuqishme do të jenë ato. Imagjinoni përsosmërinë e Islamit, i cili vjen nga i Gjithëdijshmi, i Pagabuari, Allahu xh.sh.. Në rast të dukjes se Islami ka defekte, të cilat e atakojnë përsosmërinë e fesë, atëherë adresa është e qartë, keqinterpretimi ose mospraktikimi i duhur i Islamit. Gjendja përshkallëzohet nëse kemi keqinterpretim dhe mospraktikim të mirëfilltë të Islamit.

LEHTËSIMI DHE MIRËKUPTIMI NË BESIM

Kuptimi qendror i fjalës 'lehtësi' në fjalorin e gjuhës shqipe është: të qenët i lehtë për t'u bërë, për t'u arritur etj.; aftësia për të bërë diçka lehtë, pa mundime e pa lodhje. Durimi për pranushmërinë e besimit tjetër, edhe pse je i bindur dhe i vetëdijshëm për pasaktësinë dhe dëmin që rezulton nga ai besim i gabuar, tregon që ju posedoni një karakter shumë të pasur të besimit, kuptimit dhe praktikimit të fesë. Në bindjen e tij, njeriu, nuk zotëron diçka më të mirë sesa besimi në Krijuesin e tij. Pra, është vlerë islame dhe dëshirë e zjarrtë që myslimani të dëshirojë që edhe të tjerët të pasurohen me mirësitë që ai posedon, e besimi është kryevlera e tij.

Megjithatë, feja islame na mëson që të respektojmë zgjedhjen e njeriut. Allahu xh.sh. na urdhëron që sjellja jonë në raport me ata që nuk besojnë në një Krijues, është që me mirësjellje t'ju themi se ne, nuk mund të largohemi nga rruga e drejtë, të heqim dorë nga besimi ynë vetëm e vetëm që të përmbushim dëshirat tuaja. Zoti xh.sh. na mëson që të themi: *"Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuroni! … Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni!"* (El Kafirun, 2-4). Për shkak të rëndësisë së këtij parimi, Allahu xh.sh., shprehimisht na mëson se si të sillemi në raport me besimet e tjera: *"Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!"* (El Kafirun, 6). Në një citat tjetër, Allahu xh.sh. thotë: *"Ju mos ua shani ata (zota) që u luten përveç Allahut, e (ata) të fyejnë Allahun…"* (El Enam, 108). Mosdurimi ndaj besimeve të të tjerëve, sjell pasoja dhe ofendime të cilat shkaktojnë konflikte, me potencial të përshkallëzimit, që vështirë se mund të menaxhohen apo përmirësohen.

Pra, nuk është çudi, kur shohim nivelin e kësaj edukate te myslimanët e vendit tonë. Merita e kësaj tolerance, në radhë të parë ju takon atyre që janë shumicë. Sa më e lartë të jetë shumica, aq më e lartë është merita e kësaj tolerance, sepse ata kanë potencialin më të madh për ruajtjen apo jo të këtyre vlerave. Toleranca islame në raport me besimet dhe bindjet e të tjerëve është treguesi më i mirë për përsosmërinë e Islamit.

LEHTËSIMI DHE MIRËKUPTIMI NË MESIN E PJESËTARËVE TË TË NJËJTIT BESIM

Përderisa kemi nivel të lartë të mirëkuptimit në raport me ata që nuk besojnë fare, patjetër që mirëkuptimi në mesin e besimtarëve myslimanë do të jetë i shkëlqyer. Mendimi se lehtësimi është vetëm slogan formal apo joshës, derisa njeriu të bëhet pjesëtar i këtij besimi, dhe kur bëhet anëtar i saj, kalon në një regjim të papërballueshëm të normave juridike, është i gabuar dhe qëllimkeq. Zoti xh.sh. myslimanëve, respektivisht agjëruesve ju thotë: *"...Allahu dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju..."* (El Bekare, 185). Agjërimi nuk është ngarkesë, ai është mundësi e artë për reflektim. Nëse e kuptojmë drejt premtimin e Zotit për shpërblimin e agjërimit, e që është aq i madh, saqë Zoti xh.sh. vlerën e tij e ka lënë të pazbuluar, në mënyrë që të jetë befasi apo surprizë gëzimi në botën tjetër, do të lehtësohet agjërimi dhe do të ndiejmë kënaqësinë e Ramazanit. Në Ramazan, krahas vlerës së lartë të agjërimit, shumëfishohet edhe shpërblimi i leximit të Kuranit, namazeve, duave, dhikrit, bamirësisë, mirësjelljes etj.. Mundësitë apo ofertat për faljen e mëkateve dhe arritjen e shpërblimeve në Ramazan janë shumë herë më të mëdha sesa mundi përgjatë agjërimit.

Në Ramazan, krahas vlerës së lartë të agjërimit, shumëfishohet edhe shpërblimi i leximit të Kuranit, namazeve, duave, dhikrit, bamirësisë, mirësjelljes etj..

Por, Zoti xh.sh., nuk ngarkon askënd me atë që nuk mund ta bartë. Në rast se dikush nuk ka mundësi të agjërojë është i liruar nga agjërimi. Allahu xh.sh. thotë: *"...e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëron), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë..."* Këtë lehtësi apo mundësi e përmbyllë me nxitjen për agjërim, ku Zoti xh.sh. thotë: *"...mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju."* (El Bekare, 184). Nëse agjëruesi ballafaqohet me vështirësi të cilat nuk janë në kompetencën apo mundësinë e tij që të distancohet nga ato vështirësi, lehtësimi hyjnore është i tillë, saqë fare nuk e konsideron që ka ndodhur ajo vepër e cila, në fakt e prishë agjërimin. Pejgamberi a.s., ka thënë: "Kush han apo pi nga harresa, duke qenë agjërueshëm, mos ta ndërpresë agjërimin e tij, pasi Allahu e ka gostitur me ushqim dhe pije!"[1] Harresa është veçori përbërëse e qenies njeri, nuk mund të zhveshët prej saj, prandaj, një shkelje formale nuk konsiderohet që ka ndodh nëse vije si shkak i saj. Me këtë normë vlerësohet dhe trajtohet edhe depërtimi i pluhurit, tymit etj., në organizimin e agjëruesit, andaj, depërtimi i tyre nuk e prish agjërimin, pasi që është e pamundur të ruhemi nga këto situata. Zoti xh.sh. është i pa të meta, është tolerant, ka lehtësuar situatat që vërtet janë ngarkesë për agjëruesin. Kurse, ai që nuk mund të agjërojë për arsye të justifikueshme, nuk ka mëkat, e shfrytëzon Ramazanin me adhurime përcjellëse të tij dhe i ofrohet alternativë tjetër për të kompensuar pamundësinë e agjërimit. Mundësia apo alternativa për të arritur shpërblimin e agjërimit në forma të ndryshme, paraqet dëshirën e Allahut që askush të mos privohet nga shpërblimi i tij.

LEHTËSIMI NË ASPEKTIN JURIDIK PËR FËMIJËT DHE ATA QË KANË PROBLEME NEUROPSIKIKE

Lirimi i të miturve, të atyre që ende nuk janë në moshën madhore nga agjërimi i Ramazanit, është argument shtesë për saktësinë dhe përputhshmërinë absolute të kësaj feje me natyrshmërinë e krijimit të njeriut. Qëllimi i asnjë obligimi nuk është dëmtimi i besimtarëve. Edhe pse fëmijët është e preferuar që të agjërojnë ndonjë ditë, në mënyrë që të mësohen dhe mishërohen me agjërim. Këtu shfaqet lehtësia e të Mëshirshmit, Allahut xh.sh., ku

përmes agjërimit apo tentimit të agjërimit, fëmijët edukohen që të jenë të gatshëm të agjërojnë atëherë kur do ta kenë obligim agjërimin. Njëkohësisht, ata shpërblehen për angazhimin apo agjërimin e tyre, por nuk çortohen dhe assesi nuk dënohen për mos agjërim.

Agjërimi në fazën e fëmijërisë është esencial, në mënyrë që i riu të trajnohet apo të mësohet me agjërim. Natyrshmëria e Islamit paraqitet edhe atëherë kur gjatë gjithë muajit Ramazan nuk e kanë mendjen e shëndoshë, të çmendurit. Zoti xh.sh., thotë: *"...Kush prej jush që e zë këtë muaj, le të agjërojë!"* (El Bekare, 185). Ai që nuk është i shëndosh mentalisht qysh para fillimit të Ramazanit deri pas përfundimit të Ramazanit, nuk konsiderohet se e ka takuar muajin Ramazan.[2] Të tillët janë të liruar, sepse ata jetojnë, por nuk kuptojnë, e urdhri për agjërim nuk është i vlefshëm për ta. Disa dijetarë thonë se, në këtë grup mund të hyjnë edhe ata që janë pa vetëdije, apo në gjendje kome, dhe kjo ju zgjat që nga fillimi i Ramazanit dhe deri pas përfundimit të tij. Këto kategori kanë qenë të pranishme me mendjen e tyre në këtë muaj, dhe konsiderohet sikurse nuk e kanë zënë apo jetuar muajin Ramazan. Ndërsa nëse vetëm në një pjesë të Ramazanit u rikthehet vetëdija, pas shërimit, obligohen me kompensimin e tërë Ramazanit. Përndryshe, këto kategori nuk e kanë obligim agjërimin, por as kompensimin kur të rriten apo shërohen.

LEHTËSIMI PËR TË SËMURIT DHE ATA QË NUK MUND T'I PËRBALLOJNË AGJËRIMIT

Besimtarët janë të obliguar me vepra përkitazi me mundësit që posedojnë për praktikimin e tyre. Nëse gjendja shëndetësore e pamundëson agjërimin, myslimani lirohet nga ky obligim.[3] I sëmuri që lirohet nga agjërimi është: a) çdo person i cili bazohet në arsye të justifikueshme, duke u frikësuar se agjërimi mund të ndikojë që të sëmuret edhe më, apo t'i rikthehet sëmundja; b) ai i sëmurë që mund të agjërojë, mirëpo agjërimi do t'ia përkeqësojë gjendjen, ose do ta zgjasë kohën e shërimit. Zoti, xh.sh., thotë: *"...e kush është i sëmurë prej jush, ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë po aq ditë."* (El Bekare, 184). Në Islam, shëndeti është prioritet. Në rast të rrezikimit të tij, besimtari tolerohet të shtyjë apo edhe mund t'i ndalohet obligueshmëria e agjërimit. Pra, adhurimet janë në dobi të besimtarit, nëse ato dëmtojnë apo seriozisht rrezikojnë shëndetin, myslimani lirohet nga ato obligime. Po pra, Islami është fe perfekte, tolerante, trajton secilën gjendje sipas specifikave të saj. Vlerësimet e gjendjes shëndetësore i bën mjeku i fushës së caktuar mjekësore, i cili është mysliman, i drejtë, besnik dhe e njeh vlerën e agjërimit. Mund të pranohet edhe praktika e disa sëmundjeve, në të cilat gjendje, nuk paramendohen që besimtari mund të agjërojë. Ndërsa, nëse natyra e punës ndikon që agjëruesi të hasë në vështirësi serioze për t'i përballuar agjërimit, këta persona duhet që të fillojnë agjërimin çdo ditë, e nëse gjatë ditës ballafaqohen me vështirësi të papërballueshme, në atë çast ju lejohet prishja e agjërimit, mirëpo jo para se të bëhet e nevojshme. Kush e di, ndoshta për shkak të sinqeritetit dhe angazhimit tuaj, Allahu ju jep forcë dhe agjëroni, ose ndodhë ndonjë e paplanifikuar dhe atë ditë nuk punoni fare. Pra, nëse keqësohet shëndeti gjatë agjërimit, besimtarit i lejohet apo edhe i obligohet të prishë atë ditë dhe të njëjtën e kompenson ditë për ditë. Por, me kujdes, që të mos abuzohet me këtë, sepse Zoti xh.sh. i njeh zemrat dhe mundësitë e njerëzve. Kurse, ata që janë të shtyrë në moshë, që nuk shpresohet përmirësimi i gjendjes së tyre, edhe nëse nuk kanë probleme shëndetësore konkrete, por trupi i tyre e ka humbur energjinë dhe forcën, për shkak të dobësisë fizike nga mosha, kjo kategori lirohet nga agjërimi. Nëse kanë mundësi financiare, e paguajnë një vlerë materiale.[4] Lehtësimi i jashtëzakonshëm, i cili e mirëkupton dhe motivon këtë kategori, arrin deri në atë nivel ku këta persona shpërblimin e Ramazanit e arrijnë përmes kësaj vlere materiale. Por jo vetëm kaq, nëse zemra dhe dëshira e tyre vlon nga lakmia për agjërim, por për shkak të moshës, ju pamundësohet agjërimi, dhe njëkohësisht nuk kanë mundësi financiare që të paguajnë kompensimin në vlerë monetare, këta myslimanë, Zoti xh.sh., me bujarinë e tij, do t'i shpërblejë me shpërblimin e agjëruesve. Islami kërkon angazhim dhe sinqeritet, sasia e adhurimit mund të jetë e ndryshme, por jo detyrimisht edhe shkalla e shpërblimit, sepse veprat shpërblehen sipas qëllimit, jo vetëm sipas sasisë.

> Në Islam, shëndeti është prioritet. Në rast të rrezikimit të tij, besimtari tolerohet të shtyjë apo edhe mund t'i ndalohet obligueshmëria e agjërimit.

LEHTËSIMI NË RAPORT ME UDHËTARËT

Zoti xh.sh. është i Gjithëdijshëm, e njeh atë që ka qenë, që është dhe atë që të do vijë. Allahu xh.sh. e ka ditur që mundësitë e udhëtimit do të lehtësohen, megjithatë, duke e ditur që udhëtimi është ngarkesë fizike dhe psikike, Allahu xh.sh., përmes Muhamedit a.s., na ka informuar se: "Udhëtimi konsiderohet pjesë e vështirësisë…"[5] Allahu xh.sh. i ka lehtësuar disa norma jurdike vetëm për faktin që jemi në udhëtim. Andaj, agjërimi është obligim për

atë që nuk është udhëtar, ndërsa udhëtari është i liruar nga obligueshmëria e agjërimit. Këtu shfaqet toleranca apo liria e Islamit, që besimtarin e lë të lirë për të zgjedhur. Allahu xh.sh., thotë: *"...kush është i sëmurë prej jush, ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë (të agjërojë) më vonë aq ditë...!"*, - mirëpo agjërimi i udhëtarit është më i dashur për Allahun, prandaj edhe e përmbyllë ajetin duke thënë: *"...mirëpo, po që se e dini, agjërimi është më i mirë për ju."* (El Bekare, 184).

Agjërimi i një dite fillon nga imsaku dhe përfundon me perëndimin e diellit. Nëse gjatë një pjese të kësaj kohe njeriu nuk është udhëtar, nuk i lejohet ta prish agjërimin. Mirëpo, nëse vështirësia e rrugëtimit e ngarkon, aq sa nuk mundet t'i përballojë udhëtimit, e prish agjërimin në atë çast, për shkak të pamundësisë së agjërimit, apo rrezikshmërisë së shëndetit, mirëpo jo për shkak se është udhëtar.[6] Edhe udhëtarët e kanë të drejtën që të shfrytëzojnë këtë lehtësi fetare për të mos agjëruar, veçse nëse nuk gjejnë vështirësi gjatë udhëtimit, agjërimi është më i dashur te Zoti, xh.sh.. Megjithatë, Allahu xh.sh. këtë e ka lënë në tolerancën dhe vullnetin e besimtarëve.

LEHTËSIA HYJNORE NË RAPORT ME GJININË FEMËRORE GJATË MUAJIT TË RAMAZANIT

Mësimet dhe udhëzimet hyjnore islame na udhëzojnë dhe mësojnë që të respektojmë dhe nderojmë gjininë femërore, saqë nderi dhe krenaria e burrave, është ndërlidhur edhe me kujdesin dhe nderin që ju bëhet grave. Pa dyshim, që lehtësimet apo toleranca islame ndaj obligimeve që ndërlidhen me gratë, përkon me nderin dhe krenarinë e Islamit.

Adhurimet e drejtpërdrejta shpirtërore, jo material, janë të ndërlidhura edhe me pastërtinë fizike. Andaj, gratë, jo vetëm që janë të liruara nga agjërimi, por atyre ju ndalohet agjërimi gjatë ciklit mujor (hajzit) dhe lehonisë (nifasit). Zoti xh.sh., duke na njohur neve më mirë sesa që ne e njohim vetën tonë, ka përshtatur normat juridike konform gjendjes sonë fizike dhe shpirtërore. Kur një vepër për dikë është e dëmshme, Allahu xh.sh. na ka ndaluar nga ajo vepër, e nëse të njëjtën e veprojmë kemi mëkat. Këtu, toleranca hyjnore tejkalon në fazën e ndalesës, për të ruajtur natyrshmërinë e Islamit në raport me atë të krijimit të njeriut. Aisheja r.a., thotë: "...jemi urdhëruar ta kompensonim agjërimin, dhe nuk e kompensonim namazin."[7] Kjo, sepse nuk agjëronin përderisa ishin në kohën e ciklit mujor dhe lehonisë.

KOMPENSIMI I AGJËRIMIT

Të gjithë ata që kanë qenë të obliguar me agjërim dhe nuk kanë agjëruar për arsye të justifikueshme fetarisht, obligohen t'i kompensojnë ditët përkatëse. Allahu xh.sh., thotë: *"...kush prej jush është i sëmurë, ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë (le të agjërojë) më vonë aq ditë...!"* (El Bekare, 184). Alternativat e kompensimit fillojnë nga mundësia e agjërimit në kohë dhe mundësi të përshtatshme për personin në fjalë, kalon kah kompensimi me kundërvlerë materiale deri te lirimi absolut.

Kjo lehtësi e jashtëzakonshme, jo vetëm që po liron myslimanët nga agjërimi, në raste të ndryshme, por, në disa raste edhe po e ndalon. Kurse, mundësit e kompensimit janë aq të lehta, saqë vetëm ai që nuk dëshiron, nuk mundet ta arrijë vlerën e Ramazanit. A ka ndonjë fe, sistem, organizatë, shtet e proces më të lehtë dhe tolerantë ku mundëson arritjen e objektivave të tij apo saj sikur mundësitë që japin normat juridike islame?!

1 Sahih El Buhari, nr. 6669, 8/136.
2 Ahmet bin Ali el Xhesas, Sherh Muhtesar et Tahavi, (Bejrut, Dar el Beshair el Islamijeh dhe Libi, Dar es Serraxh Lineshri ve et Tvziië, 2010) 2/448.
3 Alauddin el Kesani, Ebu Beker ibën Mesud ibën Ahmed, Bedaia es Sanaia fi Tertib esh Sheraia, (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmije, 1986), 2/97.
4 Burhanudin el Hanefij, El Muhit el Burhanij fi el Fikh en Nuëmani, (Liban, Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 2004), 2/476.
5 Sahih el Buhari, nr. 1710, 2/639.
6 Prof. dr. Ebu el Haxh, Sallah, El Minhaxh el Vexhiz fi Fikh et Taharah ve es Salah ve es Sijam ve el Itikaf, (Jordan, Amman, Dar el Faruk, 2015), f. 192.
7 Sahih Muslim, nr. 335, 1/265.

Ramazani, një ofertë hyjnore për femrën myslimane

Adlie Morina-Krasniqi

Femra është themeli i shoqërisë dhe një pjesë e pandarë e saj. Ajo edukon individin, brezat dhe shoqërinë në tërësi.

Gruaja, kjo forcë e madhe kryen njëkohësisht rolin e vajzës, partneres, nënës, organizatores, menaxheres, disiplinueses në familje dhe është faktor i rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të shoqërisë. Fuqizimi i rolit të saj mund të përkufizohet në promovimin e ndjenjës së vetëvlerësimit të saj për t'i përcaktuar zgjedhjet dhe të drejtat e saj, si dhe për të ndikuar në ndryshimet shoqërore për veten, familjen dhe të tjerët.

Familja është faktori kryesor në edukimin e gruas, sepse familja ka një rol jetik në transmetimin e vlerave familjare dhe në formësimin e personalitetit të femrës. Zoti i Mëshirshëm, sikurse burrit, njashtu edhe gruas ua krijoi kushte dhe mundësitë për t'u zhvilluar dhe jetuar sa më mirë në jetën e kësaj bote. Për secilin prej tyre, në mënyrë të barabartë dhe pa anime, Ai ofroi tridhjetë ditë të veçanta për çdo vit. Kështu secili prej tyre, në stilin e vet, mund të rifreskojë dhe riformësojë aftësitë e tij, përkatësisht të saj, fizike dhe mendore për një jetë më të suksesshme.

Oferta hyjnore plot një muaj, pra muaji i bekuar Ramazan, për gruan është një dhuratë nga Krijuesi, që është si një lumë i pashteruar më dobi të panumërta që i ofron asaj mundësi të rregullojë marrëdhëniet me vetveten dhe rrethin me të cilin bashkëvepron.

Psikologët pranojnë përfitimet e agjërimit në aspektin fizik, fiziologjik dhe psikik. Agjërimi ka ndikim të drejtpërdrejtë në psikikën e gruas që agjëron dhe është aktive në kryerjen e veprave të mira gjatë gjithë muajit Ramazan.

Gjatë muajit të bekuar Ramazan, femra myslimane mund të përfitojë nga disa aspekte psikologjike si:

Disiplina dhe vetëkontrolli – Duke qenë se Ramazani kërkon ndalimin e ushqimit dhe pijeve gjatë ditës, gruaja nxitë veten për ta përmbushur këtë detyrë religjioze me shpresën e arritjes së shpërblimit. Kjo i ndihmon asaj të zhvillojë dhe të ruajë vetëkontrollin. Uria është elementi i parë i vetëdisiplinës. "Nëse mund të kontrolloni atë që hani dhe pini, mund të kontrolloni gjithçka tjetër." (Dr. Umar Faruk Abd-Allah)

Pra, studime të ndryshme psikologjike pohojnë se aftësitë e një kontrollimi sa më të mirë të gjërave në jetën e njeriut, burojnë nga nisma e nevojave bazë fiziologjike, ushqimi dhe pija, andaj kush mban kontrollim mbi to, mund të arrijë kontrollin mbi çdo gjë tjetër. Agjërimi mund të sigurojë një riformim të trupit dhe mendjes, duke çuar në një mirëqenie të përgjithshme më të mirë. Ai është mësuesi ynë më i mirë

që na bënë të kuptojmë se ne nuk jetojmë për të ngrënë dhe për të pirë, por ne ushqehemi për të jetuar.

Reflektimi dhe rilindja personale – Ramazani ofron hapësirë për reflektim personal, rilindje shpirtërore, rritje të ndjenjës së mëshirës ndaj të tjerëve dhe falje. Të gjitha këto aspekte pozitive të Ramazanit mund të ndikojnë në mirëqenien psikologjike dhe emocionale të gruas myslimane, duke i dhënë asaj energji dhe harmoni të brendshme si dhe kujdes për veten.

Duke pasur parasysh se shëndeti mendor nënkupton që të jemi vigjilente, të shkathëta, të pastra dhe energjike nga pikëpamja psikike, nuk mund të gjejmë periudhë më të përshtatshme për t'i gërshetuar në mënyrë më të mirë të gjithë këta përbërës, se sa në muajin Ramazan, e veçanërisht gjatë adhurimeve të natës, *dhikrit* dhe *namazit*.

Akoma mbaj mend fare qartë, profesorin e mirënjohur të psikologjisë, dr. Pajazit Nushin, ndjesë pastë, gjatë kohës së studimeve teksa thoshte në amfiteatrin e madh të universitetit: "Ramazani për psikikën e njeriut është një operacion pa brisk." "Në radhë të parë ai mbron njeriun nga egoizmi i theksuar, madje nga megalomania (mendjemadhësia), si dhe disa forma ekstreme të personalitetit që mund të mënjanohen përmes agjërimit," sqaronte atëbotë profesor Nushi. (Gazeta Online)

Le të mos të harrojmë se agjërimi përforcon vullnetin e femrës, duke e ditur se ajo për nga natyra është me më shumë emocione, dëshira, dashuri, vullnet, guxim e kurajë. Pra ky përforcim e bënë atë më të vendosur, që nënkupton se agjërimi jep një kontribut të jashtëzakonshëm në formësimin dhe brumosjen e personalitetit të femrës.

Forcimi i ndjenjës së empatisë (ndjeshmërisë) – Pjesëmarrja në iftare dhe falje e namazeve kolektive në xhami mund të forcojnë ndjenjën e empatisë dhe bashkëjetesës midis grave myslimane. Në përgjithësi, agjëruesve u rriten ndjenjat e empatisë ndaj shtresave me nevoja socio-ekonomike, sepse ata e përjetojnë një gjendje të ngjashme nga vetë brenda vetes.

Përgatitja e iftarit dhe syfyrit – Kujdesi i tyre për ushqimin e shëndetshëm dhe atmosferën e ngrohtë në familje rritë harmoninë dhe përjetimin e tyre shpirtëror. Duhet theksuar se shumica e hulumtimeve të realizuara në lidhje me dobitë psikologjike të aktiviteteve sociale të përbashkëta theksojnë se edhe iftaret dhe syfyret e përbashkëta radhitën në mesin e përforcuesve të unitetit dhe afërsisë familjare. Një gjë e këtillë, së paku një muaj në vit, largon njeriun nga të qenit 'ego centrik' (në qendër të vëmendjes). Kështu së paku gjatë këtij muaji njeriu kupton edhe nevojat, kërkesat dhe synimet e të tjerëve si diçka me të cilën duhet mësuar dhe jetuar.

Bamirësia dhe solidariteti – Shumë gra organizojnë ndihma për të varfrit, përgatisin ushqime për nevojtarët dhe angazhohen në vepra të mira. Në të gjitha dëshmitë psikologjike hasim rezultate befasuese se njerëzit, të cilët në mënyrë vullnetare ofrojnë diçka që të tjerët i bënë të lumtur, përjetojnë ndjenja lumturie më të mëdha për vete sesa lumturia e atyre që u kanë ndihmuar.

> Ramazani ofron hapësirë për reflektim personal, rilindje shpirtërore, rritje të ndjenjës së mëshirës ndaj të tjerëve dhe falje.

Angazhimi në aktivitete fetare – Disa gra ndihmojnë në organizimin e mësimeve fetare, ligjëratave apo leximit të Kuranit në xhami apo në grupet e grave. Intensifikimi i leximit për një muaj pandërprerë është një 'infuzion' i jashtëzakonshëm dhe rimëkëmbje e shëndetit mendor. Kjo ndikon dukshëm në rritjen e përqendrimit të vëmendjes, në stabilitetin emocional dhe në parandalimin e sëmundjeve apo çrregullimeve mendore. Nëse leximi kryhet gjatë agjërimit, atëherë, ai është edhe më efikas. Kjo për shkak se agjërimi kthjellon mendjen, aftëson shqisat dhe përforcon memorien. Një lukth i zbrazur, gjakun të cilin do të duhej ta harxhonte për tretje e dërgon në tru, kështu truri pranon më shumë gjak dhe energji. Si rezultat i këtij procesi organik rritet përqendrimi dhe aftësia e të menduarit.

Mbështetja emocionale dhe shpirtërore e të tjerëve – Gratë shpesh ofrojnë këshilla dhe ndihmë për familjarët, komunitetin dhe njerëzit në nevojë. Është e vërtetuar se gratë ndjehen më të lehtësuara dhe me më pak probleme madje vetëm kur gjejnë një 'vesh' që i dëgjon. Andaj është një veprim shumë i qëlluar, dhe rekomandohet më të madhe, që gratë ta mbështesin njëra-tjetrën. Gjatë gjithë kohës sa ato shkëmbejnë biseda në mes vete, kjo është në favor të gjithë atyre. Sidomos nëse bisedat që janë zhvilluar, janë bërë në mirëbesim dhe fshehtësi (*konfidencë*) të plotë, atëherë janë ato biseda janë të dobishme për të dyja palët.

Menaxhimi i zemërimit (kontrollimi i inatit) – Në jetën e përditshme gjithmonë thuhet se meshkujt janë më agresivë sesa femrat. Kjo nga njëherë na bënë të mendojmë se ndoshta ata inatosen më shumë dhe mbajnë mëri/inat. Sipas një studimi të kryer nga Universiteti Shtetëror i Misurit Jugperëndimor, ky nuk duket të jetë realiteti. Në këtë hulumtim të 200 meshkujve dhe femrave, rezultatet tregojnë se femrat inatosen shumë më shpesh dhe në mënyrë më intensive sesa meshkujt.[11] Zemërimi duket të jetë një ndjenjë e fuqishme dhe pjesë përbërëse e natyrës se femrës. Zemërimi në veten e tij nuk është një gjë e keqe, por, nëse ai shprehet në mënyrë jo të shëndetshme, atëherë bëhet problem për shëndetin mendor. Zemërimi mund të shfaqet edhe ndaj vetvetes në situata të caktuara, por edhe ndaj tjerëve... (Ferjad Husejn – "*Menaxhimi i emocioneve*").

Agjërimi është një trajner shumë i mirë që i ndihmon femrën ta mbaj veten nën kontroll. Përgjatë tridhjetë ditëve të Ramazanit, femra myslimane ushtrohet të mësoj t'i shprehë pakënaqësitë e saj nëpërmjet komunikimit të qetë dhe pa e humbur durimin. Pikërisht këtë na ka mësuar Profeti Muhamed a.s., kur thoshte: "Kur dikush nga ju agjëron, le të mos fyej, e të mos bërtas, e nëse dikush e ofendon apo fyen, atëherë le t'i thotë: "Unë jam njeri që agjëroj." (Buhariu dhe Muslim).

Edukimi i fëmijëve me vlerat e Ramazanit – Gratë ndihmojnë në formimin e fëmijëve me moral të lartë, duke i mësuar ata mbi vlerat e sakrificës, si dhe duke i motivuar edhe fëmijët të agjërojnë, gjë që kontribuon që ata të mësojnë vlerat e durimit, faljes dhe bujarisë.

"Kur dikush nga ju agjëron, le të mos fyej, e të mos bërtas, e nëse dikush e ofendon apo fyen, atëherë le t'i thotë: "Unë jam njeri që agjëroj."

(Muhamedi, a.s.)

Fisnikërimi shpirtëror përmes agjërimit dhe lutjeve – Gratë përkushtohen në namazin e natës (teravitë), leximin e Kuranit dhe duatë për veten dhe familjen. Ramazani është kohë për të ushtruar durimin, faljen dhe lirimin e shpirtit nga emocionet negative. Kur jemi të lutja dhe të *Nata e Kadrit*, a ka ofertë më të mirë për lirimin e emocioneve negative dhe hedhjen e toksinave përjashta sesa kjo. Përmes shpresës për falje, mendja jonë çlirohet e bashkë me të rritet edhe motivi dhe kuraja për të vazhduar veprat e mira.

Vetë shpresa në arritjen e shpërblimit të *Natës së Kadrit* përmirëson ndjenjën e vetësoditjes, pendimit dhe kërkim-faljes.

Mos të harrojmë dobitë e këtij muaji edhe në aspektet e çrregullimeve dhe sëmundjeve psikologjike, se si ndikon ai për rifreskimin dhe shërimin e shumë problemeve të spektrit psikologjik. Andaj edhe psikoterapia më e duhur për të cilën ne flasim ka të bëjë me performimin e saj në lidhje me çrregullimet në sjelljet e njerëzve, kryesisht te gjinia femërore, ku efekti i agjërimit si terapi e përshtatshme do ishte më e qëlluar sipër çrregullimeve të sjelljeve.

Për fund, Ramazani është një ofertë hyjnore për femrën myslimane, duke i mundësuar asaj të zhvillojë vullnetin, disiplinën dhe shpirtin dhe duke e shëruar dhe rikthyer në funksion sa me të mirë të shumë funksioneve mentale. Ky muaj shërben si një rrugë për zhvillimin e personalitetit dhe përgatitjen e saj për rolin kyç në familje dhe shoqëri, duke formuar breza me vlera të larta morale dhe duke kontribuar në krijimin e një shoqërie të drejtë, të mirë dhe solidare.

Referencat:

Dean Burnett, *Truri idiot*, (Prishtinë: Shtëpia Botuese Pema, 2023),13-162.

Nevsat Tarhan, *Psikologjia e Lumturisë*, (Gjilan: Shtëpia Botuese Efekos, 2018), 55-57.

Kruse J. *Hyrje në Psikoterapi të thellë psikologjike si pjesë e javëve të psikoterapisë Lindau*, bazuar në Gerd Rudolf, 2006: Psikoterapia Strukturore, Stuttgart: Scattauer.

https://www.theguardian.com/lifeandstyle/2019/may/12/science-of-anger-gender- agepersonality

1 https://www.theguardian.com/lifeandstyle/2019/may/12/science-of-anger-gender-age-personality

Aspektet psiko-sociale dhe shëndetësore të agjërimit të Ramazanit

Hfz. dr. Almir Pramenkoviq

Ramazani është muaji i nëntë i kalendarit hënor islamik, e agjërimi i Ramazanit është një detyrë fetare për çdo mysliman të rritur dhe të shëndetshëm. Agjërimi i Ramazanit respektohet denjësisht çdo vit në të gjithë botën dhe zgjat njëzetenëntë (29) ose tridhjetë (30) ditë. Në Islam, agjërimi është një praktikë e detyrueshme gjatë muajit Ramazan nga agimi deri në muzg. Gjatë kësaj periudhe besimtarët nuk konsumojnë ushqim, përmbahen nga kënaqësitë trupore, sjelljet e papërshtatshme, etj..

Agjërimi i Ramazanit është obligim për çdo të rritur të shëndetshëm. Megjithatë, kur agjërimi mund të ndikojë ndjeshëm në shëndetin e individit ose kur dikush është vërtet i sëmurë, Islami e liron atë nga agjërimi. *"Allahu nuk dëshiron t'ju sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastroj të mirën e Tij ndaj jush e që t'i falënderoheni."* (El Maide, 6).

Në Kuran është urdhëruar: *"O ju që besuat, agjërimi ju është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."* (El Bekare, 183).

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, shëndeti është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale, e jo vetëm mungesë e sëmundjes ose paaftësisë. Për ne myslimanët shëndeti është një nga bekimet më të mëdha të Allahut që i është dhuruar njeriut nga Krijuesi i Madhërishëm, e i cili sipas mësimeve islame, vjen menjëherë pas bekimit të besimit.

Është sugjeruar se agjërimi i Ramazanit do të ishte një rekomandim ideal për trajtimin e sëmundjeve sikur që janë: diabeti, hipertensioni esencial, kontrolli i peshës, ulja e nivelit të sheqerit në gjak, ulja e kolesterolit dhe ulja e niveleve të yndyrës në trup.

Është e rëndësishme të theksohet, se në vitin 1994, në Kazablanka, Marok, është mbajt Kongresi i Parë Ndërkombëtar për Shëndetin dhe Ramazanin, në të cilin janë prezantuar rreth 50 punime shkencore mbi etikën mjekësore të agjërimit, e ku të pranishëm ishin ekspertë nga e gjithë bota. Është sugjeruar se agjërimi i Ramazanit do të ishte një rekomandim ideal për trajtimin e sëmundjeve sikur që janë: diabeti, hipertensioni esencial, kontrolli i peshës, ulja e nivelit të sheqerit në gjak, ulja e kolesterolit dhe ulja e niveleve të yndyrës në trup.

Duhet theksuar se qëllimi parësor i agjërimit të Ramazanit është në formimin e sjelljes dhe mënyrën e jetës së praktikuesve të tij, duke u përmbajtur nga dëgjimi, të folurit ose të menduarit keq për të tjerët, duke u shndërruar ata në qenie ideale njerëzore. Për ta arritur këtë, ata duhet të përmbahen nga dëgjimi, të folurit ose të menduarit keq për të tjerët. Ndikimi i procesit të pastrimit duhet të zbatohet dhe të zgjasë edhe në muajt e pas Ramazanit.

ASPEKTI PSIKOLOGJIK I AGJËRIMIT TË RAMAZANIT

Kurani famëlartë është burim udhëzimi për njerëzimin dhe asgjë në të nuk përmendet dhe urdhërohet pa qëllim dhe dobi. Myslimanët besojnë se agjërimi është më shumë sesa përmbajtja nga ushqimi. Agjërimi përfshin gjithashtu largimin nga çdo gënjeshtër në të folur dhe në veprim, largim nga të gjitha fjalët injorante dhe të pahijshme dhe mendimet epshore. Gjithashtu, agjërimi ka efekt qetësues në nerva, largon ankthin dhe tensionin, sjell qejf të mirë dhe kënaqësi shpirtërore. Prandaj, është e pahijshme dhe në kundërshtim me frymën e agjërimit islam që agjëruesi të jetë nervoz, i tensionuar, i padisponushëm dhe i pavullnetshëm. Agjërim forcon kontrollin impulsiv dhe ndihmon në zhvillimin e sjelljes cilësore. Përveç kësaj, agjërimi i Ramazanit nuk ka të bëjë vetëm me disiplinimin e trupit për t'u përmbajtur nga ushqimi. Sytë, veshët, gjuha dhe i gjithë trupi janë po aq të detyruar që të përmbahen. Ky pastrim i trupit dhe i shpirtit harmonizon sferat e brendshme dhe të jashtme të individit. Prandaj, myslimanët përpiqen të përmirësojnë gjendjen e trupit dhe shpirtit të tyre duke zvogëluar marrjen e ushqimit dhe duke mbajtur një mënyrë jetese më të shëndetshme.

Nuk ka dyshim se agjërimi ndihmon në promovimin e pastërtisë dhe të përulësisë, parandalim të mëkatit, shfrenim të epsheve dhe dëshirave të pakontrolluara. Gjatë muajit Ramazan, besimtarët përpiqen të pastrojnë shpirtin dhe trupin e tyre dhe të shtojnë vepra të mira.

Në nivelin moral, besimtarët përpiqen të arrijnë virtytet dhe karakteristikat më të larta duke zbatuar ato në situatat e tyre të përditshme. Ata përpiqen të tregojnë bashkëndjesi, bujari dhe mëshirë ndaj të tjerëve, të arrijnë durim dhe të kontrollojnë egon e tyre. Në thelb, agjërimi i Ramazanit kërkon të rifreskojë dimensionin shpirtëror, të ndërtojë karakterin dhe shprehjet pozitive të individit dhe komunitetit.

Islami i inkurajon myslimanët që në Ramazan të kryejnë vepra devotshmërie, bamirësisë ose studimin të Kuranit. Studimi i Kuranit jo vetëm që kultivon qetësi të zemrës dhe të mendjes, por gjithashtu përmirëson kujtesën. Për më tepër, agjërimi shërben si një mjet për vetëdijesimin tonë për Zotin dhe përforcimin e vetëkontrollit tonë. Përveç të përmbajturit nga ushqimi, agjërimi përfshin gjendjen e ngritur mendore, si dhe zhvillimin e ndjenjave pozitive. Shumë studime tregojnë se shkalla e vetëvrasjeve ulet ndjeshëm gjatë muajit Ramazan.

ASPEKTI SOCIAL I AGJËRIMIT TË RAMAZANIT

Agjërimi i Ramazanit zhvillon vlerat shpirtërore, morale dhe shoqërore. Ai është një mesazh i barazisë ndërmjet individëve në shoqëri. Vëmendje i kushtohet të varfërve nëpërmjet shpërndarjes së ndihmës, forcohet lidhja e fqinjësisë dhe e mikpritjes. Agjërimi është rregulluar me qëllim që të vendoset barazia ndërmjet të pasurve dhe të varfërve - të pasurit në agjërim përjetojnë urinë, dhe kështu bashkëndjenjë me të varfrit duke i përmbushur detyrimet e tyre financiare.

Një nga dobitë më të mëdha të agjërimit të këtij muaji është se ai te njeriu krijon veprimin për të thënë të vërtetën. Agjërimi i Ramazanit, në fakt, është ushtrim i vetëdisiplinës. Ata që përdorin duhanin duke dëmtuar shëndetin e tyre, por edhe shëndetin e të tjerëve në familjen ose në komunitetin e tyre; ata që vazhdimisht hanë ushqime, ose pinë kafe çdo orë, kanë një mundësi të mirë për të hequr një shprehi të tillë, duke shpresuar se efekti do të vazhdojë edhe pas muajit Ramazan. Për ata që janë të varur nga të lartpërmendurat, Ramazani është koha më e mirë për t'i braktisur veprimet që e dëmtojnë shëndetin, si dhe gjendjen e tyre ekonomike. Meqenëse arrijnë të kontrollojnë veprimet e tyre për një

muaj, besimtarët duhet të vazhdojnë ta bëjnë këtë edhe pas Ramazanit.

ASPEKTI SHËNDETËSOR I AGJËRIMIT TË RAMAZANIT

Agjërimi i Ramazanit ka ndikim pozitiv në shëndetin dhe në zhvillimin personal. Myslimanët nuk agjërojnë për përfitime shëndetësore, që janë të natyrës dytësore, megjithëse dimensionet shëndetësore Islami nuk i neglizhon. Literatura mjekësore tregon se agjërimi gjatë Ramazanit është i dobishëm për shumicën e njerëzve me diabet. Agjërimi si dietë e ekuilibruar përmirëson kolesterolin në gjak, redukton aciditetin e stomakut, zgjidh problemet e tretjes dhe kontribuon në mënyrën aktive dhe të shëndetshme të jetesës. Agjërimi sjell pushim të shëndetshëm fiziologjik në traktin tretës dhe sistemin nervor qendror, si dhe normalizon metabolizmin. E në pjesën e trurit të hipotalamusit ekziston një qendër që quhet lipostat, e që kontrollon masën e trupit. Kur vije deri te humbja serioze dhe e shpejtë e peshës nga uria, qendra nuk e njeh këtë si normale dhe për këtë arsye riprogramon që të shkaktojë shtim të shpejtë të peshës kur personi ndërprenë dietën. Prandaj, mënyra e vetme efektive për të humbur peshë është e ngadaltë, e vetëkontrollueshme dhe përshkallëzuar, duke modifikuar sjelljen dhe qëndrimin ndaj të ngrënit dhe duke e eliminuar ushqimin e tepërt. Prandaj, Ramazani është muaji i vetërregullimit dhe vetëtrajnimit në lidhje me marrjen e ushqimit.

Agjërimi sjell pushim të shëndetshëm fiziologjik në traktin tretës dhe sistemin nervor qendror, si dhe normalizon metabolizmin.

Shumë studime tregojnë se problemet shëndetësore mund të shfaqen si rezultat i marrjes së tepërt të ushqimit. Një studim që përfshinte 60 vullnetarë në Jordani tregoi se pesha e trupit është ul ndjeshëm në fund të agjërimit dhe se agjërimi nuk kishte efekt negativ në kortizolin, testosteronin, elektrolitet, kolesterolin ose trigliceridet. Janë evidente efektet e agjërimit të Ramazanit në fiziologjinë e organizmit, si dhe në parametra të ndryshëm biokimikë, hematologjikë dhe metabolikë.

Siç u cek më sipër, myslimanët falen pesë herë në ditë, e gjatë Ramazanit falin edhe 20 rekate namazin e teravisë. Kjo jo vetëm që ndihmon në përdorimin më të mirë të ushqimit, por krijon energji dhe është gjithashtu e dobishme për përdorimin dhe shpenzimin shtesë të kalorive.

Mund të thuhet lirisht se agjërimi i Ramazanit është mundësia më e mirë për të përmirësuar shëndetin tonë mendor, shpirtëror dhe fizik.

Përktheu nga gjuha boshnjake: Shaban Basha



Dispozitat e namazit të teravive

Mr. Ekrem Maqedonci

Namazi i teravive është një nga adhurimet e preferuara të Pejgamberit a.s. në muajin e bekuar Ramazan. Ky namaz është veçori e këtij muaji të bekuar dhe nuk falet në muajt e tjerë. Koha e faljes së namazit të teravive është pas namazit të jacisë dhe para vitrit. Ky namaz është i ligjshëm si për gjininë mashkullore, ashtu edhe për gjininë femërore. Mund të falet në mënyrë individuale dhe me xhematë, porse falja e tij me xhematë është më e preferuar, ngase kështu arrihet edhe shpërblimi i namazit me xhematë.

NORMA E NAMAZIT TË TERAVIVE

Ky namaz bën pjesë në grupin e namazave joobligative, ose thënë ndryshe bën pjesë në grupin e namazeve vullnetare. Por, meqë Pejgamberi a.s., këtë namaz e falte rregullisht, atëherë e merr normën e *suneteve të forta – muekede.*[1] Pejgamberi a.s., i nxiste sahabët për ta falur këtë namaz duke iu thënë: "Kush ngrihet të falë namaz nafile (teravitë) gjatë natës në Ramazan, me bindje dhe besim, duke llogaritur në shpërblimin e Allahut, atij do t'i falen mëkatet e tij të kaluara."[2]

Me këtë hadith na bëhet e qartë rëndësia dhe dobia e namazit të teravisë, ngase Pejgamberi a.s. u premtoi agjëruesve se do t'u falen nga mëkatet e tyre, nëse ata janë të kujdesshëm dhe të rregullt në faljen e këtij namazi.

Periudha e aplikimit të namazit të teravisë

Nuk ka ndonjë hadith që tregon saktësisht se kur ka filluar së aplikuari falja e namazit të teravive. Por, sipas disa mendimeve nga juristët islamë, Ramazani i fundit i Pejgamberit a.s. mund të jetë Ramazani ose viti në të cilin është filluar me faljen e namazit të teravive në mënyrë të rregullt.[3]

Është evidentuar nga Aisheja r.a. se Pejgamberi a.s. në një prej netëve të Ramazanit doli në xhami dhe u fal (pra fali namazin e teravive), dhe disa njerëz u falën bashkë me të. Të nesërmen njerëzit biseduan për këtë namaz dhe u tubuan edhe më shumë, ai u fal dhe ata u falën me të, në natën e tretë erdhën edhe më shumë sahabë për t'u falur, dhe u falën me të. Kurse në natën e katërt pasi erdhën shumë xhematë nga sahabët për t'u falur me Pejgamberin a.s., ai nuk u doli në xhami. Sahabët e pritën një kohë të gjatë Pejgamberin a.s. për të dalë në namaz, por ai prapë nuk doli. Në ditën e nesërme pas namazit të sabahut, Pejgamberi a.s. iu drejtua njerëzve me një fjalim të shkurtër dhe u tha atyre: "O ju njerëz, e di gjendjen tuaj, nuk dola mbrëmë për të falur namaz (namazin e teravive), ngase u frikësova se po u bëhet obligim juve, e pastaj do të jetë ngarkesë për ju, e nuk mund ta kryeni."[4]

NUMRI I REKATEVE TË NAMAZIT TË TERAVISË

Sipas mendimit të shumicës së juristëve islam,[5] e ndër ta edhe juristët e medhhebit hanefi, medhheb të cilin edhe zyrtarisht e kemi në trojet tona shqiptare, namazi i teravive ka njëzet rekate. Lidhur me këtë, Imam Merginani në librin e tij "El Hidajeh", ka thënë: "Preferohet që në Ramazan të tubohen njerëzit dhe të falen pesë teravi, (secila teravi me nga dy selame, pra pesë herë nga katër rekate)."[6] Ndërsa Imam Vehbi Sulejman Gavoxhi në librin e tij "Erkanul Islam" ka thënë: "Numri i rekateve të namazit të teravive është njëzet, mund të falen edhe me dhjetë selame, në çdo rekate lexohet Fatihaja dhe diç tjetër nga Kurani fisnik, mjafton tri ajete të shkurtra, ose një ajet të gjatë, ose ndonjë sure."[7]

Për numrin e rekateve që e theksuam, juristët hanefitë numërojnë disa argumente, e ndër me të rëndësishmet janë:

Transmetohet nga Jezid bin Rumani, se njerëzit në kohën e Umer ibën Hatabit r.a. falnin njëzet e tri rekate namaz (njëzet teravi dhe tri rekate vitr).[8]

Po ashtu transmetohet nga Ibën Abasi r.a., se: "Pejgamberi a.s. në Ramazan i falte njëzet rekate."[9]

Po ashtu transmetohet nga Abdurrahman b. Abdulkarië, i cili ka thënë: "Një natë gjatë Ramazanit dola në xhami me Omerin r.a., e atje i pamë njerëzit duke u falur të shpërndarë, dikush falej vetmas, e disa të tjerë faleshin në grupe." Omeri kur i pa tha: "Unë mendoj që t'i bashkoj këta njerëz që të falin namazin me një imam." Pastaj i thirri të gjithë sahabët dhe i bashkoi në një xhemat, dhe për imam të tyre caktoi Ubej b. Kabin. E kur doli natën tjetër dhe i pa njerëzit duke u falur me xhematë pas një imami tha: "Sa risi e mirë është kjo." Më pastaj tregohet nga sahabët se kur Omeri r.a. i kishte bashkuar ata në një xhemat dhe ua kishte caktuar atyre imam Ubej ibën Kabin, e falnin namazin e teravive njëzetë rekate.[10]

Transmetohet gjithashtu se edhe Aliu r.a. e kishte urdhëruar një imam që t'i falte teravitë njëzetë rekate.[11]

Këto hadithe, edhe nëse ndonjërit prej tyre mund t'i kontestohet saktësia e tyre te dijetarët e hadithit, prapëseprapë argumentimi me to mbetet tejet i fortë dhe kredibil. Kjo për faktin se veprimi i sahabëve dhe praktika e tyre në këtë çështje, e forcon mendimin e katër medhhebeve për numrin e rekateve të teravive.

Prandaj, ajo që te ne po ndodh në kohën e pasluftës, ku një numër i xhematit pas faljes së tetë rekateve, ose një numri të caktuar të rekateve të teravive, po ndahen nga imami, nga xhemati e xhamia, është gabim në normë dhe edeb.

Madje, një çështje shumë me rëndësi që duhet ta kemi parasysh është **ixhmai i sahabëve**, (pajtueshmëria dhe unanimiteti i të gjithë sahabëve me mendimin e Omerit r.a.), ngase kur Omeri r.a. i organizoi sahabët që të falen me një imam dhe një xhemat, dhe që teravitë të faleshin njëzetë rekate, asnjë nga sahabët e pranishëm nuk doli që e kundërshtoi Omerin r.a.. E dihet fare mirë, që sahabët po të kishin tjetër mendim nuk do të pajtonin me një vendim të gabuar të Omerit r.a..

Prandaj, edhe Ebu Hanife kur u pyet për namazin e teravisë dhe veprimin e Omerit me njëzetë rekate, tha: "Ai nuk e bëri këtë nga vetvetja e tij, dhe kurrë nuk do ta bënte nëse nuk do të gjente mbështetje në Sunetin e të Dërguarit të tij."[12]

Prandaj, ajo që te ne po ndodh në kohën e pasluftës, ku një numër i xhematit pas faljes së tetë rekateve, ose një numri të caktuar të rekateve të teravive, po ndahen nga imami, nga xhemati e xhamia, është gabim në normë dhe edeb.

Them gabim në normë, ngase Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kush falet me imamin e tij derisa imami ta përfundojë namazin e tij, atij do t'i shkruhet (llogaritet) sikur të jetë falur tërë natën."[13]

Ndërsa gabim në edeb, e kemi për qëllim prishjen e rendit të xhematit, disiplinës së xhamisë dhe qetësisë së saj, ngase në shumicën e rasteve të tillët (siç edhe dihet qartazi) me bisedat dhe diskutimet e tyre brenda xhamisë, bëhen pengesë për imamin dhe xhematin të cilët vazhdojnë namazin e tyre.

MËNYRA E FALJES SË NAMAZIT TË TERAVIVE

Për faljen e namazit të teravisë nuk ka nevojë të thirret as ezan e as ikamet. Ngase edhe ezani edhe ikameti janë të aplikueshme vetëm për namazet obligative, respektivisht për pesë namazet ditore dhe për namazin e xhumasë. Namazi i teravive mund të falet vetmas, por mund të falet edhe me xhematë. Nëse e falim me xhematë imami lexon Kuranin me zë, e nëse e falim vetmas atëherë mund ta falim edhe me zë, por edhe pa zë (duke lexuar vetvetiu). Ky namaz mund të falet nga dy rekate, por mund të falet edhe nga katër rekate me një selam. Në vendin tonë është bërë e zakonshme që të falen nga katër rekate me një selam, gjë që nuk ka asgjë të keqe, dhe mendojmë se është më e udhës që të respektohet kjo traditë.

Në fillim të rekatit, merret tekbiri fillestar, këndohet Subhanekeja, Eudhubilahi dhe Besmeleja, pastaj lexohet Fatihaja dhe ndonjë ajet ose ndonjë sure. Në rekatin e dytë po ashtu lexohet Fatihaja dhe ndonjë ajet ose ndonjë sure, dhe shkohet ne uljen e parë, ku lexohet Tehijati, Shehadeti dhe Salavatet. Ngrihemi në rekatin e tretë, (dhe meqenëse ky namaz bën të falet edhe nga dy edhe nga katër rekate, atëherë edhe në fillim të rekatit të tretë) e lexojnë Subhaneken, Eudhubilahin dhe Besmelen, pastaj lexojmë Fatihan dhe ndonjë ajet ose ndonjë sure. Në rekatin e katërt lexohet Fatihaja dhe ndonjë ajet ose ndonjë sure, dhe pastaj shkojmë në uljen e fundit ku lexojmë: Tehijatin, Shehadetin, Salavatet, Duatë, dhe japim selam. Gjatë faljes së namazit të teravisë, dijetarët janë të mendimit se është e preferuar që të pushohet nga pak pas çdo katër rekateve, për aq sa xhemati mund të bëjnë një pushim të vogël. Gjatë këtij pushimi, mund të ketë ndonjë këshillë nga imami apo ndokush tjetër, ose edhe mund të lexohet Kuran, apo vetë xhemati në heshtje të bëjë ndonjë lutje apo dhikër tjetër.

NAMAZI I NATËS PAS NAMAZIT TË TERAVIVE

Rëndom, edhe vetë namazi i teravive konsiderohet namaz i natës, ngase çdo namaz vullnetar mes namazit të jacisë dhe namazit të sabahut konsiderohet namaz i natës. Mirëpo këtu nuk kemi për qëllim namazin e teravive, por namazin e natës që e bëjmë në Ramazan, pas namazit të teravive, e sidomos në dhjetë netët e fundit të Ramazanit. Në këto dhjetë net gjendet edhe Nata e Kadrit, natë që konsiderohet më e vlefshme sesa njëmijë muaj.

Për rëndësinë e namazit të natës flet edhe Allahu xh.sh. në Kuran kur thotë: *"O ti i mbuluar! Ngrihu për namaz nate, përveç një pjese të vogël të saj. Gjysmën e saj ose diç më pak se gjysmën. Ose shto diç prej saj dhe Kuranin lexoje me vëmendje. Ne do të shpallim ty fjalë të rëndë. E nuk ka dyshim se aktiviteti i natës është fuqizues i qartë."* (Muzemil 1-6).

Andaj në parim, kalimi i natës me adhurim, rikujtim të Allahut, lexim të Kuranit, e namaz vullnetar, si na Ramazan ashtu edhe jashtë Ramazanit, konsiderohet prej veprave të preferuara dhe të shpërblyera tek Allahu i Madhërishëm. Pejgamberi a.s., në një hadith ka thënë: "Kalojeni natën me namaz nate, ngase namazi i natës është qëndresa e robërve të mirë."[14] Po ashtu me një rast i ka thënë Abdullah ibën Amrit r.a.: "O Abdullah, mos u bë si filani, ka qenë i rregullt në namaz të natës dhe tani e ka lënë atë."[15] E në një tjetër hadith ka thënë: "Namazi më i mirë pas farzit është namazi i natës."[16]

Ky namaz është sunet që të falet nga dy rekate, ashtu siç falet suneti i sabahut, ngase Pejgamberi a.s., ka thënë: "Namazi i natës falet nga dy rekate."[17] Mund të falet me zë dhe pa zë. Mund të falet vetmas, por edhe me xhematë (ngase Muhamedi a.s. ndonjëherë e falte namazin e natës edhe me xhematë, transmetohet se një rast në shtëpi të vet ua kishte falur namazin e natës Ibën Abasit, Ibën Muesudit, dhe Hudhejfi ibnul Jemanit r.a.).[18]

Por sipas medhebit hanefi (por edhe atij shafi), namazin e natës është më e preferuar që ta falim në shtëpi, larg nga sytë e njerëzve (e sidomos gjinia femërore). Kjo për faktin se Pejgamberi a.s., kur e falte namazin e natës kishte dëshirë që mos ta shoh atë askush nga njerëzit, madje as bashkëshortja e tij. Transmetohet nga Ajsheja r.a. të ketë thënë: "Një natë e vërejta të Dërguarin e Zotit se nuk është në shtrat, kur shikova e vërejta se është duke u falur namaz...".[19] Po ashtu, edhe me fjalët e tij i kishte porositur shokët e tij me një hadith duke ju thënë: "O ju njerëz, përhapeni selamin, bëhuni bukëdhënës dhe faluni natën kur njerëzit janë fjetur, sepse do të hyni në Xhenet pa ndonjë pengesë."[20]

1 El Hidajeh Sherh Bidajetul Mubtedi, Imam Merginani, 1/85.
2 Transmeton Muslimi me nr. 759.
3 Shih: Pejgamberi a.s. në Ramazan, Abdulhakim el Enis, përkthyer nga mr. Vedat Shabani, fq.73.
4 Transmeton Buhariu me nr. 1077, Muslimi me nr. 761.
5 Shih: Fikhul Islam ve ediletuhu, dr. Vehbi Zuhejli 1/75.
6 El Hidajeh Sherh Bidajetul Mubtedi, Imam Merginani, 1/85.
7 Erkanul Islam, Vehbi Sulejman Gavoxhi, 1/330.
8 Transmeton Imam Maliku në "Muveta" (525).
9 Transmeton Imam Bejhakiu në "Sunen" (496).
10 Transmeton Buhariu me nr. 1906.
11 Transmeton Imam Bejhakiu në "Sunen" (497).
12 Erkanul Islam, Vehbi Sulejman Gavoxhi, 1/331
13 Evidenton Ibën Huzejme në Sahihun e tij me nr. 2211.
14 Transmeton Imam Tirmidhiu.
15 Transmeton Buhariu me nr. 1152
16 Transmeton Muslimi me nr.
17 Transmeton Buhariu me nr. 472.
18 Transmeton Buhariu me nr. 698.
19 Transmeton Muslimi me nr. 485
20 Transmeton Tirmidhiu me 7/1166.

Namazi i vitrit dhe falja e tij gjatë Ramazanit

Dr. Ejup Haziri

HYRJE

Çështja e faljes së namazit të vitrit si dispozitë dhe numri i rekateve të tij do të jetë diskutim brenda këtij punimi, pa anashkaluar edhe faljen e vitrit me theks të veçantë gjatë muajit të bekuar Ramazan. Ndonëse për numrin e rekateve, mënyrën e faljes dhe disa dispozita të tjera, ka debate që nuk përfundojnë, megjithatë fokusi do të jetë brenda shkollës hanefite dhe pa u stërzgjatur shumë.

NORMA E TIJ

Namazi i vitrit sipas mendimit zyrtar të shkollës hanefite është vaxhib, përkundër që brenda kësaj shkolle ka mendime se ai është sunet, sikurse që ka edhe mendime se ai është farz. Megjithatë mendimi zyrtar dhe i njohur është ai që dominon brenda kësaj shkolle se vitri është vaxhib dhe i ka tri rekate.[1]

NAMAZI I VITRIT – TRI REKATE

Namazi i vitrit i ka tri rekate dhe ato tri rekate falen pa ndërprerje, me vetëm një selam në fund. Tahaviu në lidhje me polemikën se sa rekate i ka vitri shprehet: "Ai (vitri) ose është farz (përfshinë edhe vaxhibin) ose është sunet. Nëse është farz, ose i ka dy rekate, tre apo katër, e ulemaja janë dakorduar se vitri nuk mund t'i ketë as dy e as katër rekate, andaj është vërtetuar se i ka tri rekate. E nëse është sunet, prej sunetit nuk mund të gjejmë ndryshe veçse ngjasim të plotë me farzin, e prej farzit vetëm akshami është tek, pra i ka tri rekate, andaj edhe nga kjo perspektivë po dëshmohet se vitri i ka tri rekate."[2] Hasan el Basriu kishte thënë se konsensusi i dijetarëve është ndërtuar mbi opinionin se vitri i ka tri rekate.[3]

Tahaviu përcjell mendimin e Ebu-l Alijeh, i cili thotë: "Shokët e të Dërguarit të Allahut na mësonin se vitri është sikurse akshami (tri rekate), ky është vitri i natës e ai është i ditës."[4]

Edhe pse ekzistojnë mendime të ndryshme sa i përket numrit të rekateve të namazit të vitrit, megjithatë mendimi më popullarizues është ky që e kemi sjellë këtu, gjegjësisht tri rekate. Madje, edhe pse Ibën Omeri përcjell se i Dërguari i Allahut falte një rekat vitër, kur është pyetur ai dhe Ibën Abasi nga Amir Shabiu se si ishte namazi i natës i të Dërguarit të Allahut, ata i janë përgjigjur: "Namazi i të Dërguarit të Allahut ishte trembëdhjetë rekate: tetë (namaz nate), vitër tre, dhe dy rekate të namazit të sabahut."[5] Madje, përcillet se Ibën Omeri falte tri rekate vitër, jepte selam pas dy rekateve, kryente apo urdhëronte të kryhej ndonjë punë dhe pastaj e falte edhe një.[6] Me fjalë të tjera, kishte arsye për dhënie selam pas dy rekateve, e më pas e plotësonte edhe një.

Problematika e numrit të rekateve të vitrit që pasqyrohet përmes transmetimeve të ndryshme, është nga fakti se transmetimet rreth tij, në të shumtën flasin për namazin e

natës që falte i Dërguari i Allahut, duke përfshirë këtu edhe namazin e vitrit, ku në disa transmetime thuhet se ai falte tetë rekate namaz nate e një vitër, në disa të tjera tetë rekate namaz nate e tri vitër, e në disa tjera trembëdhjetë rekate, tetë namaz nate, tri vitër e dy rekate të tjera sunet të sabahut. Zakonisht shumica e këtyre transmetimeve përcillen nga disa sahabë, si Ebu Selemeh ibën Abdurrahmani, Sad ibën Hishami etj., të cilët e kanë pyetur Aishen rreth namazit të natës dhe vitrit që bënte i Dërguari i Allahut. Meqë në shikim të parë mund të duken se këto hadithe kanë kontradikta mes vete, në realitet ato nuk kanë kundërthënie dhe duhet kuptuar një gjë, se i Dërguari i Allahut ndonëse falte gjithnjë namazin e natës, numri i rekateve të tij mund të ndryshonte, sikurse që në disa transmetime përmenden edhe dy rekate namaz të sabahut, e në disa të tjera nuk përmendet, ngase koha ishte e shkurtër për faljen e tyre. Kjo komentohet varësisht prej gjendjes së tij, prej kohës që kishte në dispozicion, si dhe dallimi mes kohës kur me shëndet ishte mirë dhe kohës kur kishte problem me shëndet,[7] ku në disa transmetime përmendet se një pjesë e kishte falur në këmbë, e pjesën tjetër ulur.

Bedrudin Ajniu në lidhje me këtë jep këtë shpjegim: "...Arsyeja e këtij dallimi apo mospajtimi (i transmetimeve) nga Aisheja rreth numrit të rekateve të namazit të natës të Resulullahut ose vjen nga transmetuesit prej Aishes, ose nga lajmi i saj për gjendjet e ndryshme, ku disa prej veprimeve të tij janë më të shpeshta,[8] disa më të rralla,[9] e disa varësisht nga dispozicioni i kohës që kishte[10]."[11]

Përfundimisht mund të themi se mendimi më i pranuar, më i qëlluar dhe më i dëshmuar është mendimi se vitri i ka tri rekate, ngase hadithet më tepër e synojnë atë numër. Problematika në tekste qëndron në faktin se vitrin i Dërguari i Allahut e falte vonë (natën), ku së pari falte namazin e natës e pastaj vitrin, e në disa transmetime përmendet edhe falja e sunetit të sabahut, e nga këtu kemi transmetime me shifra të ndryshme të rekateve, gjë që është qartë e kuptueshme, sepse kemi të bëjmë me namaz nate, vitër, e ndonjëherë edhe me sunetin e sabahut.

Përfundimisht mund të themi se mendimi më i pranuar, më i qëlluar dhe më i dëshmuar është mendimi se vitri i ka tri rekate, ngase hadithet më tepër e synojnë atë numër.

SI FALET NAMAZI I VITRIT

Forma e faljes së namazit të vitrit është falja e tre rekateve me një selam në fund, ku në rekatin e parë lexohet Fatihaja me një sure, në të dytin Fatihaja me një sure tjetër, bëhet ulja në teshehud por pa dhënë selam, më pas ngrihet për rekatin e tretë ku lexohet Fatihaja me një sure dhe para rukusë, ngrihen duart dhe lexohet duaja e kunutit, e pastaj teshehudi dhe selami e përmbyll namazin e vitrit. Është e preferuar që në rekatin e parë krahas Fatihasë të lexohet kaptina El A'la, në të dytin El Kafirunë, përderisa në të tretin El Ihlas.[12]

ARGUMENTET PËR TË

Sipas medhhebit hanefi, namazi i vitrit duhet të falet tri rekate me vetëm një selam në fund. Ky qëndrim është i bazuar në argumentet në vijim:

"Aisheja transmeton se i Dërguari i Allahut vitrin e falte tri rekate dhe jepte selam vetëm në fund të tij."[13] Në një transmetim tjetër po ashtu nga Aisheja, thuhet: "Asnjëherë nuk jepte selam pas dy rekateve të vitrit."[14]

Ebu Selemeh e kishte pyetur Aishen rreth namazit të natës që bënte i Dërguari i Allahut, e ajo ia ktheu: "...Ai i falte katër rekate, e mos pyet për bukurinë dhe gjatësinë e atyre rekateve, e më pas falte edhe katra tjera, po ashtu mos pyet për bukurinë dhe gjatësinë e atyre rekateve, e pastaj falte tri rekate (vitër)..."[15] Në këtë hadith përmendet namazi i natës nga katër rekate dhe tre rekate që aludohet namazi i vitrit, e që as në këtë transmetim nuk përmenden se janë ndarë me selam pas rekatit të dytë, por që përmenden se ishin tre rekate. Sido që të jetë, edhe ky hadith e përforcon atë paraprak se namazi i vitrit i ka tri rekate. Madje ky hadith është argument i Ebu Hanifes se namazet nafile gjatë natës janë katër rekate me një selam, sikurse që është argument se namazi i vitrit është tri rekate.[16]

Transmetimet prej sahabëve të ndryshëm që përcjellin namazin e vitrit të të Dërguarit të Allahut janë të shumta, si nga Ebu Musa el Eshariu, Sadi, Amrete e bija e Abdurrahmanit nga ensarët, etj.

Përveç Aishes, edhe Ibën Abasi përcjell se i Dërguari i Allahut vitrin e falte tri, rekate dhe

tregonte edhe për kaptinat që i lexonte për secilën rekate.[17]

Dikush e kishte pyetur Ebu-l Alijeh për vitrin, e ai i qe përgjigjur: "Shokët e Muhamedit a.s. na mësonin se vitri është i ngjashëm me namazin e akshamit, me përjashtim se në rekatin e tretë lexohet, e ky është vitri i natës e ai është vitri i ditës."[18]

Namazi i vitrit falet pas namazit të jacisë deri në kohën e namazit të sabahut. Namazi i akshamit përmbyll ditën dhe koha e tij mbaron atëherë kur fillon koha e namazit të jacisë, andaj përmendet në tekste se akshami është vitri i ditës e namazi i vitrit është vitri i natës, ndonëse edhe në falje dallojnë, gjegjësisht në rekatin e tretë, ku në namazin e akshamit lexohet vetëm Fatihaja, përderisa në vitër krahas Fatihasë i bashkëngjitet edhe një kaptinë dhe më pas bëhet duaja e kunutit.

Ubejj ibën Kabi përcjell se i Dërguari i Allahut lexonte kaptinën El A'la në rekatin e parë të vitrit, kaptinën El Kafirun në rekatin e dytë dhe kaptinën El Ihlas në rekatin e tretë, dhe ai (i Dërguari i Allahut) nuk jepte selam pos në fund të këtyre rekateve.

Pra, ekzistojnë argumente të shumta që tregojnë dhe dëshmojnë se i Dërguari i Allahut e ka falur vitrin tri rekate me një selam, e kjo tregohet përmes Aishes dhe shumë sahabëve të tjerë. Vlen të përmendet se Omer ibën Abdulazizi kishte urdhëruar që namazi i vitrit të falet me tri rekate me vetëm një selam në fund, e këtë e kishte bërë në bazë të verdikteve të fukahave (juristëve).

> Praktika e disave që falin vetëm disa rekate namaz teravie dhe pastaj largohen në emër të "sunetit" dhe e lënë imamin me një pjesë tjetër, është praktikë e gabuar, e paqëlluar dhe bie në kundërshtim me hadithet e mësipërme.

PRAKTIKA E SAHABËVE RRETH FALJES SË VITRIT

Përcillet në transmetime të ndryshme se Ebu Bekri, Omer ibën Hatabi, Aliu, Abdullah ibën Mesudi, Ubej ibën Kabi, Zejd ibën Thabiti, Enes ibën Maliku dhe shumë të tjerë, e falnin namazin e vitrit tri rekate, duke dhënë selam vetëm në fund të rekatit të tretë.[19] Përderisa djali i Omerit, Abdullahu dhe një grup tjetër, kryesisht të rinj, e falnin po ashtu tri rekate, por me dy selame, në rekatin e dytë dhe të tretë. Sigurisht se Abdullah ibën Mesudi ishte prej të parëve që pranuan Islamin dhe e kishte shoqëruar gjithnjë të Dërguarin e Allahut dhe ishte i njohur në praktikën ndaj sunetit të të Dërguari të Allahut. Gjithashtu edhe Omeri dhe të tjerët, nga sahabët e vjetër që faleshin gjithnjë pranë të Dërguarit të Allahut, ishin të njohur për praktikën e të Dërguarit të Allahut. Habib el Mualimi përcjell se dikush e kishte pyetur Hasan Basriun se i biri i Omerit (Abdullahu) po jepte selam pas faljes së dy rekateve të vitrit, e ai tha: "Omeri ishte më i ditur (fekih) se ai, e ai (Omeri) ngrihej në rekatin e tretë me tekbir."[20]

Përveç sahabëve, të njëjtën praktikë se vitri i ka tre rekate me një selam në fund, e kishte edhe Omer ibën Abdulazizi, shtatë juristët e njohur të Medinës,[21] Alkame, Xhabir ibën Zejdi, Seid ibën Xhubejri, Mekhuli, Hamadi, Ibrahim Nehaiu dhe shumë të tjerë.[22] Në të vërtetë, këta kishin gjetur banorët e Medinës që vitrin e falnin në atë mënyrë, pra një falje e tillë ishte trashëguar nga koha e të Dërguarit të Allahut. Ibën ebi Shejbe përcjell opinionin e Hasan Basriut i cili thotë: "*Myslimanët janë dakorduar se vitri i ka tri rekate, selam jep vetëm në fund të rekatit të tretë.*"[23]

FALJA E VITRIT ME IMAM GJATË RAMAZANIT

Gjatë muajit Ramazan, namazi i vitrit falet kolektivisht me xhematë. Imami i prin xhematit dhe e fal vitrin me zë. Kjo e bën vitrin akoma më të fuqishëm dhe i jep edhe më tepër rëndësi dhe vlerë. Ai që falet me imamin derisa ta përfundojë imami, i llogaritet sikur të ketë falur namazin e natës. Për këtë i Dërguari i Allahut tha: "Nëse njeriu falet bashkë me imamin derisa ai (imami) të largohet (përfundojë), i llogaritet atij si (të ketë falur) namaz nate."[24]

Pothuajse ngjashëm me këtë hadith është edhe ky: "Kush falet me imamin derisa ai të përfundojë (namazin), atij i shkruhet (se është falur) namaz nate."[25]

Hadithi është inkurajim i qartë për faljen e komplet namazit së bashku ma imamin, derisa imami të përfundojë nga namazi. Ky është suneti dhe kushdo që pretendon se ia ka qëlluar sunetit me faljen e disa rekateve duke lënë pjesën tjetër, vetëm e mashtron veten dhe ia ka huq sunetit. Praktika e disave që falin vetëm disa rekate namaz teravie dhe pastaj largohen në emër të "sunetit" dhe e lënë imamin me një pjesë tjetër, është praktikë e gabuar, e paqëlluar dhe bie në kundërshtim me hadithet e mësipërme. Përderisa hadithet që i solla, tregojnë më së miri se ai që falet me imamin derisa imami ta përfundojë, atij i llogaritet sikur ta ketë kaluar natën me namaz. Po këta që largohen pas katër apo tetë rekateve, çfarë fitojnë?

Transmetimet që flasin për caktimin e Ubeje ibën Kabit dhe Temim ed Darit për t'iu prirë njerëzve në namaz, tregojnë se njerëzit faleshin pas tyre derisa ata e përfundonin namazin e teravive prej njëzet rekateve, e nuk ka transmetim që dikush largohej.

Andaj, kjo praktikë e re që dalin pas disa rekateve (pa arsye) duke lënë imamin me një pjesë tjetër, nuk është e arsyeshme, është shmangie nga kolektivi (xhemati) dhe humbje e madhe e shpërblimit.

Gjatë muajit Ramazan, namazi i vitrit falet kolektivisht me xhematë. Imami i prin xhematit dhe e fal vitrin me zë. Kjo e bën vitrin akoma më të fuqishëm dhe i jep edhe më tepër rëndësi dhe vlerë.

1 Bidajetu-l Mubtedi, f.20; *El Hidajeh fi sherh Bidajetu-l Mubtedi*, v.I, f. 66.

2 Bedrudin el Ajni, *Sherh sunen ebi Davud*, bot. I-rë, Mektebetu Rrushd, Riad, 1999, v.V, f. 331.

3 Ibën ebi Shejbe në Musannef, v. II, f. 90, nr. 6834.

4 Alij el Karij, *Mirkatu-l Mefatih sherh Mishkatu-l Mesabih*, bot. I-rë, 2002, Daru-l Fikr, Bejrut, v.III, f. 949.

5 Ibën Maxheh në Sunen, v. III, f. 380, nr. 1360. Hadithi është autentik, ndonëse për Ubejd ibën Mejmunin kanë folur dijetarët.

6 Buhariu në Sahih, v.I, f. 135, nr. 991.

7 Shumica e këtyre transmetimeve flasin për kohën kur i Dërguari i Allahut ishte i shtyrë në moshë dhe kishte probleme shëndetësore. Madje për këtë kohë ka transmetime se gjatë namazit të natës ishte falur më pak. Shih Nesaiu në Sunen, v.I, f.249, nr. 1708.

8 11 rekate përmendet më së shpeshti.

9 15 rekate përmendet më rrallë.

10 7 rekate përmendet shumë pak.

11 Bedrudin el Ajni, *Nuhabu-l efkar fi tenkih mebani-l ahbar*, bot. I-rë, 2011 Dar-l Minhaxh, Xhide, v.VI, f. 395.

12 E-Mevsilij, *El Ihtijar litalili-l muhtar*, Matbeatu-l halebij, Kajro, 1937, v.I, f.55.

13 Hakimi në Mustedrek, v.I, f.447, nr. 1140, dhe thotë se ky ishte vitri i prijësit të besimtarëve, Omerit, e nga ai e morën këtë praktikë banorët e Medinës.

14 Hakimi në Mustedrek, v.I, f.446, nr. 1139, dhe thotë se hadithi është autentik sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit.

15 Buhariu në Sahih, v.IV, f.504, nr. 3565; Maliku në Muveta, v.I, f.115, nr. 293; Ahmedi në Musned, nr. 24073.

16 Bedrudin el Ajni, *Nuhabu-l efkar fi tenkih mebani-l ahbar*, bot. I-rë, 2011 Dar-l Minhaxh, Xhide, v.VI, f. 402.

17 Ahmedi në Musned, v.III, f.215, nr. 2720. Senedi i hadithit është autentik.

18 Tahaviu në Sherh meani-l Athar, v.I, f.293, nr. 1743.

19 Bedrudin el Ajni, *Nuhabu-l efkar fi tenkih mebani-l ahbar*, bot. I-rë, 2011 Dar-l Minhaxh, Xhide, v.VI, f. 356, 496, 508.

20 Hakimi në Mustedrek, v.I, f.447, nr. 1141.

21 Seid ibën Musejjeb, Urvetu ibën Zubejri, El Kasim ibën Muhamed, Ebu Bekr ibën Abdurrahmani, Harixheh ibën Zejdi, Sulejman ibën Jesari, dhe Ubejdullah ibën Abdullah ibën Utbeh.

22 Po aty, fq. 506-509.

23 Ibën ebi Shejbe në Musannef, v.II, f.90.

24 Ebu Davudi në Sunen, nr. 1375. Hadithi është autentik.

25 Tirmidhiu në Sunen, nr. 806. Hadithi është autentik.

Dhjetë netët e fundit të Ramazanit dhe Nata e Kadrit

Isa Tërshani

Falënderojmë Allahun e Madhëruar, që na dha shëndet, jetë dhe mundësi që edhe këtë vit ta presim e ta fillojmë agjërimin e muajit Ramazan, dhe inshallah ta përfundojmë këtë muaj duke dalë faqebardhë me shpërblime të shumta nga i Madhi Zot xh.sh.! Jemi në këtë muaj të shenjtë, muaj i madhështive dhe vlerave të mëdha, muaj i mëshirës, i dritës dhe i shkëlqimit hyjnor, muaj i ibadetit dhe Kuranit. Ditët e bekuara të Ramazanit ikin mjaft shpejt. Këto janë ditët speciale të Allahut, në të cilat Ai zbret mëshirën e Tij të madhe, falë dhe plotëson lutjet e besimtarëve. Kështu që, secili prej nesh duhet ta vlerësojë këtë muaj para se të bëhet vonë. Allahu i Madhëruar krijon, veçon dhe zgjedh kë të dojë Ai, ashtu siç tha në Kuran: *"Zoti yt krijon çka të dojë, dhe zgjedh kë të dojë..."* (El Kasas, 68).

Allahu xh.sh., e ka veçuar këtë ymet nga ymetet e tjera me begati dhe veçori të shumta; së pari e ka veçuar me faktin se këtij ymeti ia ka dërguar Pejgamberin më të mirë dhe më të zgjedhur, Muhamedin a.s., me të cilin e ka vulosur pejgamberinë, dhe këtë ymet e ka bërë ymetin më të mirë në sipërfaqen e Tokës. Pastaj, Allahu xh.sh., këtij ymeti ia tregoi edhe obligimet, në mënyrë që lidhja e tij me Krijuesin të jetë përherë e pashkëputur. E, nga obligimet është edhe agjërimi i muajit Ramazan.

Allahu i Madhëruar e zgjodhi dhe e dalloi këtë muaj nga muajt e tjerë si muaj kur nisi zbritja e Kuranit. Megjithatë, edhe vetë brenda Ramazanit, Allahu zgjodhi ca ditë, të cilat janë më me vlerë sesa ditët e tjera. Fjala është pikërisht për dhjetë netët e fundit, e që ne në këtë shkrim po i shënojmë disa nga ato vlera. Vlera e tyre sigurisht se është më e madhe sesa vlera e 20 ditëve të para, ngase pikërisht në këto net edhe ka filluar zbritja e Kuranit, siç thotë Allahu xh.sh.: *"(Ato ditë të numëruara janë) Muaji Ramazan, që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra)..."* (El Bekare, 185).

Në këto dhjetë net, besimtarë të nderuar, është edhe Nata e Kadrit, e cilësuar si më e mirë sesa 1000 muaj, dhe e cila, para së gjithash, për ne është një rast jetik për t'u pastruar nga mëkatet dhe gabimet. Allahu xh.sh., thotë: *"Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!"* (El Kadër, 3).

PO SI ISHTE GJENDJA E MUHAMEDIT A.S., NË 10 NETËT E FUNDIT TË MUAJIT RAMAZAN?

Muhamedi a.s., në këto dhjetë net ishte më aktiv se kurrë më parë në adhurime, si dhe ishte më i freskët në lutje sesa kurrë më parë. Ai falej, lutej, lexonte Kuran dhe e zgjonte edhe familjen të falej me të. Aisheja r.a., tregon për Muhamedin a.s., dhe thotë: "Kur hynte dhjetëshja (e fundit), Pejgamberi a.s., shtrëngonte brezin e tij (largohej nga jeta intime), e gjallëronte natën (me adhurim) dhe e zgjonte familjen e tij."[1]

FTESË PËR LLOGARITJE TË VETVETES

Besimtarë të nderuar, kur i kalojmë 20 ditë, dhe i afrohemi shtegut përfundimtar të Ramazanit, tradicionalisht atleti mundin e tij më të madh e jep në fund të maratonës, kur është afër cakut final. Po ne, si i kemi pasur punët gjatë ditëve të kaluara të Ramazanit?! A kemi qenë prej atyre që kemi vepruar drejt e me mençuri, apo kemi qenë prej dembelëve që, si në fillim, ashtu edhe në fund, jemi njësoj!

Ja disa nga gjërat që duhet ta llogarisim veten, për ta parë nëse ato na e mundësojnë fitoren dhe na japin fuqi tani në fund të shtegut, apo anashkalimi i tyre na ka lënë mbrapa! Kemi dëgjuar shumë herë se Muhamedi a.s., ka thënë për namazin në Ramazan: "Ai që e falë namazin e natës (teravitë) gjatë Ramazanit, duke besuar dhe llogaritur në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës."[2] Enesi r.a., transmeton se Muhamedi a.s., ka thënë: "Allahu ka një melaqe, që për çdo namaz thërret: "O bijtë e Ademit, ngrihuni për te zjarret tuaja që i keni ndezur dhe fikni-shuajini me namaz!"[3] Pra, le ta pyesim veten se çfarë namazi kemi bërë gjatë këtyre 20 ditëve! A ka qenë namazi ynë në përputhje me udhëzimet fetare, apo ka qenë si ata që Muhamedi a.s., siç transmeton Imam Ahmedi, i ka quajtur hajnat më të këqij në Tokë: "Hajni më i keq prej njerëzve është ai që vjedh në namazin e tij." "Si mund të vjedhë njeriu në namaz?", - pyetën disa. Ai tha: "Nuk e kryen siç duhet rukunë dhe sexhden e namazit."[4]

Aisheja r.a., tregon për Muhamedin a.s., dhe thotë: *"Kur hynte dhjetëshja (e fundit), Pejgamberi a.s., shtrëngonte brezin e tij (largohej nga jeta intime), e gjallëronte natën (me adhurim) dhe e zgjonte familjen e tij."*

Allahu xh.sh., e ka obliguar agjërimin në këtë muaj të shenjtë, mirëpo ne le ta pyesim veten se çfarë agjërimi kemi bërë?! Agjërim të cilësuar e me devotshmëri, apo vetëm jemi larguar nga ushqimet, dhe jo edhe nga fjalët e punët e këqija? Ebu Hurejre r.a., transmeton se Muhamedi a.s., ka thënë: "Allahu nuk ka nevojë që të lërë ushqimin dhe pijen ai që nuk i lë fjalët dhe punët e këqija (gjatë agjërimit)."[5] Kjo do të thotë se largimi i agjëruesit nga gënjeshtra, e dëshmimi i rremë, shpifjet, thashethemet, fjalët dhe sjelljet e këqija, përbën një nga parimet më të rëndësishme etike të agjërimit. Në fakt, veprimet si: thashethemet e përgojimi, kurrë nuk i kanë hije myslimanit. Myslimani është i drejtë dhe i ndershëm. Ai nuk ua thyen zemrën njerëzve e nuk mban qëndrim idhnak.[6]

Cila ishte sjellja jonë me prindër gjatë këtyre ditëve të Ramazanit? Si rikujtim për respektimin e tyre po ua sjell një hadith prej Ibën Adijit r.a., ku transmetohet se Pejgamberi a.s., ka thënë: "Qëndro afër saj (përkushtoju nënës), pasi Xheneti është te këmbët e saj (në respektimin e saj)."[7]

Myslimanë të nderuar, nga gjërat shumë të preferuara në këto dhjetë ditë është edhe itikafi.

Fjala *itikaf* gjuhësisht domethënë qëndrim ose ndalim në një vend, prandaj ai që qëndron në xhami dhe bën ibadet, quhet *akif,* ose *mu'tekif.* Ndërsa në jurisprudencën islame domethënë qëndrim në xhami me nijet (qëllim) të caktuar. Pra qëndrimi është shtyllë kryesore, kurse xhamia dhe nijeti janë dy kushte për të qenë *itikafi* i plotfuqishëm.[8] Aisheja r.a., ka thënë: "Pejgamberi a.s., hynte në itikaf në dhjetëshen e fundit të Ramazanit, (këtë e bënte vazhdimisht në çdo Ramazan) derisa vdiq…"[9]

Itikafi bëhet me qëllim të adhurimit-vetmimit për adhurim të Allahut të Madhëruar dhe largimit nga problemet e përditshmërisë së dynjasë. Le të rikujtojmë o vëllezër, se të këndosh Kuran do të thotë të flasësh me Allahun, se të falësh namaz do të thotë të jesh mysafir i Allahut, e kështu me radhë! Prandaj, le të vendosim se a duam apo jo të flasim dhe të jemi mysafirë të Allahut! Një prej emrave të bukur të Allahut, xh.sh., është edhe El Muxhib (Pranuesi i lutjeve). Le të bëjmë sa më shumë

dua, sepse duaja është adhurim! Pejgamberi a.s., ka thënë: "Duaja është thelbi (truri) i ibadetit."[10] Gjithashtu ka thënë: "Allahu vërtet është i Gjallë, i Ndershëm (Fisnik), dhe turpërohet t'ia kthejë bosh (duarthatë) nëse njeriu i ngre duart kah Ai."[11]

Të gjithë ne kemi nevojë të lutemi dhe t'ia qajmë hallet tona Atij që ka në Dorë gjithçka. Të gjithë jemi të varfër për mëshirën dhe ndihmën e Tij. Sufjan bin Ujejne ka thënë: "Mos ki frikë se nuk të pranohet lutja ngaqë ke bërë gjynahe, pasi Zoti ia ka pranuar lutjen krijesës më të keqe, shejtanit! Ai iu lut Zotit t'i jepte afat deri në një ditë të caktuar, për ta larguar njeriun nga rruga e Zotit, dhe Zoti ia pranoi lutjen! Një rast tjetër një njeri adhuroi një idhull-statujë për vite me radhë, dhe ajo asnjëherë nuk iu përgjigj. Një ditë u hidhërua, e me atë inat shkoi e iu lut Allahut xh.sh., dhe ai mori përgjigje që me lutjen e parë. Xhibrili, a.s., e pyeti Allahun, xh.sh.: "Si shpjegohet kjo, o Zot i Madhëruar?". Allahu xh.sh., i tha: "Nëse nuk i përgjigjem, atëherë ku është ndryshimi midis Meje dhe statujës?" Në fakt, Zoti gjithmonë ua pranon lutjet njerëzve.

Të mos na kalojnë këto ditë sikurse ditët e tjera, mirëpo ta shfrytëzojmë kohën dhe momentin për të kryer sa më shumë ibadete e adhurime, në mënyrë që të bëhemi më të mirë dhe të afrohemi edhe më afër mëshirës, faljes dhe bujarisë së Allahut xh.sh..

NATA E MADHE E KADRIT

Mëshira është mirësi nga ana e Allahut të Madhërishëm. Ai me mëshirën e Vet e zbriti Kuranin në Natën e Kadrit dhe ia shtoi vlerën kësaj nate. Kjo natë është Nata më e vlefshme dhe më e zgjedhur në përgjithësi. Kjo është ndodhi të cilën Toka nuk e ka përjetuar deri në atë natë. Asgjë nuk mund të krahasohet me këtë natë në aspektin e madhështisë, rëndësisë dhe ndikimit në jetën e njerëzimit. Nata e Kadrit do të thotë nata e përcaktimit dhe planifikimit, ndërsa mund të ketë kuptimin edhe të vlerës dhe pozitës. Të dy kuptimet janë në pajtim me ngjarjen e madhe kosmike, e cila do të ndryshojë botën, vlerat dhe kriteret, përpjekjet dhe aspiratat e saj. Kjo është nata madhështore të cilën e zgjodhi Allahu xh.sh., që të jetë fillimi i shpalljes së Kuranit i cili dritën e tij do ta shpërndajë fuqishëm në vetëdijen njerëzore dhe në jetën e përgjithshme të njeriut.[12]

Nata e Madhe e Kadrit i jep vlerë edhe më të madhe këtyre ditëve. Kjo natë vjen vetëm një herë në vit, dhe është më e vlefshme se njëmijë muaj. Kjo natë ofron rastin e vetëm për fitimin e mirësive të Allahut xh.sh., prandaj, duhet patjetër ta shfrytëzojmë në mënyrën më të mirë. Allahu i Madhërishëm në kaptinën El Kadër, thotë: *"Ne e zbritëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit. E ç'të bëri ty të dish se çështë Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj. Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti Xhibrili për secilën çështje. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit. "* (El Kadër, 1-5).

Siç po na tregon Zoti i Madhëruar, në këtë natë zbresin engjëjt e Tij, në krye me Xhibrilin a.s.. Ata kërkojnë falje për mua dhe për ty. Kur ti lexon Kuran, ata lexojnë Kuran pranë teje. Kur ti falesh, edhe ata falen pranë teje. Kur ti e lut Allahun për mëshirë dhe për falje, ata thonë: "*O Zot, fale robin Tënd!*" Engjëjt nuk zbresin nga një apo nga dy, por zbresin me turma të mëdha. Numri i engjëjve të Allahut xh.sh., nuk imagjinohet dot. Muhamedi a.s., ka thënë: "Kur shkova në qiej, pashë që nuk kishte asnjë pëllëmbë vendi bosh, dhe në çdo pëllëmbë vendi kishte një melek që i bënte sexhde Allahut, xh.sh."[13]

Këta engjëj zbresin për të kërkuar falje për besimtarët, për ata besimtarë që e duan faljen e Allahut xh.sh.. Në këtë natë caktohet risku dhe jetëgjatësia e njeriut. Prandaj, o vëlla, përse nuk e lut Zotin të ta shtojë riskun e të ta shtojë edhe

jetën, dhe të bësh edhe disa punë të mira! Lutu tek Allahut xh.sh., në këtë natë se, inshallah, duaja jote do të pranohet. Kjo natë është falje, qetësi dhe paqe prej Zotit të Gjithësisë. Bëhu i qetë me Allahun xh.sh., dhe bëj paqe me engjëjt e Tij! Ka paqe edhe me shejtanin e mallkuar, sepse ai nuk ka fuqi të veprojë në këtë natë dhe në Ramazan. Prandaj, le ta shtojmë ibadetin në këto ditë të fundit duke e kërkuar Natën e Kadrit. Pejgamberi a.s., e luste Allahun xh.sh., që t'ia jepte mundësinë ta arrinte Natën e Kadrit, dhe i nxiste shokët e tij, gratë dhe fëmijët, që të luten, që Allahu xh.sh., t'ua pranojë adhurimet në këtë natë, siç transmeton Ebu Hurejre r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë: "Kush falet në Natën e Kadrit, duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, do t'i falen mëkatet e kaluara."[14]

Prej Ebu Hurejres r.a., transmetohet se Muhamedi a.s., ka thënë: "Mosha e ymetit tim është mes 60 e 70 vjet, e rrallëkush e kalon këtë."[15]

Kjo thënie e Muhamedit a.s., na e tërheq vëmendjen që të jemi të kujdesshëm. Sidomos ata që kanë mbushur 40 vjet, që ta dinë se i janë afruar kohës së fundit, kohës së tretë të jetës së tyre. Ata nuk mund të jenë si dikur, dhe tashmë presin në çdo moment t'u vijë melaqja e vdekjes, prandaj edhe duhet të përgatiten për të. Po kështu ndodh edhe me muajin Ramazan. Dhjetëditëshi i fundit tregon se këtij muaji po i afrohet fundi. Dashtë Zoti që këto ditë të jenë dëshmi për ne, dhe jo kundër nesh!

Nata e Kadrit është një natë më e mirë se njëmijë muaj. Subhanallah! Njëmijë muaj është e barabartë me 83 vjet e 4 muaj. E, kush e përjeton këtë natë, falet për Zotin xh.sh., dhe i lutet Atij me sinqeritet, te Zoti llogaritet sikur të jetë falur e ta ketë adhuruar Allahun e Madhëruar, për 83 vjet me radhë. 83 vjet është si një jetë tjetër. Kjo është sikur njeriu të jetojë dy jetë brenda një jete. Kjo është mëshira dhe begatia e Allahut xh.sh.. Le ta marrim një shembull nga përditshmëria: ata njerëz që merren me tregti, dhe e dinë se ç'është fitimi, i shfrytëzojnë momentet kur del malli me çmimin më të lirë, dhe blejnë sa më shumë. Allahu xh.sh., na e dha Natën e Kadrit që të marrim sa më shumë shpërblime në të. Për një natë Zoti xh.sh., jep shpërblim sikur për 83 vjet, ose shpërblimin e një jete tjetër brenda kësaj jete. Në jetën tonë shpesh bëjmë gabime, dhe në adhurimet tona shpesh bëjmë lëshime dhe kemi neglizhencë. E, sevapi i kësaj nate jepet i plotë, sikurse të kishim jetuar 83 vjet, pa bërë asnjë gabim.

Aisheja r.a., transmeton se e pyeti Pejgamberin a.s.: "Sikur ta dija se kur është Nata e Kadrit, çfarë më këshillon të them?". E, Pejgamberi a.s., i tha: "Thuaj: O Zot, Ti je Falës i madh, Ti e do shumë faljen, prandaj më fal mua!".

Po, a dihet saktësisht se kur është kjo natë? Zoti me mëshirën dhe urtësinë e Tij e ka fshehur këtë natë. Pra, ne nuk e dimë me saktësi se kur është kjo natë. Muhamedi a.s., ka thënë: "Kërkojeni Natën e Kadrit në dhjetëditëshen e fundit të Ramazanit".[16] Gjithashtu Ubade ibën Samiti r.a., tregon se Pejgamberi a.s., doli të na lajmëronte për Natën e Kadrit, por papritmas dy myslimanë zunë të fjaloseshin, e në atë rast tha: "Dola t'ju lajmëroja për Natën e Kadrit, por, ngaqë po fjaloseshin filani dhe filani, m'u tërhoq dituria për të. Shpresoj që kjo të jetë më e dobishme për ju. Andaj, kërkojeni në natën e nëntë, të shtatë dhe të pestë (të dhjetëshes së fundit)."[17]

Edhe kjo ishte nga urtësitë e Allahut xh.sh.. Imagjinoni se çfarë bëjnë konfliktet mes myslimanëve, dhe sa e sa bereqet largohet nga shtëpitë dhe zemrat tona nga përçarjet! Aisheja r.a., transmeton se e pyeti Pejgamberin a.s.: "Sikur ta dija se kur është Nata e Kadrit, çfarë më këshillon të them?". E, Pejgamberi a.s., i tha: "Thuaj: O Zot, Ti je Falës i madh, Ti e do shumë faljen, prandaj më fal mua!".[18]

Të nderuar agjërues, lutuni për falje për veten tuaj, për prindërit, bashkëshortet-ët dhe fëmijët tuaj! Lutuni për gjithë myslimanët, për ata që vuajnë çdo ditë! Nuk ka koprraci më të madhe sesa mos t'i lutesh Allahut xh.sh.. Po t'i lutesh dikujt, ai mërzitet, ndërsa Allahu xh.sh., mërzitet kur nuk i lutemi.

Në fund, e lus Zotin e Gjithëmëshirshëm që ta arrijmë Natën e Kadrit, e mos të privohemi nga begatitë e saj! Të na i ketë pranuar prej nesh agjërimin, namazin, lutjet, sadakanë dhe çdo punë të mirë që e kemi bërë! Amin!

1 Sahihu i Buhariut, v. 2. Shtëpia botuese, Harfi, Prishtinë, 2024.
2 Sahihu i Buhariut, 37.
3 Taberaniu, 9686.
4 Ahmedi, 22642.
5 Sahihu i Buhariut, 1903.
6 Islami nëpërmjet hadithеve, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë. 2.f. 455.
7 Nesaiu, 3104.
8 Vehbi Sulejman Gavoçi, Dispozitat e agjërimit, Prishtinë, 2008, f.111.
9 Sahihu i Buhariut, 2026.
10 Tirmidhiu, 3371.
11 Tirmidhiu, 3556.
12 Doc. dr. Shefik Kurdiq, Ramazani dhe namazi i teravive në dritën e medhhebit hanefi, Prishtinë, 2004, f.35.
13 Taberaniu, 201.
14 Sahihu i Buhariut, 2014. Muslimi, 760.
15 Tirmidhiu, 3550.
16 Sahihu i Buhariut, 2020.
17 Sahihu i Buhariut, 2023.
18 Tirmidhiu, 3513.

Zekati - shtylla e drejtësisë sociale në Islam

Dr. Ilmije Kuqi

Zekati është një nga shtyllat më të rëndësishme që mbështet drejtësinë sociale dhe ekonomike. Si një nga pesë shtyllat e Islamit, zekati renditet në rëndësi menjëherë pas namazit, duke dëshmuar kështu rolin e tij thelbësor në praktikën islame. Ndryshe nga adhurimet fizike, si: namazi, agjërimi dhe haxhi, që janë kryesisht fizike, zekati përfaqëson një dimension financiar të adhurimit, i cili është i detyrueshëm për çdo mysliman që plotëson kushtet e caktuara të pasurisë.

Karakteri i detyrueshëm i zekatit e dallon atë nga format e tjera të bamirësisë. Ai nuk është një favor, apo bamirësi, nuk është produkt i zgjedhjes personale, apo i bujarisë individuale, por një detyrim hyjnor i përcaktuar qartë në Kuran, i cili ka si qëllim trajtimin e varfërisë dhe shpërndarjen e pasurisë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Përmes këtij punimi, do të shqyrtojmë atë si zekati kontribuon në drejtësinë ekonomike dhe sociale në Islam, duke analizuar se si ai është një e drejtë e caktuar për të varfrit, një detyrim për të pasurit dhe një e drejtë e shoqërisë dhe e Zotit.

ZEKATI SI E DREJTË E TË VARFËRVE

Marrja e pjesës së të varfërve dhe nevojtarëve nga pasuria e të pasurve përbën një nga shtyllat themelore të sistemit ekonomik dhe social në Islam. Kjo e drejtë është vendosur qartë në Kuran dhe Sunet që para më shumë se katërmbëdhjetë shekujve. Zoti i Madhëruar e ka përcaktuar këtë në mënyrë eksplicite përmes ajeteve kuranore, ku theksohet se në pasurinë e besimtarëve të pasur ekziston një pjesë e caktuar që u takon atyre që kanë nevojë. Zoti i Madhëruar thotë: *"Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë një pjesë të caktuar (e njohur). Për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp."* (El Mearixh, 24-25).

Karakteri i detyrueshëm i zekatit e dallon atë nga format e tjera të bamirësisë. Ai nuk është një favor, apo bamirësi, nuk është produkt i zgjedhjes personale, apo i bujarisë individuale, por një detyrim hyjnor i përcaktuar qartë në Kuran.

Ky ajet tregon se zekati është një e drejtë e njohur dhe e caktuar që duhet të jepet nga ata që kanë pasuri. Kjo pjesë e pasurisë, e njohur si zekat, nuk është thjesht një akt bamirësie, por një detyrim fetar i institucionalizuar, ku Ligjvënësi ka përcaktuar rregullat, sasitë dhe kushtet e dhënies së tij. Kjo nuk është lënë në dorë të bamirësisë së rastësishme të të pasurve, apo në varësi të ndjenjave të tyre të mëshirës. Përkundrazi, përcaktoi sasinë, kohën, personat që obligohen më dhënie dhe personat të cilëve u takon.

E drejta e të varfrit në zekat bazohet në parimin se ai është vëlla i të pasurit në fe dhe njerëzim. Islami e ka bërë shoqërinë si një familje ku anëtarët e saj e mbrojnë njëri-tjetrin, madje si një trup i vetëm, ku nëse disa gjymtyrë ankojnë, ankon i tërë trupi. Prandaj,

është e drejtë e të varfrit që të ndihmohet, të mbështetet dhe të kapet për dore, kur ai nuk mund të punojë, ose mund të punojë, por nuk mund të gjejë punë, ose punon, por nuk siguron të ardhura të mjaftueshme, ose siguron të ardhura të mjaftueshme, por përballet me fatkeqësi që i çojnë në varfëri.

Nuk është besim as njerëzore që disa njerëz të ngopen derisa të ankohen nga ngopja, ndërkohë që pranë tyre ka të varfër që vuajnë urie. Neglizhimi i kësaj përgjegjësie shpie në hidhërimin e Zotit në këtë botë dhe në botën tjetër.[1] Kurani na tregon se mosushqyerja e të varfërve është një nga arsyet për ndëshkim në botën tjetër: *"Çka u solli juve në Sekar?" Ata thonë: "Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënin namaz); Nuk kemi qenë që ushqenim të varfrit…"* (El Mudethir, 40-44).

Kjo tregon se përgjegjësia sociale ndaj të varfërve nuk është thjesht një çështje e zgjedhjes personale, por një detyrim fetar me pasoja serioze.

ZEKATI SI E DREJTË E SHOQËRISË

Zekati, përveçse është e drejtë e të varfërve, ai gjithashtu është edhe e drejtë e shoqërisë. Pasuria e individëve nuk është vetëm rezultat i përpjekjeve të tyre personale, por është rezultat i kontributit të shumë faktorëve që ndihmojnë në krijimin e saj. Kjo ngase një person nuk e fiton pasurinë vetëm me përpjekjen e tij, por në këtë proces përfshihen shumë ide, punë dhe kontribute të ndryshme. Disa nga këto janë të qëllimshme, disa janë të rastësishme, disa kontribuojnë nga afër, ndërsa disa të tjerë nga larg. Të gjithë këta faktorë ndihmojnë në arritjen e pasurisë në duart e pronarit të saj.[2]

Për shembull, kur e shqyrtojmë tregtarin, ne duhet të pyesim se si ai ka arritur ta mbledhë pasurinë e tij. A ka marrë ndihmë nga shoqëria? Nga kush ka blerë produktet e tij? Kujt ia ka shitur? Me çka ka punuar? Cila do të ishte gjendja e tij nëse shoqëria nuk do të ekzistonte? Kjo e njëjta logjikë vlen edhe për fermerët, prodhuesit dhe të gjithë ata që zotërojnë pasuri. Të gjithë këta individë janë të lidhur ngushtësisht me shoqërinë, dhe me këtë, shoqëria ka të drejtë të kërkojë një pjesë nga pasuria e tyre, e cila shërben si një mekanizëm që siguron një shpërndarje më të drejtë të burimeve dhe qëndron si një mjet për të mbështetur nevojtarët dhe për ta përmirësuar jetën e të varfërve.

Në një shoqëri islame, pasuria nuk konsiderohet si pronë e individëve, por si një amanet që Zoti ua ka dhënë atyre për ta menaxhuar dhe për t'u kujdesur për të. Ky koncept i rëndësishëm e bën zekatin një mjet për të siguruar që pasuria të mos mbetet e grumbulluar vetëm në duar të disa individëve, por të shpërndahet në të gjithë shoqërinë për të përmirësuar jetën e të varfërve dhe për të mbështetur ata që kanë nevojë.

ZEKATI SI E DREJTË E ZOTIT

Përveç asaj që është thënë, zekati është e drejtë e Zotit të Madhëruar, sepse Ai është pronari i vërtetë i çdo gjëje në univers, përfshirë Tokën, Qiellin dhe gjithçka që ekziston brenda tyre. Pasuria që njeriu ka në dorë nuk është më shumë se një pasuri që Zoti ia ka besuar dhe ai është vetëm një menaxhues i kësaj pasurie, i besuar nga Zoti për ta përdorur dhe shpërndarë atë. Ajo pasuri është e Zotit, sepse Ai është Krijuesi, Dhuruesi, Lehtësuesi i mjeteve të saj, si dhe dhënësi i aftësisë te njeriu për ta fituar atë.

Për shembull, nëse njeriu mbjell një farë dhe ajo rritet, ose mbjell një pemë dhe ajo jep fryte, lind pyetja, sa është puna e dorës së njeriut në lërim, ujitje dhe kujdes, në raport me punën e Dorës së Zotit, i Cili e shtroi tokën, zbriti shi nga qielli, bëri lumenj që rrjedhin nëpër tokë, siguroi burimet natyrore që ia mundësojnë farës të mbijë dhe të prodhojë fryte?!

Mandej, çfarë bën njeriu nëse Zoti nuk i jep mjetet me të cilat punon dhe mendjen me të cilën mendon dhe menaxhon?![3] Kjo tregon mirësinë dhe bekimin e Zotit ndaj robërve të Tij. Puna e njeriut është vetëm një pjesë e vogël në këtë proces të madh, ndërsa fuqia dhe kujdesi i Zotit janë ato që i mundësojnë të gjitha këto procese.

Kurani ilustron këtë koncept përmes shembujve të shumtë nga natyra dhe prodhimi bujqësor, duke nënvizuar rolin e kufizuar të njeriut në përfitimin e pasurisë. Ai sqaron mirësinë e Zotit ndaj robërve të Tij dhe fton të meditojnë rreth krijimit të ushqimit dhe burimit të tij: *"A nuk e shihni atë që e mbillni? A ju e bëni të mbijë ajo, apo Ne e bëjmë të mbijë? Sikur Ne të dëshironim, do ta bënim atë të thyer (të shkatërruar) e ju do të mbeteshit gjithmonë të habitur (duke thënë). S'ka dyshim se ne mbetëm të dëmtuar. Po jo, ne mbetëm pa të (të varfëruar). A e shihni ujin që po e pini? A ju e lëshoni*

atë prej reve, apo Ne jemi që e lëshojmë? Sikur Ne të dëshirojmë, e bëjmë atë të njelmët, përse nuk falënderoni?" (El Vakiah, 63-70).

Kjo tregon që, përkundër mundësive dhe përpjekjeve njerëzore, është vetëm Zoti që e mundëson çdo gjë. Në një tjetër kontekst, Kurani përmend gjithashtu procesin e krijimit të ushqimit dhe burimet natyrore që ia mundësojnë njeriut të ketë ushqim. Ai na fton të meditojmë rreth tyre: *"Njeriu le të shikoje ushqimin e vet. Ne lëshuam shi të mjaftueshëm. Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës, dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra, edhe rrush e perime..."* (Abese, 24-28).

Ky është një tjetër rikujtim për njeriun që gjithçka që ka është dhuratë nga Zoti dhe se roli i tij është vetëm të menaxhojë dhe të kujdeset për atë që ka.

Puna e "dorës" së Zotit nuk është vetëm në bujqësi, por në çdo aspekt të jetës: bujqësi, tregti, industri dhe të tjera. Në fushën e industrisë, për shembull, Zoti na ka dhënë hekurin, i cili ka dobi të madhe për njerëzimin: *"Ne e kemi zbritur edhe hekurin që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëz."* (El Hadid, 25).

Shprehja *"ne zbritëm"* do të thotë se Zoti e krijoi atë me një rregullim suprem qiellor, në të cilën nuk ka dorë njeriu. Gjithashtu, Zoti u ka mësuar njerëzve zanate të ndryshme, siç tregohet në shembullin e Profetit Davud a.s., të cilit iu mësua përpunimi i hekurit për mbrojtje: *"Ne i mësuam atij (Davudit) mbarimin e petkave (të hekurta) për ju, që t'ju mbrojnë në raste lufte. A jeni pra mirënjohës ju për këtë?"* (El Enbija, 80).

Rezultati i kësaj është se pasuria që ne zotërojmë është në të vërtetë një amanet nga Zoti. Pavarësisht punës dhe mundimit tonë, duhet të pranojmë se furnizimi përfundimtar vjen nga Zoti. Për këtë arsye, është e natyrshme që ne të ndajmë një pjesë të pasurisë sonë me të tjerët, veçanërisht me ata në nevojë, në përmbushje të detyrës që i është dhënë e drejta për të qenë mirënjohës për begatitë e Tij. Dhe për shkak se pasuria është pasuri e Zotit, ndërsa njeriu nuk është gjë tjetër veçse një trashëgimtar në të ose një punëtor të cilit i është besuar zhvillimi, shpenzimi dhe përfitimi i saj.[4] Prandaj, Zoti na fton të japim nga pasuria që Ai na ka dhënë: *"...dhe jepni nga ajo që Ai u bëri trashëgues në të."* (El Hadid, 7).

Përfundimisht, zekati, si një nga shtyllat themelore të Islamit, përfaqëson më shumë se një detyrim fetar, ai ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e drejtësisë sociale dhe ekonomike. Ai është një detyrim fetar dhe një e drejtë e caktuar për të varfrit, shoqërinë dhe Zotin. Ai është një mjet i fuqishëm për të kontribuar në mirëqenien e shoqërisë dhe për të forcuar lidhjet sociale mes individëve. Përmes zekatit, Islami promovon një model solidariteti dhe barazie, ku pasuria shpërndahet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Ky sistem i drejtësisë sociale, i institucionalizuar dhe i detyrueshëm, mundëson që të varfrit të mbrohen dhe t'u garantohen të drejtat e tyre, jo përmes bamirësisë, por përmes një detyrimi të përcaktuar nga Zoti i Madhërishëm.

1 El Ibadetu fil-Islam, fq.268.
2 El Ibadetu fil-Islam, fq.269-270.
3 Po aty, fq.270.
4 El Ibadetu fil-Islam, fq.271-272.

Familja myslimane dhe industria e Inteligjencës Artificiale

OPINION I LËSHUAR NGA KËSHILLI I FETFASË NË EGJIPT

Në epokën e Inteligjencës Artificiale (AI - Artificial Intelligence), familjet myslimane, si çdo familje tjetër, janë duke lundruar në mundësitë dhe sfidat e paraqitura nga përparimi teknologjik në çdo aspekt të jetës së tyre të përditshme. Ky ndërveprim i përditshëm përfshin aplikacione celulare, platforma në internet dhe pajisje të fuqizuara nga AI që mund të ofrojnë burime për kohën e lutjes, studimet kuranore, edukimin islam dhe akçes te studiuesit fetarë. Këto mjete mund të ndihmojnë familjet myslimane të ruajnë traditat e tyre fetare dhe të forcojnë besimin e tyre në epokën digjitale. Në përputhje me këtë përparim teknologjik, institucionet zyrtare fetare të përfaqësuara në Darul Ifta të Egjiptit kanë lansuar aplikacionin "Fatwa Pro", i cili është një aplikacion elektronik shumëgjuhësh i krijuar për të komunikuar me komunitetet myslimane, veçanërisht në Perëndim. Kjo është platforma e parë e sigurt në internet që përfaqëson një referencë autentike të rregulluar mbi njohuritë fetare për myslimanët në Perëndim, duke u ofruar atyre një strehë për t'u mbrojtur kundër valëve të ekstremizmit, devijimit dhe ateizmit.

Në këtë diversitet dhe njohuri islame që u bënë të disponueshme më parë, familjet myslimane duhet të marrin në konsideratë implikimet etike të teknologjisë së AI. Kjo përfshin shqetësime të tilla si privatësia e të dhënave, paragjykimet algoritmike dhe keqpërdorimi i mundshëm i AI në përhapjen e gjuhës së urrejtjes ose mosinformimit. Parimet etike islame, si drejtësia, paanësia dhe respekti për privatësinë, duhet t'u prijnë diskutimeve mbi zhvillimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të AI brenda familjeve myslimane.

DHUNA NË FAMILJE – NJË KRIZË BESIMI

Për këtë arsye, ne duhet të hedhim dritë mbi një nga dukuritë mbizotëruese brenda familjes myslimane dhe të përpiqemi të hetojmë tekstet ligjore për ta përballuar atë. Një thirrje e tillë individualizmi është rezultat i natyrshëm i përdorimit të tepërt të pajisjeve inteligjente brenda familjes. Me fjalë të tjera, çdo anëtar i familjes po jeton në flluskën e vet dhe kështu gjuha e komunikimit të ekuilibruar konstruktiv u fundos në harresë. Prandaj, mund të gjejmë shumë fëmijë nga Gjenerata "Z" (Gjenerata Z është grupi demografik që vjen pas mijëvjeçarëve, NI.) që vazhdimisht ankohen se janë ekspozuar ndaj dhunës fizike ose verbale nga prindërit e tyre

për shkak të hendekut ekzistues të shkaktuar nga teknologjia dhe platformat e mediave sociale.

Dhuna në familje është në fakt një çështje serioze dhe e përhapur që prek individët dhe familjet në mbarë botën. Ai i referohet çdo forme abuzimi ose sjelljeje të dhunshme që ndodh brenda marrëdhënieve intime, duke përfshirë dëmtimin fizik, emocional, seksual ose psikologjik. Dhuna në familje është një çështje globale që prek individë të të gjitha gjinive, moshave, racave dhe prejardhjes socio-ekonomike. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), afërsisht 1 në 3 gra në mbarë botën kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale.

Në një shoqëri të tillë moderne, në të cilën individët kanë akçes në arsim dhe luajnë një rol vendimtar në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shoqërisë, kapja pas nocioneve të modës së vjetër për disiplinimin e grave dhe fëmijëve nëpërmjet dhunës nuk ka kuptim. Siç përmendet në ajetin kuranor, Zoti u kërkon besimtarëve që të këshillojnë varësinë e tyre me lutje dhe të jenë të durueshëm me fjalët e mira: "*Dhe urdhëro familjen tënde (dhe njerëzit) për namazin dhe ji i qëndrueshëm në të.*" (Ta Ha, 132). Të përmbajturit nga çdo lloj goditjeje është më afër kuptimit që Zoti synonte për marrëdhëniet familjare në përgjithësi "etikën e mëshirës" (rahmeh) në këtë ajet dhe në këtë kontekst.

Megjithatë, ajo që po monitorohet aktualisht tregon se trajtimi i dhunshëm është i vetmi mjet me fëmijët ose anëtarët e familjes, veçanërisht në mungesë të dialogut dhe mirëkuptimit. Është gjithashtu interesante të theksohet se asnjëherë nuk është përmendur se i Dërguari i Zotit ka goditur gratë e tij apo dikë. Nëna e besimtarëve, zonja Aishe r.a., tregon se Pejgamberi a.s. nuk e ka goditur askënd me dorën e tij, as grua dhe as shërbëtore, por vetëm në rastin kur ai kishte luftuar në rrugën e Zotit. (Muslimi në Sahih).

Dhe me siguri se rregulli i artë që është çelësi për zgjidhjen e më shumë se 90% të hendekut të moshës brenda familjes myslimane janë fjalët e Zotit në Kuran: "*Dhe fol mirë me njerëzit.*" (El Bekare, 83).

A MUNDET AI TË NDIHMOJË?

Është e rëndësishme të mbani mend se AI duhet të plotësojë, jo të zëvendësojë, ndërhyrjen dhe mbështetjen e njeriut.

"Atëherë pyetni ata që kanë njohuri (të shkrimeve) nëse nuk dini."

(En Nahl, 43).

Ndërveprimet njerëzore të personalizuara dhe empatike janë thelbësore në rastet e dhunës në familje. Inteligjenca artificiale duhet të shihet si një mjet për të përmirësuar shërbimet ekzistuese dhe për të ofruar përkrahje shtesë, ndërsa profesionistët njerëzorë mbeten kritikë në ofrimin e mbështetjes emocionale dhe të kuptuarit e kompleksitetit të situatave të dhunës në familje. Zoti i Plotfuqishëm thotë: "*Atëherë pyetni ata që kanë njohuri (të shkrimeve) nëse nuk dini.*" (En Nahl, 43).

Ndërsa AI ka potencialin të jetë një mjet i vlefshëm në adresimin e dhunës në familje, ai ngre konsiderata të rëndësishme etike. Ruajtja e privatësisë, garantimi i sigurisë së të dhënave dhe shmangia e paragjykimeve algoritmike janë thelbësore për të parandaluar dëmtimin ose keqpërdorimin e mundshëm të teknologjisë së AI në këtë fushë të ndjeshme.

Si përfundim, AI mund të kontribuojë pozitivisht në adresimin e dhunës në familje duke ndihmuar në zbulimin e hershëm, duke mbështetur të mbijetuarit, duke analizuar të dhënat, duke vlerësuar rreziqet dhe duke informuar ndërhyrjet. Megjithatë, është jetike t'i qasemi përdorimit të AI në këtë kontekst me kujdes, duke siguruar që privatësia, konsideratat etike dhe një qasje me në qendër njeriun të mbeten në krye të çdo zgjidhjeje teknologjike.

Përktheu: Nexhat Ibrahimi

[1] Burimi: *The Muslim Family and AI Industry,* Egypt's Dar Al-Ifta, sipas: https://www.dar-alifta.org/en/article/details/8863/the-muslim-family-and-ai-industry.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFIN E MISIONIT TË EULEX-IT NË KOSOVË, Z. GIOVANNI PIETRO BARBANO

Më 27 shkurt 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në një takim kurtuazie shefin e Misionit të EULEX-it në Kosovë, z. Giovanni Pietro Barbano.

Gjatë këtij takimi u diskutua për rëndësinë dhe rolin e dialogut ndërfetar dhe bashkëjetesën paqësore ndërmjet grupeve fetare në Kosovë.

Myftiu Tërnava me këtë rast tha se Kosova, ndonëse një vend i vogël, botës i jep shembullin më të mirë të harmonisë dhe bashkëjetesës ndërmjet besimeve të ndryshme. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar që të vazhdojë kultivimin e raporteve të mira që kanë me bashkësitë e tjera fetare në vend, gjithnjë për promovimin e paqes dhe mirëkuptimit ndërmjet qytetarëve të të gjitha grupeve fetare në vend. Myftiu Tërnava shfrytëzoi rastin që të njoh mysafirin edhe me aktivitetin humanitar të Bashkësisë Islame të Kosovës, që zhvillon përmes Shoqatës Humanitare Bamirëse "Bereqeti".

Nga ana e tij, z. Giovanni Pietro Barbano, falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen, si dhe shprehu mirënjohjen e tij për angazhimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës për mirëqenien e gjithë qytetarëve në vend, si dhe për angazhimin e tij në promovimin e vlerave të paqes dhe respektit të ndërsjellë.

Ai në fund shfrytëzoi rastin që të uroi Myftiun Tërnava dhe gjithë besimtarët myslimanë për ardhjen e muajit Ramazan, me urimet për pranim të agjërimit dhe sakrificës.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZYRTAREN PËR ÇËSHTJE POLITIKE NË AMBASADËN E SHBA-VE, ZNJ. BROOKE YOUNG

Më 25 shkurt 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim zyrtaren për çështje politike në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, znj. Brooke Young.

Gjatë këtij takimi u diskutua për rëndësinë e lirive fetare dhe angazhimin e Bashkësisë Islame në avancimin e të drejtave dhe lirive fetare në Kosovë.

Myftiu Tërnava theksoi se Kosova është një shembull i harmonisë fetare, ku besimtarët e feve të ndryshme bashkëjetojnë në paqe dhe respekt. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e lirive fetare dhe respektimin e diversitetit, duke kontribuuar kështu në forcimin e paqes dhe stabilitetit në vend.

Nga ana e saj, znj. Brooke Young, vlerësoi lart kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe angazhimin e saj për t'i ruajtur dhe forcuar liritë fetare, duke theksuar faktin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështesin përpjekjet e Kosovës për të promovuar tolerancën fetare dhe të drejtat e njeriut. Ajo me këtë rast theksoi rëndësinë e dialogut ndërfetar dhe bashkëpunimin për ndërtimin e një shoqërie të barabartë për të gjithë qytetarët.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN EKZEKUTIV TË ÇMIMIT "SHEIKH HAMAD" PËR PËRKTHIM DHE MIRËKUPTIM NDËRKOMBËTAR, Z. LABIB NAHHAS

Më 5 shkurt 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim z. Labib Nahhas, drejtor ekzekutiv i Çmimit "Sheikh Hamad" për Përkthim dhe Mirëkuptim Ndërkombëtar, dhe dr. Halit Eren, anëtar i bordit të këtij çmimi.

Gjatë takimit u diskutua rëndësia e përkthimit në promovimin e dialogut ndërkulturor dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Myftiu Tërnava e njohu mysafirin me angazhimet dhe punët e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke theksuar kështu rolin e përkthimit në përhapjen e njohurive dhe mirëkuptimit ndërmjet popujve, ndërsa z. Nahhas dhe z. Eren ndanë përvojat e tyre në promovimin e përkthimit si mjet për ndërtimin e urave të mirëkuptimit ndërkombëtar.

U INAUGURUA PROGRAMI PËR SHPËRNDARJEN E HURMAVE I ARABISË SAUDITE

Më 10 shkurt 2025, në ambientet e Medresesë "Alauddin" në Prishtinë, me një atmosferë vëllazërore, u inaugurua programi për shpërndarjen e hurmave nga Mbretëria e Arabisë Saudite, Qendra e Mbretit Selman. 25 ton hurma do të shpërndahen për familjet në nevojë nga Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti".

Në këtë ngjarje morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, zëvendësambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, Ahmed al Harbi, dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij Myftiu Tërnava falënderoi shtetin e Arabisë Saudite për përkrahjen e vazhdueshme ndaj popullit të Kosovë, gjatë dhe pas luftës, duke përmendur donacione të shumta që ky shtet dha për popullin e Kosovës kur ishte më tepër nevoja. Myftiu Tërnava po ashtu me këtë rast shprehu mirënjohjen për Shoqatën Humanitare Bamirëse "Bereqeti" për gjithë punën dhe përkushtimin e saj për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve të Kosovës.

Hurmat e para të këtij projekti u ndanë për nxënësit e Medresesë "Alauddin" në Prishtinë. Në ditët në vijim do të bëhet shpërndarja e hurmave për familjet në nevojë.

MYFTIU TËRNAVA TAKOI ADMINISTRATËN E KËSHILLAVE TË BI-SË

Më 11 shkurt 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnava, zhvilloi një takim frymëzues me administratën e Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës – kryetarët, kryeimamët, sekretarët dhe arkëtarët.

Në këtë mbledhje, Myftiu Tërnava nënvizoi rëndësinë e angazhimit të secilit anëtar të administratës, duke theksuar nevojën për një bashkëpunim të ngushtë dhe përmbajtje të plotë ndaj vlerave dhe strukturës hierarkike të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai e cilësoi këtë takim si një kujtesë për përgjegjësitë që bart secili mbi supe dhe për angazhimin që duhet treguar në secilin hap të punës.

Po ashtu, Myftiu Tërnava nuk i la pa përmendur sulmet që po vijnë nga individë dhe grupe të ndryshme, që tentojnë të largojnë besimtarët nga rruga e Islamit, duke theksuar se besimi është i fortë dhe askush nuk mund ta ndryshojë atë me forcë.

Në këtë takim u diskutuan gjithashtu tema të rëndësishme që lidhen me rolin e imamëve dhe anëtarëve të Këshillave të BIK-ut, si dhe përgatitjet për muajin e begatë Ramazan.

Në fund të takimit, duke falënderuar secilin për punën, kontributin e angazhimin, Myftiu Tërnava uroi të gjithë për ardhjen e muajit të bekuar Ramazan, duke lutur Zotin që të na e mundësojë ta përjetojmë këtë muaj me devotshmëri, dashuri dhe sakrificë.

MEDRESEJA "ALAUDDIN" SHËNOI 17 SHKURTIN, DITËN E PAVARËSISË SË KOSOVËS

Më 13 shkurt 2025, me një program të pasur artistik, në amfiteatrin e medresesë së mesme "Alauddin" në Prishtinë, u shënua 17 Shkurti, Dita e Pavarësisë së Kosovës.

Në këtë manifestim përveç nxënësve dhe profesorëve të kësaj shkolle, i pranishëm qe edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, me bashkëpunëtorë, i cili në fjalën e tij para të pranishmëve, theksoi kënaqësinë dhe lumturinë që ndien ai kur gjendet para këtyre të rinjve dhe të rejave, që kryesish janë të lindur në Kosovën e lirë dhe të pavarur.

"Unë jam vërtet njeri me fat që Zoti ma mundësoj që sot t'i shohim këta të rinj dhe të reja që kryesisht janë të lindur në Kosovën e lirë dhe të pavarur, e kjo është një kënaqësi e veçantë kur ju nuk keni përjetuar asnjë ditë të aparteidit të dhunës, maltretimeve e burgosjeve që bënte dikur Serbia. Më vjen mirë që prapë Zoti ma mundësoj të jemi këtu në këtë vend, ku qëndruam stoikë e të pathyer, bashkë me kolegët e mi, me nxënësit e viteve 1981-1999, ngase këtu ku sot jeni ulur ju, qëndruan e diskutuan burra e gra të këtij kombi, njerëz të cilët e donin lirinë, këtu lindën ide dhe vizione të qarta për ardhmërinë e vendit", – tha ndër të tjerash Myftiu Tërnava.

Ai gjithashtu porositi nxënësit që të jenë krenarë që janë pjesë e kësaj shkolle, ngase kjo shtëpi qëndroi në ditët më të vështira të kombit tonë. "Kosova është e jona, trojet etnike shqiptare janë tonat dhe assesi në asnjë moment askujt nuk guxojmë t'ia falim" – përfundoi fjalimin Myftiu Tërnava.

Këtë takim e përshëndeti edhe drejtori i shkollës, Fadil ef. Hasani, ndërsa programi më pas vazhdoi me disa pika artistike, të përgatitura nga nxënësit e Medresesë "Alauddin".

FILLOI SHPËRNDARJA E MBI TETË MIJË PAKOVE USHQIMORE PËR FAMILJET NEVOJTARE

Më 18 shkurt 2025, filloi shpërndarja e mbi tetë mijë pakove ushqimore për familjet nevojtare, në kuadër të një aksioni humanitar të organizuar nga Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti" në bashkëpunim me Qendrën e Mbretit Selman për Ndihmë dhe Punë Humanitare të Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Shpërndarja e ndihmave është fokusuar te kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë, në prag të muajit të shenjtë Ramazan dhe ka filluar në Prishtinë, për të vazhduar më pas me qytetet e tjera. Në këtë ceremoni hapëse mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, i cili gjatë ceremonisë së shpërndarjes, e vlerësoi këtë aksion si një ndihmë të rëndësishme për ata që kanë më së shumti nevojë.

Nga ana tjetër, ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, Feisal Hefzi, tha se një iniciativë e tillë është e domosdoshme për të mbështetur familjet e cenueshme në këtë periudhë të vitit.

"Komuna e Prishtinës ka përzgjedhur pjesën më të ndjeshme të shoqërisë për të përfituar nga ky aksion humanitar," tha Gentiana Hasani, duke nënvizuar rëndësinë e ndihmës për familjet në nevojë.

Ky aksion humanitar realizohet tradicionalisht në prag të Ramazanit, duke synuar të lehtësojë kushtet e jetesës për familjet që përballen me vështirësi ekonomike.

U VARROS IMAMI I FSHATIT ORLLAN, SHEFQET EF. PAJAZITI

Më 19 shkurt 2025, pas një sëmundje të rëndë, ndërroi jetë imami i fshatit Orllan, Shefqet ef. Pajaziti. Po atë ditë, me pjesëmarrjen e shumë qytetarëve dhe hoxhallarëve nga vende të ndryshme të Kosovës, në varrezat e fshatit Orllan, pranë kullës së dëshmorit Zahir Pajaziti, u varros imami i këtij fshati, Shefqet ef. Pajaziti.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i cili njëkohësisht edhe i priu faljes së namazit të xhenazes.

Ai para të pranishmëve çmoi dhe nderoi lart personalitetin e imamit Shefqet ef. Pajaziti. Myftiu Tërnava tha se sot, jo vetëm Orllani dhe Podujeva, por edhe tërë Kosova dhe Bashkësia Islame e Kosovës kanë humbur një punëtor të dalluar. "Mulla Shefqeti ishte një punëtor i zellshëm, një imam që kontribuoi jashtëzakonisht shumë për edukimin e brezave të rinj, një luftëtar që i ktheu pushkën armikut kur ishte nevoja, andaj me këtë rast porosis edhe familjen që të jenë krenarë për familjarin dhe hoxhën e tyre" – tha ndër të tjera Myftiu Naim ef. Tërnava.

Myftiu Tërnava shfrytëzoi rastin që një mesazh t'ua drejtoi edhe ish-nxënësve të tij, duke i porositur ata që ta vazhdojnë rrugën e mësuesit të tyre dhe të ndihen krenarë për të.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË VEPRIMTARISË BOTUESE TË DIJANET-IT, Z. CAFER TAYYAR DOYMAZ

Më 20 shkurt 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim drejtorin e Përgjithshëm të Veprimtarisë Botuese të Dijanet-it të Turqisë, z. Cafer Tayyar Doymaz, i cili shoqërohej nga shefi i sektorit për botime në gjuhë të huaja pranë këtij institucioni, z. Fatih Karazeybek. Në shoqërim të mysafirëve nga Dijanet-i ishte edhe atasheu për Çështje Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Bynjamin Albayrak.

Myftiu Tërnava fillimisht iu uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu ata me veprimtarinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë për veprimtarinë botuese që ky institucion e zhvillon përmes Shtëpisë Botuese "Dituria Islame". Ai me theks të veçantë e falënderoi z. Doymaz për botimin e përkthimit të Kuranit fisnik në gjuhën shqipe, i cili tashmë së fundi është botuar.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për rëndësinë e shkëmbimeve kulturore dhe për bashkëpunimin në fushën e botimeve, duke e cilësuar këtë si një mbështetje për promovimin e librit si një mjet edukimi dhe zhvillimi.

Edhe z. Doymaz, shprehu gatishmërinë e tij që të vazhdojë bashkëpunimi i frytshëm me Bashkësinë Islame të Kosovës, gjithnjë për të krijuar mundësi të reja për përhapjen e mesazheve të paqes dhe mirëkuptimit ndërmjet kulturave të ndryshme.

U PROMOVUA "KURANI FISNIK – PËRKTHIMI SHQIP"

Më 21 shkurt 2025, nën organizimin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, në qytetin historik të Prizrenit u promovua vepra "Kurani fisnik – përkthimi shqip", një botim me rëndësi të madhe për besimtarët dhe studiuesit e fesë islame.

Në këtë promovim morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, drejtori për botime në Dijanet-in e Turqisë, z. Cafer Tayyar Doymaz, anëtarë të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, kryetarë dhe kryeimamë të Këshillave, profesorë, studiues, dashamirë të librit e kulturës, si dhe shumë të ftuar të tjerë.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu Naim ef. Tërnava, theksoi rëndësinë e këtij botimi në përhapjen dhe kuptimin e drejtë të mesazhit hyjnor, duke falënderuar organizatorët për punën e tyre të palodhur. Ai gjithashtu falënderoi në mënyrë të veçantë Dijanet-in e Turqisë për botimin e Kuranit, duke shprehur kështu falënderimet e tij për bashkëpunimin dhe për ndihmën e vazhdueshme që ka dhënë Dijanet-i për Bashkësinë Islame të Kosovës.

Ndërkaq, drejtori për Veprimtari Botuese i Dijanet-it të Turqisë, z. Cafer Tayyar Doymaz, theksoi se është detyrë që Kurani të përkthehet në çdo gjuhë të botës. Ai u shpreh i gëzuar që ky projekt u përfundua në prag të muajit të shenjtë Ramazan dhe shprehu mbështetjen për nisma të tilla që forcojnë lidhjet shpirtërore dhe kulturore.

Në këtë tubim mbajti fjalë edhe drejtori për Veprimtari Botuese i Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Ramadan Shkodra, i cili theksoi se shqiptarët gjithmonë i kanë kushtuar rëndësi të madhe dijes dhe se përkthimi i Kuranit ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe

në mënyrën e jetesës së tyre. Ai dha më shumë detaje rreth përkthimitdhe njoftoi se ai do të shpërndahet si dhuratë në të gjitha trojet shqiptare.

Ndërsa prof. Besnik Jaha, redaktor gjuhësor i këtij botimi, theksoi se mesazhet hyjnore janë ruajtur si amanet ndër shekuj dhe se rëndësia e redaktimit shkon përtej korrektësisë gjuhësore, duke pasur përgjegjësi të madhe në qartësinë dhe saktësinë e tekstit. Ai shtoi se redaktimi i një vepre si përkthimi i Kuranit është një detyrë më e rëndësishme dhe më sfiduese sesa çdo titull apo nderim.

Në përmbyllje të këtij tubimi, për të pranishmit u shpërndanë disa kopje të Kuranit.

Theksojmë se "Kurani Fisnik – përkthimi shqip" është përgatitur, redaktuar dhe lejuar për botim nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në bashkëpunim me "Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları", "Türkiye Diyanet Vakfı" dhe Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Ky botim është përkthim i myderrizit të shquar, haxhi Sherif Ahmeti.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 26 shkurt 2025, në prag të fillimit të muajit të bekuar Ramazan, sot, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e saj të rregullt, nën kryesimin e kryetarit të saj, Myftiut Naim ef. Tërnava.

Gjatë kësaj mbledhje si pikë kryesore qe parapërgatitja për muajin e bekuar Ramazan, ku para anëtarëve u shpalosën planet dhe aktivitetet që priten të realizohen përgjatë këtij muaji.

Po ashtu në këtë mbledhje u diskutuan edhe pika të tjera të rëndësishme, për të cilat u dhanë ide dhe u morën vendime në bazë të kompetencave që i takojnë kësaj Kryesie.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË TAKIMIN ME STUDENTËT E DIPLOMUAR NË FSI

Më 27 shkurt 2025, organizuar nga Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, u mbajt takimin me studentët e diplomuar në këtë fakultet (Alumni).

Në këtë takim mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i cili në fjalën e tij theksoi se si institucion jemi shumë krenarë me kuadrot që kanë diplomuar në këtë fakultet. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës mbetet gjithherë e përkushtuar që t'u ofrojë kushtet më të mira jo vetëm studentëve që tanimë studiojnë në FSI, por edhe atyre që kanë diplomuar. Myftiu Tërnava, shfrytëzoi rastin që në fund të takimit t'i uroj të gjithë për ardhjen e muajit të bekuar Ramazan, duke u dëshiruar agjërim të lehtë dhe të pranuar.

Një fjalë përshëndetëse e mbajti edhe dekani i FSI-së, dr. Islam Hasani, i cili në pika të shkurtra tregoi për numrin e studentëve të diplomuar, qoftë në nivelin bachelor, por edhe në atë master. Ai tha se tanimë si institucion jemi në prag të fillimit të studimeve të doktoratës, në marrëveshje me Universitetin e Malajzisë.

Në fund, edhe disa prej studentëve të diplomuar revokuan kujtimet e tyre për periudhën sa kanë qenë studentë në Fakultetin e Studimeve Islame.

VIZITA E DELEGACIONIT TË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS NË SARAJEVË

Një delegacion i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, i përbërë nga kryeimami Vedat ef. Sahiti, zv.sekretari, Rexhep Luma, drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra dhe përgjegjësi për botime, Nuhi Simnica, nga 14 deri më 17 shkurt 2025, qëndruan për vizitë zyrtare në RIJASET-in e Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës në Sarajevë, ku zhvilluan një sërë takimesh me drejtuesit e RIJASET-it dhe udhëheqësit dhe drejtuesit e institucioneve që veprojnë në kuadër të BI-së së Bosnje dhe Hercegovinës.

- **Takimi me reisul ulemanë, dr. Husein Kavazoviq**

Më 14 shkurt 2025, delegacioni i Kryesisë së BI-së së Kosovës, është pritur në takim nga reisul ulamaja i Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, Husein ef. Kavazoviq dhe bashkëpunëtorë e tij. Gjatë këtij takimi u diskutua për forcimin e mëtejmë të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës dhe asaj të Kosovës.

Reisul ulemaja Kavazoviq, u shpreh i kënaqur me bashkëpunimin e dy bashkësive islame, si dhe shprehu gatishmërinë dhe përkushtimin e tij që bashkëpunimi në të ardhmen të njohë përparim dhe rritje në fushat e arsimit, jetës fetare, asaj kulturore, si dhe të veprimtarisë botuese. Ai tha se duhet kushtuar rëndësi të veçantë veprimit të përbashkët për ruajtjen e vlerave fetare dhe kulturore të të dy popujve dhe të dyja komuniteteve fetare.

Përfaqësuesit e Kryesisë së BI-së, pasi i përcollën përshëndetjet dhe selamet e Myftiut Naim ef. Tërnava, e njohën reisul uleman me arritjet në mirëmbajtjen e jetës fetare, kulturore dhe arsimore në Kosovë. Gjithashtu, delegacioni nga Kosova shprehu gatishmërinë e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që të bashkëpunojnë në ndriçimin e së kaluarës së përbashkët, si dhe në përballimin e sfidave bashkëkohore.

Gjatë bisedës, një vëmendje të veçantë reisul ulemaja i kushtoi organizimit të përbashkët të Ekspozitës dhe ligjëratës "Bota kujton Srebrenicën", kushtuar gjenocidit në Srebrenicë, e cila u mbajt vitin e kaluar në Prishtinë. Reisul ulema Kavazoviq, me këtë rast shprehu mirënjohjen e tij të thellë për angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në fund të takimit, reisul ulemaja, përcolli përshëndetjet për Myftiun e nderuar të Kosovës, duke shprehur dëshirën

dhe përkushtimin për thellim të mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore dhe institucioneve ndërmjet dy komuniteteve.

- **Vizita në bibliotekën e Gazi Husrev Beut**

Po të premten, pas namazit të xhumasë, delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, ishte për vizitë në bibliotekën e Gazi Husreve Beut, në të cilën u mirëpritën nga drejtori Xhenan Handzhiq. Pas vizitës së muzeut të bibliotekës dhe disa departamenteve të saj, drejtori Handzhiq i njohu delegacionin e Bashkësisë Islame të Kosovës me trashëgiminë që ruan biblioteka, fondet e pasura me dorëshkrime,

dokumentet arkivore, fotografitë me vlerat e posaçme, si dhe me librat e fushave dhe disiplinave të ndryshme, e që të gjitha këto së bashku përbëjnë një trashëgimi të shkruar të Bosnje dhe Hercegovinës dhe jo vetëm.

- **Takimi me drejtuesit e Qendrës së Botimeve "El Kalem"**

Pas bibliotekës, delegacioni i Kryesisë së BI-së së Kosovës, vizitoi Qendrën e Botimeve "El Kalem", e cila vepron në kuadër të Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës. Aty u pritën ngrohtësisht nga drejtori Mesud Smajiqi, i cili shoqërohej nga kryeredaktorja, redaktorët dhe bashkautorët e tjerë të Qendrës "El Kalem". Drejtori Smajiqi dha një pasqyrë të shkurtër të veprimtarisë botuese ndër vite, si dhe i njohu delegacionin me planet dhe objektivat për të ardhmen. Gjatë këtij takimi, të dyja delegacionet ranë dakord për një bashkëpunim të ndërsjellë dhe u pajtuan që të realizojnë projekte botuese të përbashkëta.

- **Vizita në Travnik: Medreseja "Elçi Ibrahim Pasha"**

Të shtunën, më 15 shkurt 2025, delegacioni nga Bashkësisë Islame e Kosovës, qëndroi për vizitë në qytetin e Travnikut,

ku vizitoi Medresenë "Elçi Ibrahim Pasha". Aty u pritën nga ndihmësdrejtorët Xhevad Shoshiq dhe Safet Durguti. Gjatë këtij takimi u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet medreseve, të Bosnjës dhe asaj të Kosovës. Delegacioni nga Kosova, që shoqëroheshin nga nikoqirët, znj. Azra Eminoviq dhe z. Muhamed Jugo, vizituan edhe Xhaminë e Larme, një vepër kjo monumentale me vlera arkitektonike, e cila njëkohësisht është edhe ikonë e qytetit.

- **Njohja me organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Studentëve të BI-së së Bosnjës**

Të hënën, më 17 shkurt 2025, delegacioni nga Kosova, vizitoi Qendrën e Studentëve të Bashkësisë Islame të Bosnjës, në të cilën u pritën nga drejtori, dr. Ferid Dautoviq dhe nga hfz. Shpendi Fidani, bashkëpunëtor profesional.

Ata e njohën delegacionin me historikun, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Studentëve. Po ashtu delegacioni pa nga afër ambientet, kushtet dhe aktivitetet që realizohen në këtë qendër.

- **Bashkëpunimi akademik me Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë**

Po atë ditë, delegacioni vizitoi edhe Fakultetin e Shkencave Islame, në të cilin u mirëpritën nga dekani, prof. Ph.D. Mustafa Hasani, prodekanët prof. Ph.D. Ahmet Alibashiqi dhe prof. Ph.D. hfz. Aid Smajiqi.

Gjatë këtij takimi u shkëmbyen përvoja rreth programeve të studimit, me theks të veçantë në programet e studimit master dhe doktoratë në gjuhën angleze. Gjithashtu u shqyrtuan edhe mundësitë e vizitave të ndërsjella të stafit mësimdhënës dhe studentëve në të ardhmen. Të dyja palët shprehën gatishmërinë për zbatimin e këtyre nismave. Krahas temave akademike, u diskutua edhe për industrinë botuese dhe perspektivat e saj në Ballkan.

- **Vizita në Qendrën Mediale të BI-së së Bosnjës**

Gjatë ditës së hënë, delegacioni i BI-së së Kosovës, vizitoi Qendrën Mediale të Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, në të cilën u pritën nga drejtori, dr. Muamer Tinjaku, i cili shoqërohej nga drejtori i programit Nadim Hrbat. Ata u pajtuan për shkëmbimin e përmbajtjeve mediale ndërmjet dy institucioneve.

Delegacioni nga Kosova vizitoi edhe ambientet e redaksive që veprojnë në kuadër të Qendrës Mediale, ku edhe vepronin pesë platforma mediale: BIR TV, Radio BIR, Agjencia e lajmeve "Mina", Portalin "Preporodinfo" dhe gazeta islame informative "Preporod".

Aty u bisedua edhe për mundësitë e forcimit të bashkëpunimit, ku së shpejti pritet edhe nënshkrimi i protokollit për shkëmbimin e materialeve mediatike. Së shpejti do ta zyrtarizojmë këtë bashkëpunim, duke nënshkruar një protokoll për shkëmbimin e përmbajtjeve mediatike.

- **Takime me personalitete boshnjake dhe shqiptare në Sarajevë**

Gjatë qëndrimit në Sarajevë, delegacioni nga Kosova, takoi edhe profesorin e njohur boshnjak, dr. Enes Kariq, si dhe ish-zyrtarin e lartë të RIJASET-it, Muharrem Omerdiaqin. Po ashtu, delegacioni ka takuar edhe disa personalitete të shquara shqiptare, të cilët jetojnë dhe veprojnë në Sarajevë, si dhe mori pjesë në pritjen që organizoi Qendra Kulturore Shqiptare në BeH, në krye me Mitat Fidanin, me rastin e 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës.

KRYEIMAMI SAHITI TAKOI IMAMËT E DISA KËSHILLAVE TË BI-SË

Në prag të fillimit të muajit të bekuar Ramazan, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka vizituar Këshillin e BI-së së Podujevës, Gjilanit, Vitisë, Kaçanikut, Mitrovicës, Pejës dhe Lipjanit, ku ka takuar imamët e këtyre Këshillave.



Ai ka shpalosur platformën e aktiviteteve për muajin Ramazan dhe ka prezantuar qarkoren e Kryesisë së Bashkësisë Islame, e cila iu dërgua të gjitha këshillave të BI-së.

Gjatë këtyre takimeve, kryeimami Sahiti kërkoi nga imamët një përkushtim edhe më të madh në punë, sidomos gjatë këtij muaji të bekuar, pasi ky është amaneti që na është ngarkuar – amaneti i kumtimit të drejtë të fjalëve të Zotit dhe mësimeve të Pejgamberit a.s.. Ai theksoi gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit të imamëve me xhematët e tyre në terren për të plotësuar nevojat shpirtërore dhe praktike të besimtarëve.

Në vazhdim, u diskutuan edhe çështje të tjera me interes, sidomos në fushën e mësim-besimit, ku muaji i Ramazanit paraqet një mundësi të artë për edukimin e brezave të rinj. Në fund të takimit, kryeimami Sahiti uroi imamët për muajin e bekuar Ramazan, duke lutur për shëndetin e tyre, të familjeve dhe të gjithë besimtarëve kudo që janë.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË TRIBUNËN E ORGANIZUAR NGA KBI-GJILAN

Më 24 shkurt 2025, me rastin e fillimit të muajit të begatë Ramazan, Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjilan organizoi një tribunë fetare për të festuar ardhjen e këtij muaji.

Me këtë rast, kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu, në hapje të kësaj tribune falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, teksa më pas shpalosi karakteristika të veçanta të këtij muaji.

Ligjëratën kryesore kushtuar këtij muaji e mbajti kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili ligjëroi rreth asaj se si duhet të jetë besimtari gjatë këtij muaji.

Sa i përket anës shëndetësore të agjërimit, një ligjëratë të shkurtër e mbajti dr. Kushtrim Qerimi. Programi u shoqërua edhe me pika artistike.

U PËRURUA XHAMIA E RE NË NEDAKOC TË VUSHTRRISË

Më 28 shkurt 2025, në natën e bekuar të Ramazanit, në fshatin Nedakoc të Vushtrrisë, u përurua solemnisht xhamia e re, ndërtuar falë bamirësisë së familjes Pushkolli.

Në këtë ngjarje morën pjesë besimtarë të shumtë, kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, kryetari i Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi, dhe udhëheqës të tjerë fetarë e biznesmenë. Kryeimami Sahiti, në emër të Myftiut Naim ef. Tërnava dhe Kryesisë së BIK-ut, përgëzoi banorët për këtë vepër dhe falënderoi familjen Pushkolli, duke lutur Zotin për shpërblimin e tyre. Ai njoftoi gjithashtu për inaugurimin e një xhamie të ngjashme në fshatin Zakut të Podujevës.

Falënderime të veçanta për familjen Pushkolli shprehën edhe kryetari i Këshillit të BI-së së Vushtrrisë, Ejup ef. Haziri, dhe kryetari i Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi, duke vlerësuar kontributin e Bashkësisë Islame për vendin.

Në emër të familjes Pushkolli, Ridvan Pushkolli falënderoi Zotin për këtë mundësi. Hytben e xhumasë, me mesazhet për ardhjen e Ramazanit, e mbajti kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti.

XHAMIA "DRITA" NË PRATTELN TË ZVICRËS SHËNOI 20-VJETORIN E THEMELIMIT TË SAJ

Më 8 shkurt 2025, në prani të një numri të madh të mysafirëve dhe me një program të larmishëm, xhamia "Drita" në Pratteln të Zvicrës shënoi 20-vjetorin e veprimtarisë së saj.

Në këtë manifestim morën pjesë autoritete të ndryshme nga institucione të ndryshme të qytetit të Pratteln, imamë dhe veprimtarë nga Zvicra dhe rajoni. Nga Bashkësia Islame e Kosovës, në këtë tubim morën pjesë sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu dhe drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica. Gjithashtu në këtë tubim morën pjesë edhe delegacioni nga Maqedonia e Veriut, i kryesuar nga reisi Shaqir ef. Fetai, pastaj nënkryetari i KMShZ-së, Fehim ef. Abazi, si dhe mysafirë të tjerë nga vendlindja dhe Zvicra.

Sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu dhe drejtori për Diasporë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, në fjalët e tyre përcollën urimet e besimtarëve të Kosovës, institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të Myftiut Naim ef. Tërnava, duke përgëzuar Kryesinë, imamin dhe gjithë besimtarët për punën që kanë realizuar përgjatë këtyre viteve.

Në fund, drejtori Simnica, në shenjë respekti dhe bashkëpunimi, ndau një dhuratë dhe mirënjohje nga BIK-u.

U MBAJT KONFERENCA E DIALOGUT ISLAMO-ISLAMIK NË BAHREJN

Më 19 dhe 20 shkurt 2025, nën patronazhin e Madhërisë së Tij, mbretit Hamad bin Isa al Kalifa, dhe në praninë e Shkëlqesisë së Tij, Imamit të Madh të "Al Azharit", dr. Ahmed al Tayeb, Shejhut të "Al Azharit", Al Sherif dhe kryetarit të Këshillit të Urtëve Myslimanë, si dhe me pjesëmarrjen e më shumë se 400 delegatëve, dijetarëve të botës islame, liderëve fetarë, myftinjve, ministrave dhe intelektualëve, në kryeqytetin e Bahrejnit, Manama, u mbajt Konferenca e Dialogut Islamo-Islamik. Kjo Konferencë filloi punimet nën sloganin "Një umet, fat i përbashkët".

Në emër të Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavës, në këtë Konferencë mori pjesë shefi i kabinetit, mr. Besim ef. Mehmeti.

Në hapje të Konferencës, fillimisht të pranishmit i përshëndeti kryetari i Këshillit Suprem për Çështjet Islame në Bahrejn, shejhu Abdulrahman bin Muhamed al Kalifa. Ai, në emër të Mbretit të Bahrejnit, Hamad bin Isa al Khalifa, u dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve në Bahrejn, duke iu uruar punime të suksesshme dhe produktive. Më pas folën ambasadori Husein Ibrahim Taha, sekretar i Përgjithshëm i Organizatës së Bashkëpunimit Islamik, kryeministri i Malajzisë, dr. Anvar Ibrahim, dr. Mulin Ashinbajev, kryetar

i Kuvendit të Kazakistanit, Ajetullah Ahmed Almubellegi nga Irani, dr. Ahmed es Sejabi, sekretar i Zyrës së Myftiut të Omanit, Jahja Dejlemi, imami i Xhamisë Qendrore në Sanaa të Jemenit, dhe Shkëlqesia e tij, Imami i Madh, dr. Ahmed al Tayeb, Shejhu i Al Azharit.

Në fjalën e tij, Shejhu i Al Azharit, bëri thirrje për zhvillimin e një plani serioz dhe të zbatueshëm për të vendosur unitetin, mirëkuptimin dhe njohjen e ndërsjellë midis të gjitha shkollave të mendimit islam. Po ashtu, theksoi rëndësinë e një dialogu të përhershëm, në të cilin shkaqet e ndarjes, grindjeve dhe konflikteve etnike e sektariste, në veçanti, do të refuzohen, dhe në të cilin do të përqendrohen pikat e marrëveshjes dhe konvergjencës.

FIGURA TË SHQUARA FETARE NDEROHEN ME ÇMIME PRESIDENCIALE PËR KONTRIBUTIN E TYRE KOMBËTAR DHE SHOQËROR

Më 19 shkurt 2025, në ceremoninë solemne të shënimit të 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, organizuar nga presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, u nderuan me çmime të larta disa figura të shquara fetare për kontributin e tyre në çështjet kombëtare, fetare dhe shoqërore.

Ish-myftiu i Kosovës, dr. Rexhep ef. Boja, u nderua me Urdhrin Presidencial "Hasan Prishtina" për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në forcimin e vlerave të besimit dhe në kultivimin e vlerave kombëtare dhe atdhetare. Dr. Boja, i cili udhëhoqi Bashkësinë Islame të Kosovës në vitet e pasluftës, luajti një rol kyç në zhvillimin dhe përparimin e institucionit më të lartë fetar në vend.

Po në këtë ceremoni, mulla Asllan ef. Murati (post mortem) u nderua me Medaljen Presidenciale të Meritave për kontributin e tij në veprimtari atdhetare, ndërsa medalja iu dorëzua familjarëve të tij.

Gjithashtu, me medaljen presidenciale "Anton Çeta" u nderua imami, mulla Xhevat ef. Kryeziu, për angazhimin e tij në pajtim dhe paqe mes njerëzve si dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këtë medalje e pranoi vetë imami Kryeziu.

TURQIA DHUROI GJASHTË MIJË PAKO USHQIMORE PËR FAMILJET NË NEVOJË NË KOSOVË

Më 22 shkurt 2025, Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti" në bashkëpunim me Drejtorinë e Vakëfeve e Turqisë, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Turqisë, ka filluar shpërndarjen e gjashtë mijë pakove ushqimore për familjet në nevojë në Kosovë.

Kjo ndihmë vjen në kuadër të përkujdesjes për besimtarët myslimanë gjatë muajit të Ramazanit.

Xheladin Fazliu, përfaqësuesi i "Bereqetit" tha se ky aksion është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shkak se po bëhet në fillim të muajit Ramazan, ku sofra e secilës familje të jetë e mbushur dhe askush të mos e ketë brengë ushqimin.

Përfaqësuesi i Drejtorisë së Vakëfeve të Turqisë, Uğur Yazici, thotë se vëllezërit në Turqi e ndjejnë për obligim që të jenë pranë vëllezërve në Kosovë dhe në veçanti gjatë muajit Ramazan.

"Për ne si besimtarë nga Republika e Turqisë është obligim të kujdesemi për vëllezërit tanë në Kosovë. Në veçanti, kjo përkujdesje shtohet gjatë muajit Ramazan. Jemi këtu me këto dhurata për familjet që kanë nevojë për ndihmë," tha përfaqësuesi turk.

Një prej aksioneve humanitare u mbajt edhe në qytetin e Klinës, me ç'rast u vlerësua lartë uniteti në prag të Ramazanit.

Rastet sociale, jetimët, veteranët e luftës, invalidët e luftës, nënat vetushqyese, familjet e Hendikosit, shoqata e të verbërve dhe kategori të tjera prëfituan nga ky aksioni jashtëzakonshëm i "Bereqetit".

Ky vit është viti i dhjetë me radhë që Drejtoria e Vakëfeve të Turqisë së bashku me "Bereqetin" dhurojnë pako ushqimore për kategoritë e ndjeshme të shoqërisë në Kosovë dhe njëkohësisht është mbështetës i shumë projekteve të tjera për besimtarët myslimanë në Kosovë dhe shoqërinë në përgjithësi.

Pejgamberi, a.s., e bëri obligim ZEKAT (SADAKATUL) FITRIN si pastrim për agjëruesin për fjalët e këqija, dhe ushqim për të varfrit. Prandaj, kush e jep para namazit (të Bajramit), ajo është sadaka e pranuar, e kush e jep pas namazit, konsiderohet sadaka e rëndomtë!

PAGESAT E ZEKATIT DHE SADAKATUL FITRIT MUND T'I BËNI:

1. Në zyrat e këshillave të BIK-ut
2. Në secilën xhami të Kosovës
3. Në adresën bankare:
Bashkësia Islame e Kosovës
NLB-Prishtina
Account no. & IBAN:
XK05 1700200100103672
SWIFT Code (BIC): NLPRXKPR

3 euro
5 euro
10 euro

Lutje Ramazani

O Zoti ynë, i Gjithëmëshirshmi dhe i Gjithëfuqishmi, Ti që e bëre muajin e Ramazanit një muaj mëshire, falje dhe shpëtimi nga zjarri, na mundëso ta kalojmë këtë muaj me besim të fortë, me agjërim të pranuar dhe me adhurim të sinqertë!

O Allah, na jep forcë të qëndrojmë të palëkundur në bindjen ndaj Teje dhe na largo nga gjithçka që nuk të kënaq Ty! Na bëj ndër ata që e përmendin dhe falënderojnë Emrin Tënd me gjuhë dhe zemër, ashtu siç na mësoi Profeti, a.s., të lutemi: "O Zoti im, më ndihmo të të përmend, të të falënderoj dhe të të adhuroj në mënyrën më të mirë!".

Zoti ynë, na i hap dyert e mëshirës Tënde, na i fal mëkatet e kaluara dhe na udhëzo në rrugën e drejtë! "O Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë apo gabojmë! O Zoti ynë, mos na ngarko me barrë më të rëndë se sa mund të mbajmë! Na fal, na mëshiro dhe na ndihmo! Ti je Mbrojtësi ynë, prandaj na ndihmo kundër popullit mohues!" (El-Bekare: 286).

O Allah, na pastro zemrat nga urrejtja, smira dhe dyshimet, dhe na mbush me dritën e udhëzimit Tënd! Bekoje familjen tonë, forco lidhjet tona me njëri-tjetrin dhe na mbulo me mbrojtjen dhe begatinë Tënde!

O Zoti ynë, në këtë muaj të bekuar, na mundëso të arrijmë Natën e Kadrit, atë natë që është më e vlefshme se një mijë muaj! Na dhuro mundësinë ta kalojmë atë me adhurim dhe falje, duke thënë lutjen që na e mësoi Profeti, a.s.: "O Allah, Ti je Falës, e do faljen, prandaj më fal mua!"

O Allah, na bëj ndër ata që çlirohen nga zjarri i Xhehenemit dhe na dhuro kënaqësinë e shikimit të Fytyrës Sate në Xhenetin e përjetshëm!

O Zoti ynë, ne lutemi për paqe dhe siguri në vendin tonë dhe në mbarë botën. Largoji përçarjet dhe tensionet nga shoqëritë tona dhe mundëso paqen dhe harmoninë mes popujve. O Allah, mbroj vendin tonë nga çdo e keqe, nga çdo luftë dhe fatkeqësi, dhe mbushi zemrat e liderëve tanë me mençuri dhe drejtësi!

O Allah, ji pranë atyre që janë në nevojë! Mëshiroji të varfërit dhe skamnorët, mbuloji me furnizimin Tënd të pafund dhe jepu një rrugëdalje nga vështirësitë!

O Zot, ji mbështetje për jetimët dhe bëhu Ti mbrojtësi i tyre! Shto mëshirën në zemrat tona që të kujdesemi për ta!

O Allah, shëroj të sëmurët, qofshin në shtëpitë e tyre apo në spitale. Zbrit mbi ta shërimin Tënd, dhe ua shto durimin në sëmundjet që kanë!

Na dhuro shëndet, o Zot, dhe mbroji të dashurit tanë nga çdo sprovë dhe dhimbje!

Amin, o Zoti i botëve!

FAQJA E RE
E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS



www.bislame.com

DITURIA ISLAME• Nr. 412 MARS 2025